Më poshtë është tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 880-960 MHZ (900 MHz):

ECC/REC/(05)08	Planifikimi i frekuencave dhe koordinimi ndërkufitar midis Sistemeve të Lëvizshme Tokësore GSM (GSM 900, GSM 1800 dhe GSM-R).
ECC/REC/(08)02	Koordinim ndërkufitar për Rrjetet e Komunikimit Mobile/Fiks (MFCN) në brezat e frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz (duke përjashtuar GSM kundrejt GSM)

ERC/DEC/(97)02	Vendimi i ERC-së i 21 marsit 1997 mbi brezat e zgjeruar të frekuencave që do të përdoren për Sistemin e Komunikimeve Dixhitale Pan-Evropiane GSM.
ERC/DEC/(94)01	Vendimi i ERC-së i 24 tetorit 1994 mbi brezat e frekuencave që do të caktohen për futjen e koordinuar të sistemit të komunikimeve dixhitale pan-evropiane GSM.
ECC/DEC/(06)13	Kushtet teknike të harmonizuara për rrjetet e komunikimit celular/fiks (MFCN) duke përfshirë sistemet tokësore IMT, përveç GSM dhe EC-GSM IoT, në brezat 880-915/925-960 MHz dhe 1710-1785/1805-1880 MHz.

E drejta e përdorimit të frekuencave mund të transferohet. Një sipërmarrës nuk mund të transferojë të drejtën e përdorimit në brezin IMT pa miratimin paraprak të AKEP.

3.4 Brezi 1500 MHz

Brezi i frekuencave 1427-1518 MHz në Shqipëri është përdoruar për lidhje fikse me kapacitet të ulët si dhe sisteme ushtarake. Në Planin Kombëtar të Frekuencave ky brez është përcaktuar edhe për perdorime MFCN. Nëse do të parashikohet në të ardhmen futja e përdorimit MFCN duhet të merren masa për lirimin e brezit nga këto përdorime.

Ndërko CEPT ka në shqyrtim bërjen të disponueshëm për MFCN të brezit 1427-1518.

Përdorimi i brezit rekomandoht të bëhet në blloqe 5 MHz, duke rezultuar në 10 blloqet e frekuencave në vijim në brezat 1427-1452 MHz dhe 1492-1518 MHz:

Tabela 1: Rregullimi i frekuencave te harmonizuara per brezin 1427-1452 MHz

1427-1432	1432-1437	1437-1442	1442-1447	1447-1452
Downlink (base station transmit)				
25 MHz (5 blloqe prej 5 MHz)				

Tabela 2: Rregullimi i frekuencave te harmonizuara per brezin 1492-1518 MHz

1492-1497	1497-1502	1502-1507	1507-1512	1512-1517*	1517-1518
Downlink (base station transmit)					Guard band
25 MHz (5 blloqe prej 5 MHz)					1 MHz

Tabela 3: Rregullimi i kombinuar i frekuencave te harmonizuara
(perfshi vendimin e EC (EU) 2015/750)

1427 MHz 1518 MHz

1427 - 1432*	1432 - 1437	1437 - 1442	1442 - 1447	1447 - 1452	1452 - 1457	1457 - 1462	1462 - 1467	1467 - 1472	1472 - 1477	1477 - 1482	1482 - 1487	1487 - 1492	1492 - 1497	1497 - 1502	1502 - 1507	1507 - 1512	1512 - 1517*	1517 - 1518
Downlink (base station transmit)																		Guard band
90 MHz (18 blloqe prej 5 MHz)																		1 MHz

Më poshtë është tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 1427-1518 MHZ (1500 MHz):

ECC/DEC/(17)06	Përdorimi i harmonizuar i brezit të frekuencave 1427-1452 MHz dhe 1492-1518 MHz për Rrjetet e Komunikimit Mobile/Fiks Downlink Suplementare (MFCN SDL)
ECC/DEC/(13)03	Përdorimi i harmonizuar i brezit të frekuencave 1452-1492 MHz për Rrjetet e Komunikimit Mobile/Fiks Downlink Suplementare (MFCN SDL)
ECC/REC/(15)01	Koordinim ndërkufitar për Rrjetet e Komunikimit Mobile/Fiks (MFCN) në brezat e frekuencave: 694-790 MHz, 1427-1518 MHz dhe 3400-3800 MHz

3.5 Brezi 1800 MHz

Në Planin Kombëtar të Radio Frekuencave, brezi 1710 – 1785 dhe 1805 – 1880 MHz është caktuar për shërbime fikse dhe të lëvizshme.

Brezit i frekuencave 1710 – 1785 dhe 1805 – 1880 MHz përveç shfrytëzimit për sistemet GSM është i planifikuar dhe përcaktuar edhe për sistemet MFCN-IMT.

Ndarja e kanaleve dhe kushtet e përdorimit janë në përputhje me vendimet ERC/DEC/(95)03 dhe ECC/DEC/(06)13, si dhe rekomandimet ECC/REC/(05)08 dhe ECC/REC/(08)02.

Mënyra e veprimit në brezin 1800 MHz do të jetë teknika FDD (Ndarja Duplekse e Frekuencave – Frequency Division Duplex);

Brezi 1805-1880 MHz do të përdoret për transmetimin e stacionit bazë (downlink) dhe brezi 1710-1785 MHz do të përdoret për transmetimin e stacionit fundor (uplink);

Sistemet tokësore të cilat mund të zhvillohen në brezin 1800 MHz janë sistemet në përputhje me Vendimin (EU) 2022/173.

Nënbrezat 1710-1710.1/1805-1805.1 MHz dhe 1784.9-1785/1879.9-1880 MHz do të mbahen si breza të rezervuar dhe nuk do të përdoren.

Sistemet tokësore do të operojnë në brezin 1800 MHz në frekuencat e mëposhtme: 1710.1-1784.9/1805.1-1879.9 MHz;
Hapsira duplekse (duplex gap) në brezin 1800 MHz është 95 MHz;
Hapsira nominale midis kanaleve të afërta në brezin 1800 MHz:
Për sistemet GSM është 200 kHz;
Për sistemet UMTS dhe WiMAX është 5 MHz;
Për sistemet LTE është 1.4 MHz, 3 MHz, 5 MHz, 10 MHz, 15 MHz ose 20 MHz.

Vlera e frekuencës qëndrore e kanaleve që janë afër me skajet e bllokut të frekuencave duhet të zgjidhen në mënyrë që të lejojnë që kanali i frekuencës qëndrore të përfshihet terësisht brenda bllokut të frekuencave që ka në zotërim një sipërmarrësi i pajisur me autorizim.

Frekuencat e transmetimit që korenspondojnë me kanalet GSM 1800 përcaktohen nga formula, si më poshtë:
Frekuencat e transmetimit të stacioneve fundore: $Fu(n) = 1710.2 + 0.2 \times (n-512)$, $512 \leq n \leq 885$;
Frekuencat e transmetimit të stacioneve bazë: $Fd(n) = Fu(n) + 95$.

Kushtet për përdorimin e sistemeve GSM në brezin 1800 MHz:
Brezat e rezervuar (guard bands) mund të mos mbahen midis dy blloqeve të frekuencave të përdorura nga dy operatorë të ndryshëm për sistemet GSM 1800.
Në kufirin 1878-1880 MHz mund të shfaqen interferenca për shkak të sistemeve DECT (shiko Raportin ERC Report 100). Rekomandohet që 2 MHz (kufiri 1878-1880 MHz) në brezin e sipërm të 1800 MHz të mos përdoren për transmetimin e kanaleve pilot (BCCH);

Për brezat 900 MHz dhe 1800 MHz maskat e emetimeve jashtë brezit të spektrit do të jenë identike për UMTS dhe për bartëset LTE në 5,10,15 dhe 20 MHz dhe do të ketë diferenca të vogla vetëm ndërmjet bartëseve UMTS dhe WiMAX në 5 dhe 10 MHz.

Klasat e emisionit sipas ITU

Për GSM:	271KG7W
Për UMTS:	5M00D7W
Për 1.4 MHz LTE:	1M40D7W
Për 3 MHz LTE:	3M00D7W
Për 5 MHz LTE:	5M00D7W
Për 10 MHz LTE:	10M0D7W
Për 15 MHz LTE:	15M0D7W
Për 20 MHz LTE:	20M0D7W

Për 5 MHz WiMAX: 5M00D7W
Për 10 MHz WiMAX: 10M0D7W

Maksimumi i lejuar i Fuqisë së transmetuar në downlink e.i.r.p

Fuqia e transmetuar (në e.i.r.p.) në cdo drejtim në frekuencat downlink e bllokut të frekuencave të lejuara të pajisjes radio nuk duhet të kalojë:

Teknologji	Spektri 900 MHz	Spektri 1800 MHz
Për GSM	62 dBm për bartëse	62 dBm për bartëse
Për UMTS	65 dBm për bartëse	62 dBm për bartëse
Për LTE	65 dBm për 5 MHz	62 dBm për 5 MHz
Për WiMAX	65 dBm për 5 MHz	62 dBm për 5 MHz

Në përdorimin e kanaleve në kufijtë e nënbrezave të blloqeve te frekuencave të caktuara mbajtesit e të drejtave te perdorimit kane detyrimin e koordinimit mes tyre.

Në rast të përdorimit të frekuencave në zonat kufitare, autoriteti i jep autorizimet e radio frekuencave vetëm për ato stacione që plotësojnë kushtet e përcaktuara në dokumentet përkatëse të koordinimit ndërkombëtar.

Për sistemet MFCN me brez të ngushtë (NB) që funksionojnë në kanalet 200 kHz (me përjashtim të GSM dhe EC-GSM-IoT) dhe sistemet MFCN Wideband (WB) që funksionojnë në kanale më të mëdha se 200 kHz, nëse caktohen madhësi më të vogla të bllokut sesa 5 MHz, ato duhet të jenë në shumëfish të 200 kHz.


Tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 1800 MHz:

ECC/DEC/(06)13	Vendimi mbi përcaktimin e brezeve 880-915 MHz, 925-960 MHz, 1710-1785 MHz dhe 1805-1880 MHz për sistemet celulare tokësore UMTS, LTE , WiMAX dhe IoT
ERC/DEC/(95)03	Vendimi për harmonizimin e shfrytëzimit të brezit të frekuencave 1710-1785/1805-1880 MHz për GSM/DCS1800.
ECC/REC/(05)08	Planifikimi i frekuencave dhe koordinimet ndërkufitare ndërmjet sistemeve te Lëvizshme tokësore GSM (GSM 900, GSM 1800, and GSM-R)
ECC/REC(08)02	Planifikimi dhe koordinim i radio frekuencave për sistemet e lëvizshme tokësore që operojnë në brezet 900 dhe 1800 MHz

3.6 Brezi 2100 MHz

Brezi i frekuencave 1920-1980/2110-2170 MHz është i planifikuar dhe përcaktuar për rrjetat e komunikimeve mobile/fikse MFCN, duke përfshirë edhe sistemet IMT. Ndarja e kanaleve dhe kushtet e përdorimit janë në përputhje me vendimin ECC/DEC/(06)01 dhe rekomandimin ERC/REC/(01)01 si dhe duke u referuar në standardin e ETSI EN 301 908.

Sasia e spektrit të disponueshëm në brezin 2100 MHz është 2x60 MHz i çiftuar dhe 1x20 MHz i paçiftuar.
Brezi organizohet në blloqe minimale prej 5 MHz dhe mundqë të shfrytëzohet me ndarje duplekse Frequency Division Duplex - FDD. Brezi 1920-1980 MHz shfrytëzohet për Uplink kurse brezi 2110-2170 MHz shfrytëzohet Downlink. Diferenca në mes të frekuencave transmetuese dhe marrëse për Stacionet bazë (FB) dhe ato të lëvizshme (ML) është 190 MHz.



Në rast të aplikimeve FDD:
- frekuencat e transmetimit të stacioneve bazë janë në brezat 2 110-2 170 MHz,
- frekuencat e transmetimit të stacioneve të levizshme janë në brezin 1 920-1 980 MHz
- hapesira “duplex” është 190 MHz
- hapësira e një kanali nominal është 5 MHz

Në rast të aplikimeve TDD:
- hapësira e një kanali nominal është 5 MHz

Përcaktimi i frekuencave bartëse, për gjerësi kanali 5 MHz, në brezat e mësipërm të frekuencave përcaktohet sipas Specifikimeve teknike të 3GPP (3rd Generation Partnership Project).
Frekuencat bartëse përcaktohen sipas UARFCN (UTRA Absolute Radio Frequency Channel Number). Për çdo brez, UARFCN, përcaktohet sipas formulave:

Për Up link : Nup = 5* (Ful - Ful_Offset); dhe
Për Down Link: Ndown= 5* (Fdown – Fdl_Offset)

Në rast përdorimi të frekuencave në hapesirat kufitare, autoritetet garantojnë autorizimet vetëm për frekuencat e atyre stacioneve të cilët plotësojnë kushtet të parashikuara në dokumentat e koordinimit ndërkombëtar përkatës.

Në shumicën e vendeve evropiane, brezi i frekuencave 2100 MHz u dha dhe u vu në përdorim për ofrimin e shërbimeve UMTS/IMT-2000 në fillim të viteve 2000. Në disa vende, sistemet UMTS (3G)

në brezin e frekuencave 1920–1980/2110–2170 MHz tashmë janë hequr gradualisht dhe ky brez përdoret zakonisht nga operatorët celularë për sistemet LTE/IMT-Advanced dhe 5G/IMT-2020, duke marrë parasysh kërkesën e konsumatorëve dhe parimin e neutralitetit teknologjik.

Gjerësia minimale e brezit e nevojshme për implementimin e sisteme:
- UMTS: 5 MHz
- LTE (përfshirë LTE-MTC and LTE-eMTC): 5 MHz, 10 MHz, 15 MHz, 20 MHz
- NB-IoT: 200 kHz 5
- NR: 5 MHz, 10 MHz, 15 MHz, 20 MHz

Tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 2100 MHz:

ECC/DEC/(06)01	Shfrytëzimi i harmonizuar i brezave 1920-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz për komunikime celulare/fikse rrjetet (MFCN) duke përfshirë sistemet tokësore IMT.
ERC/REC 01-01	Koordinimi ndërkufitar për komunikimet mobile/fikse rrjetet (MFCN) në brezat e frekuencave: 1920-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz.

3.7 Brezi 2300 MHz

Në Planin Kombëtar të Frekuencave, brezi 2300 – 2400 MHz është caktuar edhe për shërbime të lëvizshme, si përdorim kryesor, përkrah shërbimeve të tjera në bazë primare dhe sekondare.

Ky brez mund të shfrytëzohet për rrjetat e komunikimeve mobile/fikse MFCN.
Ndarja e kanaleve dhe kushtet e përdorimit janë mbështetur në vendimin ECC/DEC/(14)02 dhe rekomandimin ECC/REC/(14)04.

Brezi i frekuencave 2300 – 2400 MHz me gjerësi të brezit të frekuencave prej 100 MHz është përcaktuar që të shfrytëzohet sipas teknikës me ndarje duplekse kohore (Time Division Duplex - TDD).

Brezi i frekuencave 2300 – 2400 MHz për teknikën TDD ndahet në 20 blloqe jo të çiftuara të frekuencave me gjerësi 5 MHz. Paraqitja grafike dhe kufijtë e blloqeve frekuencore me nga 5 MHz janë dhënë në figurën dhe tabelën si më poshtë:

2300-2305	2305-2310	2310-2315	2315-2320	2320-2325	2325-2330	2330-2335	2335-2340	2340-2345	2345-2350	2350-2355	2355-2360	2360-2365	2365-2370	2370-2375	2375-2380	2380-2385	2385-2390	2390-2395	2395-2400
K 1	K 2	K 3	K 4	K 5	K 6	K 7	K 8	K 9	K 10	K 11	K 12	K 13	K 14	K 15	K 16	K 17	K 18	K 19	K 20
TDD 20 blloqe me gjerësi 5 MHz																			

Paraqitja grafike e shpërndarjes së brezit të frekuencave 2300 – 2400 MHz për sistemet MFCN

Tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 2300 MHz:

ECC/DEC/(14)02	Kushtet e harmonizuara teknike dhe rregullatore për përdorimin e brezit 2300-2400 MHz për rrjetet e komunikimit mobile/fiks (MFCN)
ECC/REC/(14)04	Koordinimi ndërkufitar për rrjetet e komunikimit mobil/fiks (MFCN) dhe ndërmjet MFCN dhe sistemeve të tjera në brezin e frekuencave 2300-2400 MHz.

3.8 Brezi 2600 MHz


Në Planin Kombëtar të Frekuencave, brezi 2500 – 2690 MHz është caktuar edhe për shërbime të lëvizshme, si përdorim kryesor, përkrah shërbimeve të tjera në bazë primare dhe sekondare.

Sasia e spektrit të disponueshëm në brezin e frekuencave 2500-2570/2620-2690 MHz për ofrimin e shërbimeve MFCN është 2x70 MHz (spektër i çiftuar) dhe 1x50 MHz (spektër i paçiftuar).

Brezat 2520 – 2570 MHz i çiftuar me 2620 – 2690 MHz do të alokohen për mënyrën e operimit FDD (Frequency Division Duplex) ku brezi më i ulët duhet të jetë i alokuar për transmetuesin e lëvizshëm brenda brezit më të ulët të frekuencave dhe transmetuesi bazë brenda brezit të sipërm.

Për teknikën FDD, brezi 2500-2570 MHz shfrytëzohet për Uplink, kurse brezi 2620-2690 MHz shfrytëzohet Downlink. Diferenca në mes të frekuencave transmetuese dhe marrëse për Stacionet bazë (FB) dhe ato të lëvizshme (ML) është 120 MHz.

Brezi 2570 – 2620 MHz do të alokohet ose për mënyrën e operimit TDD ose FDD ku blloqet e alokuara të frekuencave duhet të jenë shumëfisha të 5 MHz.






Tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 2600 MHz:

ECC/DEC/(05)05	Vendimi në harmonizimin e shfrytëzimit të spektrit për sistemet Rrjetat e Komunikimit të Lëvizshëm /Fiks (MFCN) duke operuar në brezin e frekuencave 2500 - 2690 MHz.
ECC/REC/(11)05	Koordinimi ndërkufitar për rrjetat mobile/fikse të radio komunikimit (MFCN) në brezin e frekuencave 2500-2690MHz.
ECC/DEC/(02)06	Përcaktimi i brezit të frekuencës 2500 – 2690 MHz për UMTS/IMT-2000

Kushtet për përdorimin e këtij brezi duhet të jenë në përputhje edhe me Vendimin e Komisionit te 2008/477/EC "*On the harmonisation of the 2500-2690 MHz frequency band for terrestrial systems capable of providing electronic communications services in the Community*" i ndryshuar me Vendimin 2020/636/EC, datë 8 maj 2020, dhe standartin EN 301 908 dhe EN 302 544.

3.9 Brezi 3400-3800 MHz


Në Planin Kombëtar të Frekuencave, përcaktimet kryesore për brezin e frekuencave 3400-3800 MHz, janë:

- Spektri 3400-3800 MHz, lejohet për disa lloje përdorimesh duke përfshirë edhe për rrjete MFCN (Mobile/Fixed Communication Networks), pra edhe rrjete të gjeneratës së re 5G.
- Pjesa e spektrit 3400-3600 MHz, është përcaktuar për përdorim Qeveritar/Civil, lejohet përdorimi për rrjete MFCN, për Sisteme Fikse Satelitore (FSS) dhe Radiovendndodhje (ushtarake), për PMSE (Evente speciale të përkohshme), etj.
- Pjesa e spektrit 3600-3800 MHz, është përcaktuar për përdorim Civil dhe lejohet për MFCN, për aplikime vendndodhje për Shërbimet e Emergjencës LAES (stafin gjurmues që i përket zjarrfikësve dhe shërbimeve të tjera emergjente, të cilët duhet të punojnë përkohësisht në situata të rrezikshme), etj. Brezi i frekuencave 3400- 3600 MHz dhe 3600-3800 MHz është përcaktuar edhe për ofrimin shërbimeve të lëvizshme MFCN, përkrah shërbimeve të tjera në bazë primare dhe sekondare.

Vendimi CEPT/ECC 11 (06), datë 09.11.2011, i ndryshuar datë 26.10.2018, përcakton rregullimet e harmonizuara të frekuencave dhe kushtet teknike kufizuese për rrjetet e komunikimit celular/fiks (MFCN) që funksionojnë në brezin 3400-3800 MHz.

Përcaktimet kryesore të këtij vendimi janë:

- Administratat e CEPT-it do të caktojnë brezin e frekuencës 3400-3800 MHz mbi një bazë joekskluzive për rrjetet e komunikimit celular/fiks (MFCN);
- Administratat që dëshirojnë të zbatojnë MFCN në brezin 3400-3800 MHz duhet të ndjekin rregullimi e frekuencës te dhënë në Aneksin 1 të këtij vendimi;
- Rregullimi i frekuencave do të jetë TDD, i bazuar në një madhësi blloku prej 5 MHz duke filluar nga më e ulëta, skaji i brezit në 3400 MHz:



Brezi 3400-3600 MHz i alokuar sipas mënyrës së operimit TDD.

- Administratat që dëshirojnë të zbatojnë MFCN në brezin 3400-3800 MHz duhet të ndjekin kushtet teknike më pak kufizuese të përshtatshme për MFCN, të dhëna në Aneksin 2, të këtij vendimi;
- Administratat duhet të konsiderojnë lehtësimin e migrimit brenda brezit të frekuencës 3400-3800 MHz e rrjeteve ekzistuese tokësore dhe autorizimet për rregullimin e frekuencës dhe kushtet teknike më pak kufizuese të përshkruara në anekset 1 dhe 2;
- Administratat të zbatojnë parimet kyçe që lidhen me bashkëjetesën me shërbimet ndryshe nga MFCN siç përshkruhet në Shtojcën te ketij vendimi.

Vendimi CEPT/ECC 11 (06), datë 09.11.2011, i ndryshuar datë 26.10.2018, është në fuqi dhe është i përfshirë në vendimet që zbatohen në Planin Kombëtar të Frekuencave.

Në një nga dokumentet zyrtare të CEPT (Report 49), cilësohet që CEPT ka vendosur që në brezin 3400-3800 MHz, të përdoren sasi spektri me pjesë prej 5 MHz. CEPT konsideroi se teknikisht, spektri i licencuar për MFCN duhet caktuar në shumëfisha të 5 MHz, përveç rastit kur ka përdorues ekzistues në këtë brez.

Kjo madhësi blloku 5 MHz, mundëson, nëpërmjet kombinimit të blloqeve ngjitur, të përdorë gjerësi bande më të mëdha të kanaleve, duke krijuar mundësi për të ofruar shpejtësi të lartë të të dhënave për IMT (veçanërisht me IMT-Advanced).

Gjerësia e brezit të kanalit, si p.sh 10, 20 dhe 40 MHz ose më shumë, që mund të caktohen në brezat 3400-3600 MHz dhe 3600-3800 MHz, do të mundësojë shpejtësi më të larta të të dhënave.

Vendimi i Komisionit Europian EU 2019/235 i datës 24 janar 2019, përcakton kushtet teknike përkatëse të zbatueshme për brezin e frekuencave 3400-3800 MHz dhe ndryshon Vendimin e mëparshëm 2008/411/EC.

Përcaktimet kryesore të këtij vendimi, janë:

Brenda brezit të frekuencave 3400-3800 MHz:

- Sasia e spektrit të disponueshëm në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz për ofrimin e shërbimeve MFCN është 400 MHz (spektër i paçiftuar).
- Mënyra e funksionimit dupleks: duhet të jetë dupleksi i ndarjes në kohë (TDD);
- Madhësitë e caktuara të bllokut duhet të jenë në shumëfisha të 5 MHz. Kufiri i poshtëm i frekuencës së një blloku të caktuar do të jetë në linjë ose i ndarë në shumëfisha të 5 MHz nga skaji i brezit të poshtëm prej 3400 MHz;
- Do të ketë spektër të disponueshëm që ofron mundësinë për të hyrë në pjesë të mëdha të spektrit, mundësisht 80-100 MHz, për shërbimet e komunikimit elektronik me brez të gjerë pa tela;
- Transmetimi i stacioneve bazë dhe stacioneve terminale duhet të jetë në përputhje me kushtet teknike të specifikuara në pjesën C dhe pjesën D, të këtij vendimi.

Në rastin e operimit FDD, blloqet do të jenë 5 MHz duke filluar nga kufiri më i ulët 3410 MHz. Nën brezat 3410-3490 MHz përdoren për Uplink dhe nën brezat 3510-3590 MHz përdoret për downlink. Duplex Gap është 20 MHz (3490-3510 MHz).
Nqs blloqet do të duhen të kompesohen për të mundësuar përdorimin nga përdorues të rinj, rasteri duhet të jetë 100 kHz. Blloqet më të ngushta mund të identifikohen si fqinje me përdoruesit e tjerë, për të lejuar përdorimin e plotë të spektrit. Blloqet e shumëfishta fqinje prej 5 MHz mund të kombinohen për të përfituar kanal më të gjerë.




Figura 2:- Brezi 3400-3600 MHz i alokuar sipas mënyrës së operimit FDD.

Brezi 3600- 3800 MHz do të alokohet për mënyrën e operimit TDD, bazuar në blloqe 5 MHz duke filluar nga kufiri më i ulët 3600 MHz. Nqs blloqet do të duhen të kompesohen për të mundësuar përdorimin nga përdorues të rinj, rasteri duhet të jetë 100 kHz. Blloqet më të ngushta mund të identifikohen si fqinje me përdoruesit e tjerë, për të lejuar përdorimin e plotë të spektrit. Gjithashtu duhet të theksohet se TDD në një rast ekstrem mund të mbulojë operimin downlink. Blloqet e shumëfishta fqinje prej 5 MHz mund të kombinohen për të përfituar kanal më të gjerë.

Raporti 100 ECC dhe Raporti ITU-R M.2109 kanë treguar që nuk ekziston përputhshmëri teknike midis operimit FSS dhe MS në të njëjtjën zonë gjeografike dhe kjo kërkoi që distanca e ndarjes së kanaleve të përbashkët të jetë e madhe. Gjithashtu duke konsideruar studimet e bëra nga JTG për

sistemet IMT sic dhe reflektohen në Raportin ITU-R S.2368, parametrat e reja të IMT nuk ndryshojnë përfundimet e studimeve të mëparshme.

Tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 3400 - 3800 MHz:

ECC/DEC/(11)06	Rregullimi i harmonizuar i frekuencave dhe kushtet teknike me më së paku kufizime (LRTC) për rrjetat e komunikimeve mobile/fikse (MFCN) që operojnë në brezin 3400-3800 MHz
ECC/REC(15)01	Koordinimi ndërkufitar për Rrjetet e komunikimeve mobile/fikse (MFCN) në brezat e frekuencave: 694-790 MHz, 1427-1518 MHz dhe 3400-3800 MHz.
ECC/REC/(20)03	Struktura kornizash për të lehtësuar koordinimin ndërkufitar të TDD MFCN në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz
2019/235/EU	Vendimi i Komisionit Evropian në lidhje me një përditësim të kushteve teknike përkatëse të zbatueshme për brezin e frekuencës 3400-3800 MHz.

si dhe Vendimet ECC/CEPT 21(01)/2021, ECC/CEPT 21(02)/2021, EU 2019/235, etj dhe standardet EN dhe shtetërore përkatëse për këtë brez frekuencash, si dhe çdo ndryshim të tyre.

3.10 Brezi 26 GHz

Përcaktimet për përdorimin e brezit 26 GHz (24.25 - 27.5 GHz).


Në Planin Kombëtar të Frekuencave ky brez është përcaktuar për aplikimet Radioteleviziv dhe i lëvizshëm me brez të gjerë MFCN në përputhje me vendimin dhe rekomandimin ECC Decision (18)06.

Në brezin 26 GHz, MFCN do të ketë përdorim kryesisht për hotspot në zonat urbane dhe periferike. Vendosja e MFCN pritet të synojë vetëm qelizat me një rreze të vogël mbulimi. Për shkak të karakteristikave të frekuence, ky brez nuk pritet që do të përdoret për mbulim të gjerë/mbarëkombëtar. Mund të ketë nevojë për një numër të limituar hotspot në zonat rurale. MFCN tek brezi 26 GHz mund të implementohet si brenda (indoor) ashtu edhe jashtë (outdoor).

Përcaktimet për mënyrën e shfrytëzimit të brezit 26 GHz (24.25 - 27.5 GHz).

Brezi i frekuencave 24.25-27.5 GHz me gjerësi të brezit të frekuencave prej 3250 MHz është përcaktuar që të shfrytëzohet me ndarje duplekse kohore (Time Division Duplex - TDD).

Brezi i frekuencave 24.25-27.5 GHz për sistemet MFCN ndahet në 16 blloqe jo të çiftuara të radio frekuencave me gjerësi 200 MHz.



Shembull i përcaktimit të frekuencave në brezin 24.25-27.5 GHz

Kjo madhësi e bllokut mund të rregullohet në blloqe më të ngushtë (shumëfish të 50 MHz) ngjitur me përdoruesit e tjerë, për të lejuar përdorimi i plotë i spektrit.

Nëse blloqet duhet të kompensohen për të akomoduar përdorime të tjera, ky zhvendosje duhet të bëhet në hapa 10 MHz.

Tabela përmbledhëse e listës së dokumentave kryesore të CEPT për brezin 26 GHz:

ECC/DEC/(18)06	Kushtet teknike të harmonizuara për rrjetet e komunikimit mobil/fiks (MFCN) në brezin 24,25-27,5 GHz.
ECC/REC/(23)02	Koordinimi ndërkufitar për rrjetet e komunikimit mobil/fiks (MFCN) në brezin e frekuencave 24.25-27.5 GHz.

Dhënia në përdorim e këtij brezi do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI 4

4. BREZAT E FREKUENCAVE DERI 1 GHz (50-921 MHz)

Plani Kombetar i Frekuencave përcakton spektrin e frekuencave radio mbi 30 MHz deri 1 GHz me emërtimet:

HF – High Frequence , brezi 3-30 MHz.
VHF – Very High Frequence, brezi 30-300 MHz
UHF – Ultra High Frequence, brezi 300 MHz -1 GHz.

në të cilët, sipas Radio Rregulloreve (RR) të ITU ofrohen shërbimet radio:

Aeronautik (*navigacion, mbikëqyrje, emergjence*).
Broadcast (*Difuzion (Tokësor, SAP/SAB dhe ENG/OB*).;
Shërbimi i levizshëm tokësor (*PMR/PAMR, Paxhing,GSM900, kordless*).
Shërbimi detar (*GDMSS, komunikim, navigacion*,)
Alarm
Aplikime ne linjat hekurudhore.
Zbulimin e viktimave, SDR.
Aplikime në shëndetsi
Model Kontroll
SDR jo të specifikuar (*Non –specific SDR*);
Radio mikrofon, pajisje për dëgjimi,
RFID Aplikime audio (*Cordless headphones and loudspeakers, Baby monitoring, Narrowbrez analogue voice devices, Brez II LP)*
Aplikime UWB (GPR/WPR)
Amator
CB Radio

Kushtet teknike për pajisjet radio që duhet të përdoren janë standartet ETSI EN 300 086, EN 300 113, EN 300 219, EN 300 296, EN 300 341, EN 300 390 ,EN 300 471, EN 300 392, EN 300 396, EN 301 166, EN 302 561, EN 301 449, EN 301 526, EN 302 426, EN 302 561 .

Maksimumi i lejuar i devijimit të frekuencës për emisionin F3E ose G3E dhe gjërësi të kanaleve me 12.5 kHz, është ±2.5 kHz dhe për kanalet me gjërësi kanali 25 kHz, maksimumi i lejuar i devijimit të frekuencës është ±5 kHz.
Ndjeshmëria reference e marrësit nuk duhet ti kaloje 2 μV (ems).
Në shërbimin e lëvizshëm tokësor duhet të përdoren antena me polarizim vertikal.
Maksimumi i lejuar i fuqisë efektive të rrezatuar ERP nuk duhet të kalojë:

- 50 W për stacionet baze
- 10 W për stacionet të instaluar në automjete.
- W për stacionet e dorës (portable, handhold).

Mënyra e përdorimit të pajisjeve varet nga brezi i frekuencave dhe konfigurimi i terrenit ku shërbimi i radiokomunikimit do të përdoret. Mënyrat e mundëshme të operimit janë :

- Simpleks (S);
- Gjysëm dupleks(SD)
- Dupleks (D)
- Kombinimi i të dyja mënyrave të operimit.

Fuqia minimale e fushës për sistemet me brez të ngushtë (deri 25 kHz), që është e mbrojtur në 50 % të vendodhjes, 10% koha, për lartësia e antenës se marrësit 10 m është:

- 0 dB (μV/m) për frekuenca midis 29.7 dhe 47 MHz;
- 6 dB (μV/m) per frekuenca midis 47 dhe 108 MHz;
- 12 dB (μV/m) per frekuenca midis 108 dhe 380MHz;
- 18 dB (μV/m) per frekuenca midis 380 dhe 400 MHz;
- 20 dB (μV/m) per frekuenca midis 400 dhe 606 MHz;
- 26 dB (μV/m) per frekuenca midis 606 dhe 921 MHz.

Per sisteme dixhitale me breze te gjere (gjeresia e kanalit; > 25 kHz) vlera e x log10 (gjeresia e kanalit /25 kHz)dB, duhet te futet ne vlerat e mesiperme. Kjo formule eshte e vlefshme per 25 kHz, 200 kHz dhe 1.25 MHz.

Brezi (406.1 – 470) MHz i përcaktuar për shërbimet e lëvizshme tokësore, mund të përdoret për sistemet numerike (dixhitale) PMR/PAMR, me brez të ngushtë, me gjerësi kanali 12.5 KHz dhe 25 kHz, sipas vendimeve ECC/DEC/(06)06, ECC/DEC/ (08)05 dhe ECC/DEC /(04)06 shtuar dhe standardeve ETSI EN 300 113, EN 300 392 , EN 300 396 EN 300 086, EN 300 219, EN 300 296, EN 300 341, EN 300 471, EN 301 166, EN 302 561,EN 300 390, EN 301 449, EN 301 526, EN 302 426, EN 302 561 shtuar.

Ndarja e kanaleve:
Sipas rekomandimit Rec. T/R 25-08, për përdorimin e kanaleve me brez të ngushtë, deri në 25 kHz, për sistemet analoge dhe ata numerike, ndarja e kanaleve bëhet sipas formulës:

fn = Skaji i brezit – (gjërësi kanali / 2) + n* (gërësi kanali);

ku:

fn = frekuenca qëndrore e kanalit

n= 1,2,3…..- numri i kanalit;

Skaji i brezit – vlera më e ulët e frekuencës së brezit, përcaktuar në MHz, p.sh 48, 68, 146, 174, 380, 406.1, …

Vërejtje:
Aktualisht ne Republikën e Shqipërisë për ndarjen e kanaleve, caktimin e frekuencës qëndrore, të kanalit radio, përdoret formula:

fn= Skaji i brezit + n* gjeresia e kanalit;

kuptimi i fn, skajit dhe n janë njëlloj si më sipër.

Për sistemet numerike për kanalet radio me gjërësi më të madhe se 25 kHz, dmth 50 kHz, 100 kHz, 150 kHz dhe 200 kHz dixhitale me brez të gjërë;.

- frekuenca qëndore për gjërësi kanali: 50 kHz, 100 kHz ose 150 kHz duhet të përcaktohet nga formulat e mesiperme;
- frekuenca qëndore për gjërësi kanali 200 kHz do të përcaktohet sipas formulave të mësiperme, me nje opsion 'offset' te qendres se frekuences nga 100 kHz.
- frekuenca qëndore për gjërësi kanali prej 1.25 MHz do të përcaktohet nga formulat e mesipërme me një opsion vendosje të qëndrës së frekuencës si shumëfishe të 12.5 kHz, në mënyrë që të sigurohet fleksibiliteti për caktimin e frekuencës qëndrore në pozicionin me optimal të brezit.

4.1 Brezi (68 – 87.5) MHz

Në brezin dupleks 68 – 87.5 MHz gjërësia (Tx/ Rx) është 9.8 MHz. Brezi 68.8 – 87.5 MHz do të caktohet për shërbimet e lëvizshme tokësore, përdorim parësor, përveç nën- brezit (74.8 - 75.2) MHz, që është përcaktuar për radio navigimet aeronautike (ILS).
Gjithë ky brez është caktuar për përdorim qeveritar.

4.2 Brezi (146 – 174) MHz (VHF)

Brezi i frekuencave (146 – 174) MHz, i ndarë në nënbreza dhe është parashikuar për përdorim simpleks dhe dupleks (gjysëm dupleks), me diference Tx-Rx=4.6 MHz sipas rekomandimit T/R 25-08.
Pjesë të këtij brezi janë caktuar për përdorim qeveritar.

Nënbrezat e mëposhtëm të këtij brezi:

156.0-157.45; 160.6-160.975 dhe 161.475-162.05 MHz,
Në bazë të Artikullin 31 dhe 52, Shtojca 13 dhe 18, e Radio Rregulloreve (RR) të ITU janë caktuara për shërbimet e lëvizshëm detar.

Në këtë brez të frekuencave, në bazë të vendimit ECC/DEC/(05)02 dhe ERC/REC 70-03 përfshihet nënbrezi (169.400–169.8125) MHz, i cili përvec përdorimit për PMR, duhet te përdoret, me fuqi të vogël të transmetimit, deri 0.5 W, për :

- Ndihmë për personat me aftësi dëgjimi të dobët; përdorim ekskluziv.
- Alarme social; përdorim ekskluziv.
- Sisteme për transmetim të të dhënave të matjeve (përdorim jo-ekskluziv);
- Transmetim me fuqi të vogël për sistemet e shoqërimit (Low power transmitters for tracking and asset tracing systems), përdorim jo-ekskluziv.

4.3 Brezi (380.0 – 399.9) MHz

Ky brez ndahet në dy nënbreza:
1) 380.000–385.000 MHz (ML1) / 390.000–395.000 MHz (FB1);
2) 385.000–390.000 MHz (ML1) / 395.000–399.900 MHz (FB2);

Brezi (380–385/390 –395) MHz, i caktuar për sistemet numerike të lëvizshme tokësore (TETRA) për përdorim qeveritar dhe civil, për shërbimet e emergjencës (policia, zjarrëfikesit, ambulance etj). Kushtet për përdorimin janë në përputhje me vendimet dhe rekomandimet, ECC/DEC/ (08)05, ECC/DEC/ (06)05, ERC/DEC/(01)19 dhe T/R 25-08 si dhe standardet e ETSI EN 300 113; EN 300 390; EN 302 561.

Nënbrezi 385-390/395-399.9 MHz caktohen për sistemet dixhitale të lëvizshme tokësore (TETRA) për përdorim civil. Kushtet për përdorim jepen në vendimet dhe rekomandimet ECC/DEC/ (08)05, ECC/DEC/ (06)05, ERC/DEC/(01)19 dhe T/R 25-08 si dhe standardet e ETSI EN 300 113; EN 300 390; EN 302 561.

Nënbrezi (380.000–380.150) dhe (390.000–390.150) MHz, përcaktohen për përdorim DMO (direct mode operation) të sistemeve numerike të lëvizshme tokësor, për shërbimet e emergjencës, për përdorim kombëtar dhe ndërkufitar, në koordinim me vëndet fqinjë.
Kushtet për përdorim jane sipas vendimit ERC DEC (01)19 ,ECC/DEC/ (08)05, ECC/DEC/ (06)05, T/R 25-08 dhe standardet ETSI EN 300 113, EN 300 390 dhe EN 302 561 .

Nën brezi (384.800–385.000) MHz dhe (394.800–395.000) MHz, përdoret për sisteme numerike të lëvizshme tokësor, për shërbime emergjence, për operimet Ajër – Tokë –Ajër (AGA Air–Ground–Air) për objekte që fluturojnë në lartësi të ulëta.
Kushtet e përdorimit jane në vendimin ERC DEC (06)05 , ECC/DEC/ (08)05, ERC/DEC/(01)19 dhe T/R 25-08 si dhe standardet e ETSI EN 300 113; EN 300 390; EN 302 561 .

4.4 Brezi 406.1 – 430 MHz

Ky brez frekuencash ndahet në dy nënbreza:

- (406.1- 410) për përdorim simpleks
- (410-420) / (420-430) MHz për përdorim dupleks.

Në brezin (410 – 420)/(420 - 430 MHz) gjerësia duplekse (Tx/Rx) është 10 MHz dhe caktohet për sisteme dixhitale të levizshme tokësore (TETRA) për perdorim ushtarak dhe civil.
Kushtet e përdorimit janë në përputhje me Vendimin ERC DEC (96)04 dhe standartet ETSI EN 303 035.
Këto breza përcaktohen përdorim dixhitale në shërbimin e lëvizshëm tokësor me brez të gjërë (PMR/PAMR) në përputhje me vendimet dhe rekomandimet ECC DEC (04)06, i amenduar, ECC/DEC/(08)05, ECC/DEC/ (08)05 ,T/R 25-08; ECC/DEC/ (06)06; EN 300 086; EN 300 113; EN 300 219; EN 300 296; EN 300 341; EN 300 390; EN 300 471; EN 301 166; EN 302 561 ; EN 301 449, EN 301 526, EN 302 426 .

4.5 Brezi (440 – 470) MHz

Ky brez frekuencash ndahet në dy nënbreza:

- (440.0 – 450.0) për përdorim simpleks
- (450 – 460.0) / (460.0-470.0) MHz për përdorim dupleks me diferencë Tx-Rx=10 MHz.

Ky brez i frekuencave përdorët për sistemet PMR, PAMR dhe TETRA.

Nën brezat e këtij brezi:
(446.0 – 446.1) MHz; për transmetim/marrje me modulim analog - PMR446
(446.1- 446.2) MHz, për transmetim/marrje modulim numerik.- DPMR 446.

Përdoren për stacione portative me fuqi të vogël, antenë të integruar, pa përdorim të stacionit bazë, për përdorim individual dhe me rreze të shkurtër të zonës se komunikimit zanor.
Përdorimi i këtyre nënbrezave të frekuencave me pajisjet përkatëse bëhet pa autorizim individual.
Gjërësia e kanaleve radio, për nënbrezin e parë është - 12.5 kHz, kurse për nënbrezin e dytë mund të jetë 12.5 ose 6.25 kHz.

4.6 Brezi (876 – 880 MHz) / (921 – 925) MHz

Është brez i caktuar për sistemet numerike të lëvizshme tokësore për trafikun hekurudhor (UIC). Në këtë brez operojnë dhe sistemet DMO- Direct Mode Operation.
Sistemet për trafikun ndërkombëtar dhe kombëtar të trenave operojnë me hapësirën duplekse 45 MHz; në brezin (876-880 MHz), stacionet e lëvizshme, çiftuar me (921 – 925 MHz), stacionet baze) ose me mënyrën simpleks, DMO, me gjërësi të kanalit 12 kHz, në brezin (876.000-876.100).
Kushtet per perdorimin dhe caktimin e kanaleve do te zgjidhen me vendimin ECC DEC (02)05 dhe standartet ETSI EN 301 502, EN 301 511 per GSM-R dhe EN300 086 per DMO.

Tabela me brezat e frekuencave nga 50 MHz deri 921 MHz.

Rekomandimi Rec. T/R 25-08, përfshin brezat e frekuencave sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Brezi MHz	Brezi frek (MHz)	Mënyra e përdorimit [1]		Dif. Tx-Rx (MHz)	
			Simpleks	Dupleks (ML/FB)	Simpl	Dupl.
1	50	29.7-54.0	29.7-54.0		n/a	
2	60	54.0-68.0		(54-61) / (61-68)	n/a	7
3	80	68.0 -87.5	(74.8-75.2) *	(68-74.8) /(77.8-84.6)	n/a	9.8

			77.7-77.8	(75.2-77.7) /(85.0-87.5)		
			84.6-85.0			
4	160	146.0-174.0	(146-146.8)	(146.8-149.9)/(151.4-154.5)	n/a	4.6
			(149.9-150.05)			
			(154.5-154.65)	(150.05-151.4)/(154.65-156.0)		
			(156.0-157.45)**			
			(160.6-160.975)**	(157.45-160.6)/(162.05-165.2)		
			(160.975-161.475)			
			(161.475-162.05)**	(165.225-169.4)/(169.825-174)		
			(166.2-166.225)			
			(169.4-169.825)			
5	200	174.0 -230	174.0-175.5	(183.5-191.5)/(175.5-183.5) (191.5-199.5)/(199.5-207.5) (215.5-223.5)/(207.5-215.5)	n/a	8
			223.5-230.0			
6	390	380.0 – 399.9	389.9-390	(380.0-385.0) /(390.0-395.0)	n/a	10
				(385.0-389.9) / (395.0-399.9)		
7	420	406.1-430.0	406.1-410	(410.0-420.0)/(420.0-430.0)	n/a	10
8	460	450.0-470.0	440.0-450.0	(450.0-460.0)/ (460.0-470.0)	n/a	10
9	900	862.0- 876.0 dhe 915.0-921.0	862.0-870.0	(870.0-876.0) / (915.0-921.0)	n/a	45

Shënim:

[1]) Jo i gjithë brezi përkatës i frekuencave është i mundur për tu dhënë për përdorim civil. Pjesë të këtyre brezave janë në përdorim nga institucionet shtetërore.

*) Brezi (74.8-75.2) MHz. caktuar për radio navigimet aeronautike (ILS)

**) Brezat 156.0-157.45), (160.6-160.975), (161.475-162.05) MHz, sipas App.18 të RR, përfshihen në Tabelen e frekuencave të transmetimit në brezin VHF për shërbimin e lëvizshëm radiodetar.

Tabela e frekuencave të transmetimit në brezin VHF - detar
(APP. 18 i RR)

Nr.kanalit	Shenim	Frekuenca e transmetim (MHz)		Midis anijeve	Oper, portit me anijet ne levizje		Përdorim për civil.
		Stacioni anijes	Bregdetar Stacioni		Simpleks	Dupleks	
60		156.025	160.625			x	x
01		156.050	160.650			x	x
61		156.075	160.675			x	x
02		156.100	160.700			x	x
62		156.125	160.125			x	x

03		156.150	160.750			x	x
63		156.175	160.775			x	x
04		156.200	160.800			x	x
64		156.225	160.825			x	x
05		156.250	160.850			x	x
65		156.275	160.875			x	x
06	*f*	156.300		x			
66		156.325	160.925			x	x
07		156.350	160.950			x	x
67	*h*	156.375	156.375	x	x		
08		156.400		x			
68		156.425	156.425		x		
09	*I*	156.450	156.450	x	x		
69		156.475	156.475	x	x		
10	*f*	156.500	156.500	x	x		
70	*j*	156.525	156.525	Thirrje selektive numerike për fatkeqësi, shpëtim dhe thuirrje (Digital selective calling for distress, safety and calling) DSC			
11		156.550	156.550		x		
71		156.575	156.575		x		
12		156.600	156.600		x		
72	*i*	156.625		x			
13	*k*	156.650	156.650	x	x		
73	*h*	156.675	156.675	x	x		
14		156.700	156.700		x		
74		156.725	156.725		x		
15	*g*	156.750	156.750	x	x		
75	*n*	156.775			x		
16		156.800	156.800	DSC			
76	*n*	156.825			x		
17	*g*	156.850	156.850	x	x		
77		156.875		x			
18	*m*	156.900	161.500		x	x	x
78		156.925	161.525			x	x
19		156.950	161.550			x	x
79		156.975	161.575			x	x

20		157.000	161.600			x	x
80		157.025	161.625			x	x
21		157.050	161.650			x	x
81		157.075	161.675			x	x
22		157.100	161.700			x	x
82	*m*	157.125	161.725		x	x	x
23		157.150	161.750			x	x
83	*m*	157.175	161.775		x	x	x
24		157.200	161.800			x	x
84	*m*	157.225	161.825		x	x	x
25		157.250	161.850			x	x
85	*m*	157.275	161.875		x	x	x
26		157.300	161.900			x	x
86	*m*	157.325	161.925		x	x	x
27		157.350	161.950			x	x
87		157.375			x		
28		157.400	162.000			x	x
88		157.425			x		
AIS 1	1	161.975	161.975				
AIS 2	1	162.025	162.025				

Shënime të përgjithshme **(**referuar simboleve në Tabelën e mësipërme.)

Këto kanale të frekuencave radio caktohen për komunikim midis anijeve dhe operacioneve portuale, për komunikim stacion bregdetar me anijet në lëvizje, si dhe të avionave dhe helikopterëve, të cilët marrin pjesë në operacionet e mbështetjes detare, për të komunikuar me anijet ose stacionin bregdetar sipas kushteve të specifikuara në S51.69 Nr, S51.73, S51 0,74, S51.75, S51.76, S51.77 dhe S51.78. te RR.

Kanalet radio të cilat janë përcaktuar për përdorim civil, duhet të përdoren vetëm në rastet që nuk shkaktojnë interference në rrjetet e radiokomunikmit detar.

Kanalet e tabelës, me përjashtim të kanaleve të 06, 13, 15, 16, 17, 70, 75 dhe 76, mund të përdoren për transmetim të të dhënave me shpejtësi të lartë, por pa shkaktuar interference, në rrjetet e radiokomunikimit detar.

Kanalet radio të tabelës, me përjashtim të kanaleve të kanaleve 06, 13, 15, 16, 17, 70, 75 dhe 76, mund të përdoren, *rekomandohet kanali 28*, për transmetim telegrafik apo transmetimin e të dhënave, por pa shkaktuar interference, në rrjetet e radiokomunikmit detar.

Këta kanale të frekuencave radio mund të përdoret gjithashtu për të radiokomunikim në lundrimet e brendshëm (liqen dhe lum), sipas kushteve të të S5.226

***Shënime specifike*:**

- Kanali radio (kanali 06) me frekuencë 156,300 MHz (shih Appendix S13, S15 dhe S51.79) mund të përdoret për komunikim mes stacioneve të anijeve dhe stacioneve të avionëve, të angazhuar në operacionet e koordinuar të kërkimit dhe të shpëtimit.
- Kanalet 15 dhe 17 mund të përdoret gjithashtu për të komunikimit on-board, anije dhe aviona, por fuqia efektive e rrezatuar, ERP, nuk duhet të jetë më e madhe se 1 W.
- Për qëllim përdorimi sipas pikës (a), të mësipërme, mund të përdoren kanalet me frekuenca: 156,450 MHz (kanali 09), 156,625 MHz (kanali 72) dhe 156,675 MHz (kanali 73).
- Kanali (70) me frekuencë 156.525 MHz është që do të përdoret ekskluzivisht për thirrjen digjitale selektive DSC për fatkeqsi, siguri dhe thirrje.
- Kanali 13 me frekuencë 156.650 MHz është përcaktuar për përdorim ndërkombëtar, kanal komunikimi për sigurinë e lundrimit, kryesisht për navigacion midis anijeve në lundrim. Mund të përdoret për komunkim midis anijeve në lëvizje gjatë operacioneve portuale, sipas rregullave të përcaktuara.
- Kanalet AIS1 dhe AIS2, janë kanale që përdoren për identifikim automatike të anijes dhe sistemit të mbikqyrjes, i aftë për të siguruar operacion në mbarë botën në det të hapur, përveç frekuencave të tjera janë të caktuara në baza rajonale për këtë qëllim

Vendime ndërkombëtare, rekomandime dhe standarde:

- **T/R 25-08 –** *Kriteret e planifikimit dhe koordinimi ndërkufitar i frekuencave për sistemet e lëvizshme tokësore në intervalin 29,7-470 MHz*
- **ERC/DEC/(01)19 –** *Brezat e frekuencave të harmonizuara për t'u caktuar për Operimin në Mënyrën Direkte (DMO) të Sistemeve të Lëvizshme Tokësore Numerike për Shërbimet e Emergjencave*
- **ECC DEC (04)06 –** *Përdorimi i harmonizuar, përjashtimi nga licencimi individual dhe qarkullimi i lirë i pajisjeve që përdorin teknologjinë Ultra-Wideband (UWB) në brezat nën 10.6 GHz*
- **ECC/DEC/ (06)05 –** *Harmonizimi i brezave të frekuencave për t'u caktuar për operimin Ajër–Tokë–Ajër (AGA) të Sistemeve të Lëvizshme Tokësore Numerike për Shërbimet e Emergjencave*
- **ECC/DEC/ (08)05 –** *Harmonizimi i brezave të frekuencave për implementimin e aplikimeve radio numerike për Mbrojtjen Publike dhe Lehtësimin e Fatkeqësive (PPDR) në brezat brenda diapazonit 380–470 MHz*
- **EN 300 066 –** *Pozicionues emergjence detar satelitor që përcaktojnë radiofarët (EPIRBs) që operojnë në brezin e frekuencës 406,0 MHz në 406,1 MHz*
- **EN 300 086 –** *Shërbimi i Lëvizshëm Tokësor; Radio pajisje me një konektor RF të brendshëm ose të jashtëm për përdorim parësor për komunikime zë analoge.*
- **EN 300 113 –** *Shërbimi i Lëvizshëm Tokësor; Radio pajisje për transmetimet e të dhënave (dhe zë) dhe që kanë një konektor antene.*
- **EN 300 219 –** *Shërbimi i Lëvizshëm Tokësor; Radio pajisje e cila transmeton sinjale për të përfituar një përgjigje specifike në marrës.*
- **EN 300 296 –** *Shërbimi i Lëvizshëm Tokësor; Radio pajisje që përdorin antena integrale*

për përdorim parësor për komunikime zë analoge.

- **EN 300 341 –** *Shërbimi i Lëvizshëm Tokësor; Radio pajisje që përdorin një antenë integrale për të transmetuar sinjale për të përfituar një përgjijgen specifike në marrës.*
- **EN 300 390 –** *Shërbimi i Lëvizshëm Tokësor; Radio pajisje për transmetimin e të dhënave (dhe zë) dhe që përdorin një antenë integrale.*
- **EN 300 396 –** *Kërkesat teknike për operimin me modalitet të drejtpërdrejtë (DMO).*
- **EN 300 471** – *Rregulla për aksesin dhe shpërndarjen, e përdorimit të përbashkët të kanaleve nga pajisje të cilat janë në përputhje me standardin EN 300 113.*
- **EN 301 166 –** *Shërbimi i Lëvizshëm Tokësor; Radio pajisje për komunikimet analoge dhe/ose numerike (zë dhe/ose të dhëna), që operojnë në kanale me brez të ngushtë dhe që kanë një konektor antene.*
- **EN 301 449 –** *Përputhshmëria elektromagnetike dhe çështjet e spektrit të radios (ERM). EN i harmonizuar për stacionet bazë të spektrit të përhapur CDMA që operojnë në brezin celular 450 MHz (CDMA 450) dhe brezat PAMR 410, 450 dhe 870 MHz (CDMA-PAMR) që mbulojnë kërkesat thelbësore të nenit 3.2 të Direktivës R&TTE*
- **EN 301 502 –** *Sistemi global për komunikimet e lëvizshme (GSM); Radio pajisje bazë dhe përsëritës.*
- **EN 301 511 –** *Stacionet e lëvizshme në brezat GSM 900 dhe GSM 1800.*
- **EN 301 526 –** *Përputhshmëria elektromagnetike dhe çështjet e spektrit të radios (ERM); EN i harmonizuar për stacionet bazë të spektrit të përhapur CDMA që operojnë në brezin celular 450 MHz (CDMA 450) dhe brezat PAMR 410, 450 dhe 870 MHz (CDMA-PAMR) që mbulojnë kërkesat thelbësore të nenit 3.2 të Direktivës R&TTE*
- **EN 302 152 –** *Sinjalizues satelitor personal për pozicionimin (PLBs) që operon në brezin e frekuencave 406.0 MHz to 406.1 MHz.*
- **EN 302 426 –** *Përputhshmëria elektromagnetike dhe çështjet e spektrit të radios (ERM); EN i harmonizuar për përsëritësit e spektrit të përhapur CDMA që operojnë në brezin celular 450 MHz (CDMA450) dhe brezat PAMR 410 MHz, 450 MHz dhe 870 MHz (CDMA-PAMR) që mbulojnë kërkesat thelbësore të nenit 3.2 të Direktivës R&TTE*
- **EN 302 561** – *Radio pajisje që përdorin modulim konstant ose jo–konstant, që operojnë më një gjërësi brezi të kanalit prej 25 kHz, 50 kHz, 100 kHz ose 150 kHz.*

KAPITULLI 5

5. PLANI PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE PËR LIDHJET SATELITORE

5.1 Plani për caktimin dhe përdorimin e frekuencave për lidhjet satelitore fikse

Ky plan do të caktojë kushtet themelore për caktimin dhe shfrytëzimin e radio frekuencave si dhe ndarjen e kanaleve të cilat sipas Planit Kombëtar Frekuencave janë caktuar për shërbimet satelitore fikse në përputhje me rregulloret dhe standardet, si dhe rekomandimet e vendimet ndërkombëtare.

Kushtet themelore për caktimin dhe shfrytëzimin e radio frekuencave për shërbimet satelitore fikse kanë të bëjnë me brezat e mëposhtme:

- 3600 – 4200 MHz
- 5925 – 6425 MHz
- 10.7 – 11.7 GHz
- 12.5 – 12.75 GHz
- 14.0 – 14.5 GHz
- 12.75 – 13.25 GHz
- 13.75 – 14.5 GHz
- 15.43 – 15.63 GHz
- 17.7 – 21.2 GHz

Në brezat e caktuara për shërbimet satelitore fikse duhet të operojnë terminalet VSAT dhe SNG.

VSAT (Very Small Aperture Terminal) është një terminal satelitor me diametër të vogël të antenës deri në 2.4 m, përveç në situata specifike kur antenat e përdorura mund të jenë me diametër deri 5 m. VSAT duhet të përdor transmetim digital me shpejtësi të ulët transmetimi, jo më të madhe se 2 Mbps. Terminalet VSAT duhet të përdoren për komunikime pikë – pikë apo pikë – shumë pika, si pjesë e rrjetit satelitor. Stacioni tokësor qendror (HUB) mund të lidhet me një rrjet publik telekomunikues.

SNG (Satellite News Gathering) është një linjë satelitore e transportueshme që përdoret për grumbullimin e informacioneve për qëllim të transmetimeve broadcast.

Terminalet VSAT duhet të përdorin frekuenca në brezat 14.0 – 14.5 GHz (Tokë – Hapësirë), 10.7– 11.7 GHz dhe 12.5 – 12.75 GHz (Hapësirë – Tokë). Terminalet SNG duhet të përdorin frekuenca në brezat 12.75 – 13.25 GHz dhe 13.75 – 14.5 GHz (Tokë – Hapësirë) si dhe 10.7 – 11.7 GHz dhe 12.5 – 12.75 GHz (Hapësirë – Tokë).

Shfrytëzimi i brezit 14.0 – 14.5 GHz për terminalet VSAT dhe SNG është në pajtueshmëri me rekomandimet ERC/REC 13–03 dhe ERC/REC 11-01, dhe ETSI standardet EN 301 428 dhe EN 301 430.

Vendime ndërkombëtare, rekomandime dhe standarde:

- **ERC/REC 13-03** – *Shfrytëzimi i brezit 14.0 – 14.5 GHz për terminalet me aperturë shumë të vogël (VSAT) dhe grumbullimin satelitor të informacioneve (SNG)*
- **ERC/REC 11-01** – *Aprovimi i tipit për pajisjet e stacioneve satelitore tokësore VSAT dhe SNG.*
- **EN 301 428** – VSAT në brezin 11/12/14 GHz
- **EN 301 430** – SNG në brezin 11/12/14 GHz

5.2 Planifikimi dhe shfrytëzimi i radio frekuencave për shërbimet satelitore të lëvizshme

Ky plan do të caktojë kushtet themelore për caktimin dhe shfrytëzimin e radio frekuencave si dhe ndarjen e kanaleve të cilat sipas Planit Kombëtar të Frekuencave janë caktuar për shërbimet satelitore të levizshme (MSS) në përputhje me rregulloret dhe standardet, si dhe rekomandimet e vendimet ndërkombëtare.

Kushtet themelore për caktimin dhe shfrytëzimin e radio frekuencave për shërbimet satelitore të levizshme kanë të bëjnë me brezat e mëposhtme:

137 – 137.025	MHz	(s – E) (S-PCS)
137.025 – 137.175	MHz	(s– E) (S-PCS)
137.175 – 137.825	MHz	(s – E) (S-PCS)
137.825 – 138	MHz	(s – E) (S-PCS)
148 – 149.9	MHz	(s – E) (S-PCS)
149.9 – 150.05	MHz	(s – E) (S-PCS)
399.9 – 400.05	MHz	(s – E) (S-PCS)
406 – 406.1	MHz	(s – E) (S-PCS)
1515 – 1525	MHz	(s – E)
1525 – 1559	MHz	(s – E)
1610 – 1626.5	MHz	(s – E) (S-PCS)
1626.5 – 1660.5	MHz	(s – E)
1670 – 1675	MHz	(s – E)
2483.5 – 2500	MHz	(s – E) (S-PCS)
1980 – 2010	MHz	(s – E) (S-PCS)
2170 – 2200	MHz	(s – E) (S-PCS)

Në shërbimet satelitore mobile janë futur shërbimet të reja satelitore për përdorues individual (S-PCS). S-PCS janë sisteme komunikuese satelitore personale për transmetimin e zërit dhe të dhënave

në nivel regjional dhe global. Satelitët S-PCS nuk vendosen në orbitat gjeostacionare (LEO, MEO dhe HEO).

5.2.1 Brezi nën 1 GHz

Sistemet S-PCS që operojnë në brezin e frekuencave nën 1 GHz duhet të përdoren për transmetimin e të dhënave, mesazheve, përcaktimin e pozicionit si dhe aplikacione tjera jo- zanore me shpejtësi të ulët transmetimi për përdorues individual, në nivel rajonal apo global.

Kushtet e përdorimit dhe mënyra e shfrytëzimit të brezit nën 1 GHz janë në pajtueshmëri me vendimin ERC/DEC(99)06.

Stacionet për shërbime satelitore të levizshme në brezin 148 – 149.9 MHz nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme apo të kërkojnë mbrojtje nga stacionet për shërbime fikse dhe të lëvizshme.

5.2.2 Brezi mbi 1 GHz

Sistemet S-PCS që operojnë në brezin e frekuencave mbi 1 GHz duhet të përdoren për transmetimin e zërit dhe të dhënave në nivel rajonal apo global.

Kushtet e përdorimit dhe mënyra e shfrytëzimit të brezeve 1610 – 1625.5 MHz/ 2483.5 – 2500 MHz dhe 1980 – 2010 MHz/ 2170 - 2200 MHz janë në përputhje me vendimin ERC/DEC(97)03.

Sistemet S-PCS përdorin modulimin CDMA dhe TDMA por në pjesë të ndryshme të brezave sipas vendimit ERC/DEC(97)03, Aneksi 1 dhe ETSI standardit EN 301 441 dhe EN 301 442.

Operatorët e rrjetit satelitor për shërbime S-PCS duhet të përmbushin kërkesat dhe procedurat e përcaktuara nga vendimi ERC/DEC(97)03, Aneksi 2.

Vendime ndërkombëtare, rekomandime dhe standarde

- **ERC/DEC(99)06** – *Vendimi për futjen e harmonizuar të sistemeve komunikuese satelitore personale që operojnë në brezat frekuencave nën 1 GHz (S-PCS<1 GHz)*
- **ERC/DEC(97)03** – *Vendimi për harmonizimin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave për shërbime komunikuese satelitore personale (S-PCS) që operojnë në brezat 1610 – 1626.5 MHz, 2483.5 – 2500 MHz, 1980 – 2010 MHz dhe 2170 – 2200 MHz*.
- **EN 301 441** – S-PCN në brezin 1.6/2.4 GHz
- **EN 301 442** – S-PCN në brezin 2 GHz

5.3 Brezi 11.7 – 12.5 GHz

Në Planin Kombëtar të Frekuencave brezi 11.7 – 12.5 GHz është caktuar për shërbime fikse, satelitore-broadcasting dhe shërbime të lëvizshme tokësore në baza primare.

Kushtet e përdorimit të brezit frekuencave 11.7 – 12.5 GHz orbitat satelitore gjeostacionare dhe ndarja e kanaleve janë përcaktuar në Konferencën Botërore për Radiokomunikime – WRC 2000 (Aneksi 30 dhe 30A).

Aneksi 30 dhe 30A përmbajnë planet për shërbimet satelitore broadcast (BSS – down link) në brezin 12 GHz (hapësirë – Tokë) dhe planet e linqeve të lidhura furnizuese (Tokë – hapësirë) në shërbimet satelitore fikse (FSS) në brezat 14 GHz dhe 7 GHz për të gjitha shtetet.

Planifikimi i Brezit 11.7 – 12.5 GHz është konfrom Rekomandimit të ITU-R F.746. 4

Vendime ndërkombëtare, rekomandime dhe standarde

- **ANEKSI 30 (WRC 2000)** – *Dispozitat për të gjitha shërbimet dhe Planet dhe Listat që kanë të bëjnë me për shërbime satelitore broadcast në brezat frekuencave 11.7 – 12.2 GHz*
- **ANEKSI 30 A (WRC 2000)** – *Dispozitat dhe Planet dhe Listat që kanë të bëjnë me linket furnizuese për shërbime satelitore broadcast në brezat frekuencave 11.7 – 12.2 GHz*
- **ERC/DEC(03)02** – *Përcaktimi i brezit 1479.5 – 1492 GHz për shërbime satelitore digitale audio broadcasting (S-DAB)*
- **ERC/DEC(00)02** – *përdorimi i brezit 10.7 – 12.5 GHz nga shërbimet fikse dhe stacionet tokësore për shërbime satelitore-broadcast dhe satelitore-fikse (hapësirë – Tokë).*

5.4 Planifikimi dhe shfrytëzimi i radio frekuencave për shërbimet radio amatore dhe radio amatore satelitore

Ky plan do të caktojë kushtet themelore për caktimin dhe shfrytëzimin e radio frekuencave si dhe ndarjen e kanaleve në brezat të cilat sipas Planit Kombëtar të Frekuencave janë caktuar për shërbimet amatore dhe amatore satelitore në pajtueshmëri me rregulloret dhe standardet, si dhe rekomandimet e vendimet ndërkombëtare.

Kushtet themelore për caktimin dhe shfrytëzimin e radio-frekuencave për shërbimet radio amatore dhe radio amatore satelitore kanë të bëjnë me brezat e mëposhtme:

135.7 – 137.8	kHz
1810 – 1850	kHz
3500 – 3800	kHz
7000 – 7200	kHz
10.10 – 10.15	MHz
14.00 – 14.35	MHz
18.068 – 18.168	MHz
21.00 – 21.45	MHz

24.89 – 24.99	MHz
28 – 29.7	MHz
50 – 52	MHz
144 – 146	MHz
432 – 438	MHz
1240 – 1300	MHz
2300 – 2450	MHz
5650 – 5850	MHz
10.00 – 10.50	GHz
24.00 – 24.25	GHz
47 – 47.9	GHz
76 – 81	GHz
122.25 – 123	GHz
134 – 141	GHz
142 – 149	GHz
241 – 250	GHz

Kushtet e përdorimit dhe mënyra e shfrytëzimit të brezave për shërbime radio amatore dhe radio amatore satelitore janë në pajtueshmëri me rekomandimet T/R 61-01, T/R 61-02, ERC/REC 62-01, ITU-RR, Artikulli 25 dhe Rregulloret për shfrytëzimin e radio stacioneve amatore.

Vendime ndërkombëtare, rekomandime dhe standarde:

- **T/R 61-01** – *Licencat Radio Amatore CEPT*
- **T/R 61-02** – *Certifikata e harmonizuar për radio kontroll amator*
- **ERC/REC 62-01** – *Përdorimi i brezit 135.7 – 137.8 kHz nga shërbimet radio amatore*
- **ITU – RR, Artikulli 25**, *Shërbimet Radio Amatore*
- **EN 301 783** – *Stacionet radio amatore*

KAPITULLI 6

6. REKOMANDIME/VENDIME PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE

6.1 Harmonizimi i brezit të spektrit radio 79 GHz për përdorimin nga pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër në komunitet

(Vendim i Komisionit më 8 Korrik 2004)
(njoftuar me dokumentin numër C(2004) 2591)
(2004/545/EC)

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EVROPIANE,

Duke marrë në konsideratë Traktatin e themelimit të Komunitetit Evropian,

Sipas Vendimit Nr. 676/2002/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 7 mars 2002, në lidhje me kuadrin rregullator për politikën e spektrit të radios në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin e Radios) (1), dhe në veçanti Nenit 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë se:

(1) Në Komunikimin e tij me Këshillin dhe Parlamentin Evropian më 15 shtator 2003, me titull "Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit për automjete të sigurta dhe inteligjente" (2), Komisioni bëri të ditur qëllimin e tij për të përmirësuar sigurinë rrugore në Evropë, me emrin Nisma për Siguri Elektronike. Ky përmirësim mund të arrihet nëpërmjet teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit, si dhe sistemeve inteligjente të sigurisë rrugore, si: pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër (SRR). Gjithashtu, më 5 dhjetor 2003, në
Përfundimet e tij për sigurinë rrugore (3), Komisioni bëri thirrje për përmirësimin e sigurisë së automjeteve përmes promovimit të teknologjive të reja, si: siguria elektronike.
(2) Zhvillimi dhe shpërndarja e shpejtë dhe e bashkërenduar e radarit me rreze të shkurtër në Komunitet dikton disponueshmërinë e brezave të harmonizuar të frekuencave të radios pa vonesa dhe në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme, në mënyrë që të krijohet besimi se industria do të bëjë investimet e nevojshme.
(3) Me qëllim harmonizimin, më 5 gusht 2003, Komisioni i Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe të Telekomunikacionit (CEPT) lëshoi një urdhër (4), sipas Nenit 4(2) të Vendimit 676/2002/CE, për të harmonizuar spektrin radio dhe për të lehtësuar futjen e bashkërenduar të sistemeve të pajisjeve radar automobilistike me rreze të shkurtër (SRR).
(4) Si rrjedhojë e këtij urdhri, CEPT-ja identifikoi brezin me rreze 79 GHz, në cilësinë e tij si Komiteti i Komunikimeve Elektronike (ECC), si brezi më i përshtatshëm për zhvillimin dhe shpërndarjen afatgjatë dhe të përhershme të radarit me rreze të shkurtër. ECC-ja doli në përfundimin që brezi duhet të funksionojë mbi baza pa interferencë dhe pa mbrojtje, në përputhje

me Rregulloren për Radiot, miratuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, dhe sipas specifikimeve teknike të parashikuara nga ECC-ja në vendimin e datës 19 mars 2004.

(5) Rezultatet e punës së kryer sipas urdhrit që i është dhënë CEPT-së në lidhje me identifikimin e një brezi afatgjatë dhe të përhershëm për radarin me rreze të shkurtër janë të pranueshme dhe duhet të vihen në zbatim në Komunitet për të garantuar disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të spektrit radio, që nevojitet për ngritjen dhe funksionimin e tregut të brendshëm. Përdorimi i radarit me rreze të shkurtër në brezin 79 GHz duhet të lejohet sa më shpejt të jetë e mundur, me afat datën

1 janar 2005, me qëllim nxitjen e industrisë që të zhvillojë, të prodhojë dhe të tregtojë pajisjet SRR, që funksionojnë në këtë brez.

(6) Radari me rreze të shkurtër duhet të përdoret duke marrë në konsideratë shëndetin dhe sigurinë e përdoruesit dhe çdo personi tjetër, me vëmendje të veçantë kushtuar Rekomandimit të Këshillit 1999/519/CE më 12 korrik 1999 në lidhje me kufizimin e ekspozimit të publikut të gjerë ndaj fushave elektromagnetike (0 në 300 GHz) (1) dhe Nenit 3.1 (a) të Direktivës 1999/5/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit më datë 9 mars 1999 në lidhje me pajisje radio dhe pajisjet e terminaleve të telekomunikacionit dhe njohjen e ndërsjellë të përputhshmërisë së tyre (2).

(7) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit të Radios,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Qëllimi i këtij Vendimi është harmonizimi i kushteve teknike për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të brezit të spektrit të radios 79 GHz për pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër.

Neni 2

Për efekt të këtij Vendimi, gjejnë zbatim përkufizimet e mëposhtme:

(a) "Brez i spektrit të radios 79 GHz" është frekuenca midis 77 dhe 81 gigaherc;

(b) "Pajisje radar automobilistike me rreze të shkurtër" quhen pajisjet që ofrojnë funksione radari për automjetet, me qëllim zbutjen e rrezikut të përplasjeve dhe rritjen e sigurisë rrugore;

(c) "Bazë pa interferencë dhe pa mbrojtje" nënkupton shmangien e interferencave të dëmshme ndaj përdoruesve të tjerë të brezit dhe mosbërjen e asnjë pretendimi për mbrojtjen nga interferenca të dëmshme që merren nga sisteme të tjera ose operatorë shërbimi, që operojnë në këtë brez.

Neni 3

Brezi i spektrit të radios 79 GHz projektohet dhe mundësohet për pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se data 1 janar 2005, në baza pa interferenca dhe pa mbrojtje.

Dendësia maksimale mesatare e fuqisë është fuqia e rrezatuar izotropike e efektshme (e.i.r.p.) prej 3 dBm/MHz shoqëruar me një kufi kulmor prej 55 dBm e.i.r.p.

Dendësia maksimale mesatare e fuqisë jashtë një automjeti, që rrjedh nga përdorimi i një radari me rreze të shkurtër nuk kalon 9 dBm/MHz e.i.r.p.

Neni 4

Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

6.2 Harmonizimi i brezit të spektrit radio 24 GHz për përdorimin e kufizuar kohor nga pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër në Komunitet

(*Vendim Zbatues i Komisionit më 29 Korrik 2011 për ndryshimin e Vendimit 2005/50/KE)*
(njoftuar me dokument C(2011) 5444)
(2011/485/EU)

KOMISIONI EVROPIAN,
Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Sipas Vendimit Nr. 676/2002/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 7 mars 2002, për kuadrin rregullator për politikën e spektrit të radios në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin e Radios) (1), dhe në veçanti Nenit 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë se:

(1) Më 7 nëntor 2008, Komisionit lëshoi një urdhër që Konferenca Evropiane e Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT) të kryente studime teknike për sistemet me radar automobilistik me rreze të shkurtër, në mbështetje të rishikimit themelor sipas Nenit 5(2) të Vendimit të Komisionit 2005/50/CE (2) dhe studime për përputhshmërinë e radios në lidhje me qasje të mundshme alternative ndaj përdorimit të brezit 24 GHz.

(2) Raportet 36 dhe 37 të CEPT-së në kuadër të këtij urdhri dhe rishikimit themelor, në përputhje me Vendimin 2005/50/CE për evolucionin në lidhje me brezat 24 GHz dhe 79 GHz tregojnë se data e referencës 30 qershor 2013, e parashikuar në Nenin 2(5) të këtij Vendimi, është ende e vlefshme, dhe se duke marrë në konsideratë mungesën aktuale të ndikimit të dëmshëm mbi përdoruesit e tjerë të brezit 24 GHz, nuk ekziston nevoja për të vijuar më tej.

(3) Po bëhet progres me zhvillimin e teknologjisë së radarit automobilistike me rreze të shkurtër në brezin 79 GHz. Megjithatë, ka tregues të konsoliduar se integrimi i aplikacioneve të kësaj teknologjie në prodhimin e makinave nuk do të arrihet brenda afatit të përcaktuar për teknologjinë me rreze të shkurtër në brezin 24 GHz dhe se, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për fazat e zhvillimit, integrimit dhe testimit, ka gjasa që integrimi i radarëve 79 GHz në automjete për të mundësuar shpërndarjen masive në treg do të ndodhë në vitin 2018 ose disa vite përpara.

(4) Krahas kësaj, do të nevojitet një periudhë shtesë për të garantuar kalimin nga teknologjia 24 GHz në teknologjinë 79 GHz në linjat e automjeteve përmes teknologjisë 24 GHz, që do të ekzistojë kur të realizohen linja të reja automjetesh, të pajisura me teknologjinë 79 GHz.

(5) Është thelbësore që të garantohet vazhdimësia e prodhimit ekzistues dhe të ardhshëm të automjeteve të pajisura me radarë 24 GHz, duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre për sigurinë rrugore dhe nevojën për të nxitur krijimin e këtyre aplikacioneve në sa më shumë automjete të jetë e mundur; ndaj, ndërprerja e spektrit të përdorshëm për radarët duhet të shmanget dhe nevojitet një zgjidhje e përkohshme për të garantuar kalimin nga data 1 korrik 2013 deri në datën 1 janar 2018. Për të mundësuar periudhën shtesë të kalimit, data 1 janar 2018 duhet të shtyhet me 4 vjet për pajisjet

radar automobilistike me rreze të shkurtër, të instaluar në automjete, për të cilat është dhënë miratimi përpara datës 1 janar 2018.

(6) Duke marrë në konsideratë mbrojtjen ndërkombëtare që i është dhënë astronomisë radio, satelitëve për eksplorimin e tokës, dhe shërbimeve pasive hulumtuese në hapësirë në brezin 23,60 GHz deri 24 GHz, dhe natyrën e veçantë të përcaktimit të këtij brezi për radarët me rreze të shkurtër nga Vendimi 2005/50/CE, zgjatja e këtij përcaktimi nuk është alternativë e realizueshme. Krahas kësaj, brezi 24 GHz deri 24,25 GHz është përcaktuar për qëllime industriale, shkencore dhe mjekësore (brezi ISM).

(7) Studimet e përputhshmërisë me CEPT-në, duke përfshirë disa sisteme ushtarake, tregojnë se brezi 24,25 GHz deri 27,50 GHz mund të jetë një zgjidhje alternative teknikisht e realizueshme. Brezi mbi 26,50 GHz është identifikuar nga NATO-ja si një brez i planifikuar ushtarak për sistemet fikse dhe celulare.

(8) Pragu i normës së penetrimit 7%, e përcaktuar nga Vendimi 2005/50/CE, duhet të mbahet, duke qenë se nuk ka tregues që ky kufi do të tejkalohej përpara kalimit në brezin 79 GHz dhe për të nënvizuar se brezi 24 GHz mbetet një zgjidhje tranzitore.

(9) Komisioni, me ndihmën e Shteteve Anëtare, duhet të vazhdojë të monitorojë zbatimin e këtij Vendimi, në veçanti në lidhje me pragun, dhe mungesën e interferencës së dëmshme ndaj përdoruesve të tjerë të brezit ose brezave fqinjë, qoftë nëse pragu prej 7% tejkalohet apo jo.

(10) Si rrjedhojë, Vendimi 2005/50/CE duhet të ndryshohet.

(11) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit të Radios,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
Vendimi 2005/50/CE ndryshohet si më poshtë vijon:
1. Neni 2, pika 5 zëvendësohet me nenin si më poshtë vijon:
‘5. “data reference” nënkuptojnë 30 qershor 2013 për frekuencën misi 21,65 dhe 24,25 GHz dhe 1 janar 2018 për frekuencën midis 24,25 dhe 26,65 GHz;’;

2. Neni 3 ndryshohet si më poshtë vijon:
(a) në paragrafin e dytë, togfjalëshi “datë reference” zëvendësohet me “data reference”;
(b) në paragrafin e tretë, togfjalëshi “ajo datë” zëvendësohet në dy vende me “ato data”;
(c) paragrafi i mëposhtëm shtohet pas paragrafit të tretë:
“Megjithatë, data 1 janar 2018 duhet të shtyhet me 4 vjet për pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër, të instaluar në automjete, për të cilat ka nisur procesi i miratimit sipas Nenit 6(6) të Direktivës 2007/46/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (*) dhe është dhënë përpara datës 6 janar 6.
3. Neni 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

(a) në pikën (d) të paragrafit 1, togfjalëshi “datë reference” zëvendësohet me “data reference”;
(b) paragrafët 2 dhe 3 fshihen;
(c) paragrafi 4 zëvendësohet si më poshtë vijon:
4. Shtetet Anëtare ndihmojnë Komisionin në vlerësimin që referohet në paragrafin 1, duke garantuar se mblidhen informacionet e nevojshme dhe i ofrohen Komisionit në kohën e duhur, veçanërisht informacionet e parashikuara në Aneks.”.

Neni 2
Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

6.3 Harmonizimi i brezit të frekuencave 2 010-2 025 MHz për lidhjet video pa tel portative ose të lëvizshme dhe kamerat pa kabllo të përdorura për krijimin e programeve dhe ngjarjet e veçanta

(*Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2016/339 i datës 8 Mars 2016)*
(njoftuar me dokumentin C(2016) 1197)

KOMISIONI EVROPIAN,
Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Sipas Vendimit Nr. 676/2002/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 7 mars 2002, në lidhje me kuadrin rregullator për politikën e spektrit të radios në Komunitetin Evropian (‘Vendimi për Spektrin e Radios’) (1), dhe në veçanti Nenit 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë se:

(1) Përdorimi i brezave të frekuencave 1 900-1 980 MHz, 2 010-2 025 MHz dhe 2 110-2 170 MHz (referuar së bashku si ‘brezi 2 GHz’) është koordinuar sipas Vendimit Nr. 128/1999/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (2). Vlefshmëria e këtij Vendimi përfundoi më 22 janar 2003, por Shtetet Anëtare vazhdojnë ta përdorin këtë spektër në mënyrë të harmonizuar.

(2) Përdorimi i nënbrezit të çiftuar 1 920-1 980 MHz dhe 2 110-2 170 MHz (‘brezi tokësor i çiftuar 2 GHz’) është harmonizuar më pas sipas Vendimit Zbatues të Komisionit 2012/688/EU (3) në përputhje me zhvillimin teknologjik dhe parimet e teknologjisë dhe neutralitetit të shërbimit.

(3) Pjesa e paçiftuar e brezit tokësor 2 GHz, që përfshin brezat e frekuencave 1 900-1 920 MHz dhe 2 010-2 025 MHz, që u ishin caktuar operatorëve celularë në Bashkim, ka mbetur e pashfrytëzuar nga rrjetet celulare për më shumë sesa 10 vjet në shumicën e Shteteve Anëtare, duke rezultuar në nënpërdorimin e pjesës së dobishme të spektrit. Ky nënpërdorim justifikon masat e reja të harmonizimit për të siguruar shfrytëzimin efektiv dhe eficient të spektrit në përputhje me objektivat e Programit shumëvjeçar të Politikës së Spektrit të Radios (‘RSPP’) (4). Këto masa në veçanti kërkojnë spektër të mjaftueshëm për të mbështetur krijimin e programeve dhe ngjarjet e veçanta (PMSE), në përputhje me objektivin për tregun e brendshëm dhe aksesin në kulturë dhe për të zhvilluar Mbrojtjen publike dhe lehtësimin e fatkeqësive (PPDR).

(4) Në përgjigje të autorizimit të Komisionit të lëshuar në vitin 2011 me Nenin 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/CE lidhur me kushtet teknike për alternativat e harmonizimit të spektrit për mikrofonat radio pa tel dhe video kamerat pa kabllo (5), Konferenca Evropiane e Administratave Postare dhe Telekomunikacionit ('CEPT') dorëzoi Raportin 51 (6) ku identifikonte brezin e frekuencave 2 010-2 025 MHz dhe breza të tjerë frekuencash si spektër të ri të mundshëm për kamerat pa tel dhe lidhjet video, subjekt i studimeve të mëtejshme. Prandaj, në tetor të vitit 2012 (1), Komisioni lëshoi një autorizim tjetër ndaj CEPT-së për të kryer studime lidhur me kushtet teknike të harmonizuara për brezat e frekuencave 1 900-1 920 MHz dhe 2 010-2 025 MHz në BE. Si rrjedhojë, më 6 mars 2015, CEPT-ja nxori Raportin 52 (2), ku identifikohen përdorimet e mundshme alternative për këta breza tokësorë 2 GHz të paçiftuar për të zbatuar politikat e nënvizuara nga RSPP-ja në lidhje me PMSE-në dhe PPDR-në.

(5) Siç vihet në dukje nga raportet e CEPT-së, kategoritë e lidhjeve video pa tel portative dhe të lëvizshme dhe kamerave pa kabllo që mund të përdoren për krijimin e programeve dhe ngjarjet e veçanta ('PMSE video') mund të përfshijnë edhe kamerat pa kabllo si kamera dore ose të montuara me transmetues të integruar ose të çmontueshëm, paketa energjetike dhe antena për përçimin e videove me cilësi transmetimi bashkërisht me sinjalet zanore në rreze të shkurtër, në vijë shikimi dhe jo në vijë shikimi; lidhjet video portative nëpërmjet transmetuesve të vegjël, për përcjellje në rreze më të gjata, zakonisht deri në dy kilometra, dhe lidhjet video të lëvizshme si sistemet e videotransmetimit me radiotransmetues dhe radiomarrës të montuar në ose mbi motoçikleta, motorë garash, biçikleta, makina, varka, helikopterë, aereoanije ose mjet tjetër ajror, me mundësi që njëri ose të dy terminalet e lidhjes të përdoren gjatë lëvizjes.

(6) Përdorimi i brezit të frekuencës 2 010-2 025 MHz i lidhjeve video dhe kamerave pa kabllo sjell përparësi teknike dhe ekonomike, duke përfituar nga brezi fqinj i frekuencës 2 025-2 110 MHz, që përdoret për lidhje të tilla dhe kamera pa kabllo në disa Shtete Anëtare dhe identifikohet në Rekomandimin e ERC-së 25-10 (3) si një brez i rekomandueshëm. Duke qenë se në Raportin 52 të CEPT-së konfirmohet se video PMSE mund të operojë në brezin e frekuencës 2 010-2 025 MHz në të njëjtat kushte teknike si ato që aplikohen për përdorimin e PMSE-së në brezin 2 025-2 110 MHz, kjo do të zgjeronte disponueshmërinë e spektrit për lidhje video dhe kamera pa kabllo nga 85 MHz deri në 100 MHz.

(7) Ndonëse në shumicën e Shteteve Anëtare, brezi i frekuencës 2 010-2 025 MHz ose nuk është caktuar ose nuk është përdorur nga operatorët celularë për shumë vite, në disa raste spektri përdoret nga shërbime në detyrë; kjo situatë mund të kërkojë një qasje fleksibël dhe rregullime vendore që marrin parasysh faktorë, të tillë si: vendndodhja ku përdoret spektri, si dhe karakteristikat teknike të përdorimit të spektrit për video PMSE në brezin e frekuencës 2 010-2 025 MHz, si në Shtetet Anëtare përkatëse, ashtu edhe në Shtetet Anëtare fqinje.

(8) Krahas kësaj, disponueshmëria dhe përdorimi i brezit me frekuencë 2 010-2 025 MHz për video PMSE duhet të bëhet në baza joekskluzive, në mënyrë që Shtetet Anëtare të mundësojnë përdorimin kombëtar të këtij spektri apo llojeve të tjera të aplikacioneve, si: mbrojtja publike dhe ruajtja nga fatkeqësitë ose lidhje video të përkohshme pikë për pikë apo kamera industriale, për aq kohë se këto aplikacione janë në përputhje me parametrat teknikë që parashikohen në këtë Vendim.

(9) Kushtet e Harmonizuara në Bashkimin Evropian ndihmojnë në krijimin e një tregu të përbashkët të efektshëm për këto aplikacione, me ekonomi shkalle dhe përfitime për qytetarët dhe industritë e Bashkimit Evropian, në përputhje me Direktivën e Pajisjeve Radio dhe Pajisjeve Terminale të Telekomunikacionit (Direktiva 1999/5/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit) (4) dhe Direktivën e Pajisjeve Radio (Direktiva 2014/53/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit) (5).

(10) Për të garantuar përdorimin e efektshëm të brezit me frekuencë 2 010-2 025 MHz në planin afatgjatë, Shtetet Anëtare duhet të vëzhgojnë vazhdimisht përdorimin e brezit me frekuencë 2 010-2 025 MHz dhe t'i raportojnë gjetjet e tyre përpara Komisionit.

(11) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit të Radios,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
Qëllimi i këtij Vendimi është harmonizimi i kushteve teknike për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të brezit të spektrit të radios 2 010- 2 025 MHz për video PMSE në baza joekskluzive.

Neni 2
Për efekt të këtij Vendimi, video PMSE nënkupton lidhje video pa kabllo që mund të jenë kamera portative ose të lëvizshme pa kabllo, që përdoren për përgatitjen e programeve dhe ngjarje të veçanta.

Neni 3
Sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së shpalljes së këtij Vendimi, Shtetet Anëtare caktojnë dhe vënë në dispozicion brezin e frekuencës 2 010-2 025 MHz për video PMSE, në baza joekskluzive, në përputhje me parametrat e parashikuar në aneks.

Me diktimin e interferencës dhe llojeve të tjera të përdoruesve të spektrit që kanë të drejtë të përdorin brezin e frekuencës 2 010- 2 025 MHz në datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Shtetet Anëtare mund të kufizojnë përdorimin e video PMSE në pjesën përkatëse të brezit të frekuencës në zona specifike gjeografike, në përputhje me aneksin.

Neni 4
Shtetet Anëtare e vëzhgojnë vazhdimisht përdorimin e brezit me frekuencë 2 010-2 025 MHz dhe i raportojnë gjetjet e tyre përpara Komisionit, duke përfshirë edhe informacionet rreth ndryshimit apo tërheqjes së të drejtave të përdorimit, me qëllim rishikimin në kohën e duhur të këtij Vendimi sipas nevojës.

Neni 5
Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKSI

Parametrat e referuar në nenin 3

Për efekt të këtij Aneksi, e.i.r.p.-ja është fuqia e rrezatuar izotropike barasvlerëse, që është produkti i fuqisë që furnizohet në antenë dhe kthimi i antenës në një drejtim të caktuar krahasuar me një antenë izotropike (fitim absolut ose izotropik).

e.i.r.p. për video PMSE

Lloji i lidhjes	e.i.r.p.
Kamerë pa kabllo	– 7 dBW
Lidhje video portative	16 dBW
Lidhje video celulare	10 dBW

Aksesi në spektër mund të autorizohet kryesisht sipas rregullimeve vendore. Këto rregullime vendore mund të konfigurohen për të marrë parasysh faktorë, të tillë si: vendndodhja ku përdoret spektri, si dhe karakteristikat teknike të përdorimit të spektrit për video PMSE, ose për shërbime në detyrë.

Shtetet Anëtare mund të përshtatin kufijtë e e.i.r.p-së për video PMSE, që përcaktohen në tabelë nëse rrethanat vendore në Shtetet Anëtare përkatëse dhe në Shtetet Anëtare fqinje mundësojnë kufij më të lartë pa kompromet uar bashkekzistencën e shërbimeve aktuale.

6.4 Thjeshtësimi i operimit të komunikimeve celulare në mjete fluturuese (shërbime MCA)

Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2016/2317 më 16 Dhjetor 2016 për ndryshimin e Vendimit 2008/294/CE dhe Vendimit Zbatues 2013/654/EU,
(njoftuar me dokumentin C(2016) 8413)

KOMISIONI EVROPIAN,
Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Sipas Vendimit Nr. 676/2002/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 7 mars 2002, për kuadrin rregullator për politikën e spektrit të radios në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin e Radios) (1), dhe në veçanti Nenit 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë se:

(1) Vendimi i Komisionit 2008/294/CE (2) parashikon kushtet teknike dhe operacionale të nevojshme për të mundësuar përdorimin e GSM, UMTS dhe LTE në mjete fluturuese (shërbime MCA) në Bashkimin Evropian.

(2) Legjislacioni aktual kërkon praninë e një Njësie të Kontrollit të Rrjetit (NCU) si pjesë e pajisjeve MCA në mjete fluturuese, me qëllim parandalimin e përpjekjeve për regjistrimin e terminaleve celulare në mjete fluturuese me rrjete tokësore të komunikimeve celulare.

(3) Më 7 tetor 2015, Komisioni lëshoi një urdhër që Konferenca Evropiane e Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT), në mbështetje të Nenit 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/CE, të kryente studime teknike në lidhje me nevojën për ta bërë të detyrueshëm përdorimin e NCU-së në mjete fluturuese që kanë MCA.

(4) Në kuadër të këtij urdhri, më 17 nëntor 2016, CEPT-ja miratoi Raportin e saj të 63-të, ku konstatohej se është e mundur bërja opsionale e përdorimit të NCU-së për sistemet GSM dhe LTE, duke marrë parasysh se operacionet MCA pa NCU garantojnë mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës nga rrjetet tokësore.

(5) Sipas përfundimeve të Raportit të CEPT-së, nuk është më i nevojshëm parandalimi aktiv përmes NCU-së i lidhjes së terminaleve celulare me rrjetet celulare tokësore, që operojnë në brezin 2 570-2 690 MHz. Neni 2 i Vendimit Zbatues të Komisionit 2013/654/EU (3) nuk gjen më zbatim dhe duhet të fshihet.

(6) Megjithatë, në lidhje me sistemet UMTS, CEPT-ja doli në përfundimin se një NCU mbetet i nevojshëm për të parandaluar lidhjet midis rrjeteve tokësore UMTS dhe pajisjeve të përdoruesve në mjetin fluturues. Sipas studimeve, këto lidhje mund të shkaktojnë reduktimin e pjesshëm dhe të përkohshëm të kapacitetit të qelizave lidhëse dhe fqinje në tokë. Zgjidhja tjetër për të zvogëluar sinjalet që hyjnë dhe dalin nga kabina dhe për të parandaluar lidhjet e padëshiruara është të shtohet mbrojtja e mjaftueshme në trupin e avionit.

(7) Specifikimet teknike të MCA-së duhet të rishikohen për të garantuar që janë në përputhje me progresin teknologjik.

(8) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit të Radios,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
Aneksi i Vendimit 2008/294/CE është zëvendësuar nga teksti në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2
Neni 2 i Vendimit Zbatues 2013/654/EU është fshirë.

Neni 3
Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKSI

1. Brezat e frekuencës dhe sistemet që lejohen për Shërbimet MCA

Tabela 1

Lloji	Frekuenca	Sistemi
GSM 1 800	1 710-1 785 MHz (lidhja drejt satelitit) 1 805-1 880 MHz (lidhja nga sateliti)	GSM në përputhje me Standardet e GSM-së të botuara nga ETSI, në veçanti EN 301 502, EN 301 511 dhe EN 302 480, ose specifikime barasvlerëse.
UMTS 2 100 (FDD)	1 920-1 980 MHz (lidhja drejt satelitit) 2 110-2 170 MHz (lidhja nga sateliti)	UMTS në përputhje me Standardet e UMTS-së të botuara nga ETSI, në veçanti EN 301 908-1, EN 301 908-2, EN 301 908-3 dhe EN 301 908-11, ose specifikime barasvlerëse.
LTE 1 800 (FDD)	1 710-1 785 MHz (lidhja drejt satelitit) 1 805-1 880 MHz (lidhja nga sateliti)	LTE në përputhje me Standardet e LTE-së të botuara nga ETSI, në veçanti EN 301 908-1, EN 301 908-13, EN 301 908-14, dhe EN 301 908-15, ose specifikime barasvlerëse.

2. Parandalimi i lidhjes së terminaleve celulare me rrjetet tokësore

Terminalet celulare brenda brezave të frekuencës që renditen në Tabelën 2 nuk duhet të regjistrohen me rrjetet celulare UMTS në tokë:

- me përfshirjen, në sistemin MCA, të Njësisë së Kontrollit të Rrjetit (NCU), që mat sinjalin në kabinë për brezat celularë marrës, dhe/ose
- nga mbrojtja e trupit të mjetit fluturues për të zvogëluar më tej hyrjen dhe daljen e sinjalit nga trupi i mjetit fluturues.

Tabela 2

Brezi i frekuencës (MHz)	Sistemet në tokë
925-960 MHz	UMTS (dhe GSM, LTE)
2 110-2 170 MHz	UMTS (dhe LTE)

Operatorët MCA mund të vendosin të zbatojnë një NCU në brezat e tjerë të frekuencës që renditen në Tabelën 3.

Tabela 3

Brezi i frekuencës (MHz)	Sistemet në tokë
460-470 MHz	LTE (1)
791-821 MHz	LTE
1 805-1 880 MHz	LTE dhe GSM
2 620-2 690 MHz	LTE
2 570-2 620 MHz	LTE

(1) Në nivelin kombëtar, administratat mund të përdorin teknologjinë LTE për aplikacione të ndryshme, si: BB-PPDR, BB-PMR ose punimet e Rrjeteve Celulare.

3. Parametrat teknike

(a) Fuqia e rrezatuar izotropike barasvlerëse (e.i.r.p.), jashtë mjetit fluturues, nga NCU/mjet fluturues BTS/mjet fluturues Nyja B

Tabela 4

e.i.r.p.-ja totale, jashtë mjetit fluturues, nga NCU/mjet fluturues BTS/mjet fluturues Nyja B nuk duhet të tejkalojë:

Lartësinë mbi tokë (m)	e.i.r.p.-ja maksimale e Sistemit jashtë mjetit fluturues në dBm/kanal		
	NCU	Mjet fluturues BTS/Mjet fluturues Nyja B	Mjet fluturues BTS/Mjet fluturues Nyja B dhe NCU
	Brezi: 900 MHz	Brezi: 1 800 MHz	Brezi: 2 100 MHz
	Gjerësia e brezit = 3,84 MHz	Gjerësia e brezit = 200 MHz	Gjerësia e brezit = 3,84 MHz
3 000	– 6,2	– 13,0	1,0
4 000	– 3,7	– 10,5	3,5
5 000	– 1,7	– 8,5	5,4
6 000	– 0,1	– 6,9	7,0
7 000	1,2	– 5,6	8,3
8 000	2,3	– 4,4	9,5

(b) Fuqia e rrezatuar izotropike barasvlerëse (e.i.r.p.), jashtë mjetit fluturues, nga terminali në bord

Tabela 5

e.i.r.p.-ja, jashtë mjetit fluturues, nga terminali celular nuk duhet të tejkalojë:

Lartësinë mbi tokë (m)	e.i.r.p.maksimale, jashtë mjetit fluturues, nga terminali celular GSM në dBm/200 kHz	e.i.r.p.maksimale, jashtë mjetit fluturues, nga terminali celular LTE në dBm/5 MHz	e.i.r.p.maksimale, jashtë mjetit fluturues, nga terminali celular UMTS në dBm/3,84 MHz
	GSM 1 800 MHz	LTE 1 800 MHz	UMTS 2 100 MHz
3 000	– 3,3	1,7	3,1
4 000	– 1,1	3,9	5,6
5 000	0,5	5	7
6 000	1,8	5	7
7 000	2,9	5	7
8 000	3,8	5	7

Kur operatorët MCA vendosin të zbatojnë një NCU në brezat e frekuencës të renditur në Tabelën 3, vlerat maksimale në Tabelën 6 gjejnë zbatim për e.i.r.p.-në totale jashtë mjetit fluturues, nga NCU/mjet fluturues BTS/mjet fluturues Nyja B, në lidhje me vlerat e përmendura në Tabelën 4.

Tabela 6

Lartësinë mbi tokë (m)	e.i.r.p. maksimale, jashtë mjetit fluturues, nga NCU/mjet fluturues BTS/mjet fluturues Nyja B			
	460-470 MHz	791-821 MHz	1 805-1 880 MHz	2 570-2 690 MHz
	dBm/1,25 MHz	dBm/10 MHz	dBm/200 kHz	dBm/4,75 MHz
3 000	– 17,0	– 0,87	– 13,0	1,9
4 000	– 14,5	1,63	– 10,5	4,4
5 000	– 12,6	3,57	– 8,5	6,3
6 000	– 11,0	5,15	– 6,9	7,9

7 000	– 9,6	6,49	– 5,6	9,3
8 000	– 8,5	7,65	– 4,4	10,4

(c) **Kërkesat Operacionale**

I. Lartësia minimale mbi tokë për çfarëdolloj transmetimi nga një sistem MCA-je në veprim duhet të jetë 3,000 metra.
II. BTS-ja e mjetit fluturues, ndërkohë që është në funksion, duhet të kufizojë fuqinë e të gjitha terminaleve celulare *GSM* që transmetojnë në brezin 1 800 MHz në një vlerë nominale prej 0 dBm/200 kHz në të gjitha fazat e komunikimit, duke përfshirë aksesin fillestar.
III. Nyja B e mjetit fluturues, ndërkohë që është në funksion, duhet të kufizojë fuqinë e transmetimit të të gjitha terminaleve celulare *LTE* që transmetojnë në brezin 1 800 MHz në një vlerë nominale prej 5 dBm/5 MHz në të gjitha fazat e komunikimit.
IV. Nyja B e mjetit fluturues, ndërkohë që është në funksion, duhet të kufizojë fuqinë e transmetimit të të gjitha terminaleve celulare *UMTS* që transmetojnë në brezin 2 100 MHz në një vlerë nominale prej -6 dBm/3,84 MHz në të gjitha fazat e komunikimit dhe numri maksimal i përdoruesve nuk duhet të jetë mbi 20.

6.5 Përditësimi i kushteve teknike të harmonizuara në fushën e përdorimit të spektrit të radios për pajisjet me rreze të shkurtër

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2019/1345 i datës 2 gusht 2019 për ndryshimin e Vendimit 2006/771/CE)
(njoftuar me dokumentin C(2019) 5660)

KOMISIONI EVROPIAN,

Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian,
Sipas Vendimit Nr. 676/2002/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 7 mars 2002, për kuadrin rregullator për politikën e spektrit të radios në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin e Radios) (1), dhe në veçanti Nenit 4(3) të tij,

Duke qenë se:

(1) Vendimi i Komisionit 2006/771/CE (2) harmonizon kushtet teknike për përdorimin e spektrit për një gamë të gjerë pajisjesh me rreze të shkurtër, duke përfshirë aplikacione si alarmet, pajisjet e komunikimeve lokale, hapësit e dyerve, implantet mjekësore dhe sistemet inteligjente të transportit. Pajisjet me rreze të shkurtër janë zakonisht produkte të tregut masiv dhe/ose portative, të cilat mund të merren dhe përdoren lehtësisht përtej kufijve; rrjedhimisht diferencat në kushtet e aksesit të spektrit pengojnë lëvizjen e tyre të lirë, rrisin kostot e tyre të prodhimit dhe krijojnë risqe për interferencë të dëmshme me aplikacione dhe shërbime të tjera radioje. Kuadri rregullator për pajisjet me rreze të shkurtër mbështet novacionin për një gamë të gjerë aplikacionesh.

(2) Vendimi Nr. 243/2012/EU i Parlamentit Evropian dhe Këshillit (3) u kërkon Shteteve Anëtare, në bashkëpunim me Komisionin, kur është e përshtatshme, që të nxisin përdorimin kolektiv të spektrit, si dhe përdorimin e përbashkët të spektrit për të përmirësuar eficiencën dhe fleksibilitetin, dhe për të siguruar disponueshmërinë e spektrit për identifikimin e radiofrekuencës (RFID) dhe 'Internetin e Gjërave' (IoT).

(3) Për shkak të rëndësisë në rritje të pajisjeve me rreze të shkurtër për ekonominë, dhe në kuadër të ndryshimeve të vrullshme në teknologji dhe kërkesave të shoqërisë, mund të dalin aplikime të reja për pajisjet me rreze të shkurtër. Këto aplikime do të kërkojnë përditësime të rregullta të kushteve teknike të harmonizuara për përdorimin e spektrit.

(4) Më 5 korrik 2006, Komisioni lëshoi një autorizim të përhershëm në Konferencën Evropiane të Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT), në zbatim të nenit 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/CE, për të përditësuar Shtojcën e Vendimit 2006/771/CE, si përgjigje për zhvillimet teknologjike dhe të tregut në fushën e pajisjeve me rreze të shkurtër.

(5) Vendimet e Komisionit 2008/432/CE (4), 2009/381/KE (5) dhe 2010/368/EU (6) dhe Vendimet Zbatuese të Komisionit 2011/829/EU (7) dhe 2013/752/EU (8) ndryshuan tashmë kushtet teknike të hormonizuara për pajisjet me rreze të shkurtër, të përcaktuara në Vendimin 2006/771/EU, duke shfuqizuar Shtojcën e tij.

(6) Në raportin e vet të korrikut 2016 (9), të dorëzuar si përgjigje për autorizimin e mësipërm, CEPT-i e informoi Komisionin për rezultatet e shqyrtimit të kërkuar të 'kufizimeve të tjera të përdorimit' në Shtojcën e Vendimit 2006/771/EU dhe e këshilloi Komisionin që të ndryshonte numrin e aspekteve teknike në atë Shtojcë.

(7) Nga njëra anë, rezultatet e analizës së CEPT-it tregojnë se pajisjet me rreze të shkurtër që operojnë mbi baza joekskluzive dhe të përbashkëta kanë siguri ligjore lidhur me mundësinë e përdorimit të spektrit në mënyrë të përbashkët, gjë që mund të arrihet nëpërmjet kushteve teknike të parashikuara për përdorimin e përbashkët të brezave të harmonizuar, që sigurojnë përdorim të besueshëm dhe eficient të këtyre brezave. Nga ana tjetër, këto pajisje me rreze të shkurtër, kanë nevojë për fleksibilitet të mjaftueshëm për të lejuar një gamë të gjerë aplikimesh, për të maksimizuar përfitimet e novacionit pa tel në Bashkimin Evropian. Prandaj, nevojitet harmonizimi i kushteve teknike të përcaktuara të përdorimit për të parandaluar interferencën e dëmshme dhe për të siguruar sa më shumë fleksibilitet që të jetë e mundur, duke nxitur përdorim të besueshëm dhe eficient të brezave të frekuencës nga pajisjet me rreze të shkurtër.

(8) Objekti i kategorive, sikurse përcaktohet në Shtojcë, duhet t'u sigurojë përdoruesve parashikueshmëri në lidhje me pajisjet e tjera me rreze të shkurtër që lejohen të përdorin të njëjtin brez frekuence në bazë joekskluzive dhe të përbashkët. Për rrjedhojë, prodhuesit duhet të sigurojnë se pajisjet me rreze të shkurtër shmangin në mënyrë efektive interferencën e dëmshme me pajisje të tjera me rreze të shkurtër. Pajisjet që operojnë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Vendim duhet të jenë në përputhje me Direktivën 2014/53/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (10).

(9) Në brezat specifikë të frekuencës të përfshira në këtë Vendim, kombinimi i kategorizimit të pajisjeve me rreze të shkurtër dhe i identifikimit të kushteve teknike të përdorimit (brezi i frekuencës, limiti i energjisë së transmetimit / limiti i fuqisë së fushës / limiti i densitetit të energjisë, parametrat shtesë dhe kufizimet e tjera të përdorimit), i zbatueshëm për këto kategori, përcakton një mjedis

ndarjeje të harmonizuar dhe të parashikueshëm, që i lejon pajisjet me rreze të shkurtër të ndajnë përdorimin e spektrit me njëra-tjetrën në bazë joekskluzive, pavarësisht qëllimit të këtij përdorimi.

(10) Për të ruajtur sigurinë ligjore dhe parashikueshmërinë e këtyre mjediseve të harmonizuara të ndarjes, përdorimi i brezave të harmonizuar, qoftë nga pajisjet me rreze të shkurtër që nuk janë pjesë e një kategorie të harmonizuar apo nga parametrat teknikë më pak kufizues, duhet të lejohet në atë masë që të mos cenohet mjedisi përkatës i ndarjes.

(11) Më 2 korrik 2014, në dokumentin 'Afati kohor dhe udhëzimi për CEPT-in për përditësimin e gjashtë të Vendimit të SRD-së' (RSCOM 13-78rev2), Komisioni i bëri thirrje CEPT-it që të merrte në konsideratë përfshirjen e Vendimeve të tjera ekzistuese lidhur me pajisjet me rreze të shkurtër në Vendimin 2006/771/CE. Në raportin e vet të korrikut 2016 (9), CEPT-i rishikoi parametrat teknikë për pajisjet RFID dhe i rekomandoi Komisionit që të shfuqizonte Vendimin 2006/804/CE (11) dhe të përfshinte parametrat e rishikuar për RFID-në në këtë Vendim.

(12) Në një shtesë të raportit të vet të korrikut 2016 (12), të dorëzuar në mars 2017, si përgjigje për autorizimin e sipërpërmendur, CEPT-i e informoi Komisionin lidhur me mundësi të mëtejshme për qasjen e harmonizimit teknik të spektrit të radios për përdorim nga pajisje me rreze të shkurtër në brezat 870-876 MHz dhe 915-921 MHz, duke marrë parasysh edhe mundësi të reja në brezin 863-868 MHz, tashmë të harmonizuar për pajisjet me rreze të shkurtër. Këto mundësi zbatohen kryesisht për llojet e reja të aplikimeve makinë me makinë (M2M)/IoT në rrjetet e pajisjeve me rreze të shkurtër që mund të përfitojnë nga ekonomitë e shkallës, si rrjedhojë e harmonizimit në nivel BE-je.

(13) Rezultatet e punës së CEPT-it për Shtesën tregojnë se mundësitë e reja në brezin 863-868 MHz janë plotësisht në përputhje me mjediset e harmonizuara të ndarjes të përcaktuara me Vendimin 2006/771/CE dhe me përditësimet e tij, dhe rrjedhimisht duhet të përfshihen në Shtojcën e tij. Brezat 870-876 MHz dhe 915-921 MHz nuk duhet të përfshihen te Shtojca e këtij Vendimi, pasi kanë nevojë për më shumë fleksibilitet në zbatim.

(14) Në bazë të rezultateve të përgjithshme të punës së CEPT-it, kushtet rregullatore për pajisjet me rreze të shkurtër mund të integrohen, p.sh. duke bashkuar dy Vendime lidhur me pajisjet me rreze të shkurtër dhe duke përmirësuar kushtet teknike. Përditësimi i kushteve të harmonizuara të aksesit të spektrit për pajisjet me rreze të shkurtër duhet të ndihmojë për të arritur objektin e përcaktuar me Vendimin Nr. 243/2012/EU, me qëllim nxitjen e përdorimit kolektiv të spektrit në tregun e brendshëm sipas kategorive të caktuara të pajisjeve me rreze të shkurtër.

(15) Prandaj, Shtojca e Vendimit 2006/771/CE duhet të ndryshohet, dhe Vendimi 2006/804/CE duhet të shfuqizohet sipas rastit.

(16) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit të Radios,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
Shtojca e Vendimit 2006/771/KE është zëvendësuar nga teksti në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2
Vendimi 2006/804/CE është shfuqizuar me efekt që nga 1 janari 2018.

Neni 3
Shtetet Anëtare i raportojnë Komisionit për zbatimin e këtij Vendimi jo më vonë se data 2 maj 2018.

Neni 4
Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

Brezat e harmonizuar të frekuencës dhe parametrat teknikë për pajisjet me rreze të shkurtër gjenden në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.

6.6 Harmonizimi i brezit të spektrit të radios 24 GHz për përdorimin e kufizuar kohor nga pajisjet radar automibilistike me rreze të shkurtër në Komunitet

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2017/2077 i datës 10 Nëntor 2017 për ndryshimin e Vendimit 2005/50/CE)
(njoftuar me dokumentin C(2017) 7374)

KOMISIONI EVROPIAN,
Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Sipas Vendimit Nr. 676/2002/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 7 mars 2002, për kuadrin rregullator për politikën e spektrit të radios në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin e Radios) (1), dhe në veçanti Nenit 4(6) të tij,

Duke marrë në konsideratë se:

(1) Vendimi i Komisionit 2005/50/CE (2), i ndryshuar me Vendimin Zbatues të Komisionit 2011/485/EU (3), harmonizon kushtet teknike për disponueshmërinë dhe përdorimin eficient të brezit të spektrit të radios 24 GHz për pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër. Këta radarë ndihmojnë për parandalimin e përplasjeve të automjeteve.

(2) Vendimi 2005/50/CE u ngarkon Shteteve Anëtare detyrime për raportim statistikor, duke përfshirë kërkesën për mbledhjen vjetore të të dhënave mbi numrin e automjeteve të pajisura me radarë me rreze të shkurtër, që përdorin brezin e spektrit radio 24 GHz.

(3) Megjithëse detyrimi për vijimin e përdorimit të radarëve me rreze të shkurtër 24 GHz nën shqyrtim duhet të qëndrojë, tanimë duket e papërshtatshme që t'i kërkohet secilit autoritet kombëtar të raportojë të dhëna statistikore vjetore sistematikisht, sipas parashikimit në Vendimin 2005/50/CE. Burimet administrative kombëtare do të shfrytëzoheshin më mirë nëse Shtetet Anëtare do t'i dorëzonin raportet statistikore vetëm me kërkesë të Komisionit. Komisioni mund t'i kërkojë këto

raporte statistikore në rastin e mundshëm, por pa gjasë të ndodhë, të raportimit për interferencë ose rritje të menjëhershme të numrit të automjeteve të pajisura me radarë 24 GHz.

(4) Që prej miratimit të Vendimit 2005/50/CE, nuk ka pasur asnjë raportim për interferencë të dëmshme nga shërbimet që mbrohen nga Vendimi. Numri i automjeteve të pajisura me radarë me rreze të shkurtër, që përdorin brezin e spektrit radio 24 GHz, ka mbetur përgjithësisht i vogël dhe, në çdo rast, në një nivel që është ndjeshëm nën pragun prej 7 % të numrit të përgjithshëm të automjeteve në qarkullim në secilin Shtet Anëtar. Ky prag konsiderohet si përqindja kritike nën të cilën supozohet se nuk do të shkaktohet interferencë e dëmshme ndaj përdoruesve të tjerë të brezit 24 GHz.

(5) Si rrjedhojë, Vendimi 2005/50/CE duhet të ndryshohet.

(6) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit të Radios,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
Vendimi 2005/50/CE ndryshohet si më poshtë vijon:

Në Shtojcën e Vendimit, fjalët "Të dhënat e mëposhtme mblidhen në bazë vjetore:" zëvendësohen me: "Të dhënat e mëposhtme mblidhen me kërkesë të Komisionit:"

Neni 2
Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

6.7 Përditësimi i kushteve teknike të hamornizuara në fushën e përdorimit të spektrit të radios për pajisjet me rreze të shkurtër

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2019/1345 i datës 2 Gusht 2019 për ndryshimin e Vendimit 2006/771/CE)
(njoftuar me dokumentin C(2019) 5660)

KOMISIONI EVROPIAN,
Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Sipas Vendimit Nr. 676/2002/CE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 7 mars 2002, për kuadrin rregullator për politikën e spektrit të radios në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin e Radios) (1), dhe në veçanti Nenit 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë se:

(1) Pajisjet me rreze të shkurtër janë zakonisht produkte radio të tregut masiv dhe/ose portative, të cilat mund të merren dhe përdoren lehtësisht përtej kufijve. Diferencat në kushtet e aksesit të spektrit krijojnë risqe për interferencë të dëmshme me aplikime dhe shërbime të tjera radioje, pengojnë

lëvizjen e tyre të lirë dhe rrisin kostot e tyre të prodhimit.
(2) Vendimi i Komisionit 2006/771/CE (2) harmonizon kushtet teknike për përdorimin e spektrit për një gamë të gjerë pajisjesh me rreze të shkurtër në fushat e zbatimit, si alarmet, komunikimet vendore, telekomandimi, implantet mjekësore dhe mbledhja e të dhënave mjekësore, sistemet inteligjente të transportit dhe "Interneti i Gjërave", që përfshin identifikimin e radiofrekuencës ('RFID'). Si rrjedhojë, pajisjet me rreze të shkurtër që respektojnë këto kushte teknike të harmonizuara i nënshtrohen vetëm një autorizimi të përgjithshëm sipas legjislacionit kombëtar.
(3) Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2018/1538 (3) harmonizon më tej edhe kushtet teknike për përdorimin e spektrit nga pajisjet me rreze të shkurtër brenda brezave të frekuencave 874-874,4 dhe 915-919,4 MHz. Në këta breza frekuencash, mjedisi i ndarjes është i ndryshëm; prandaj, nevojitet një regjim rregullator i posaçëm. Ky Vendim mundëson zgjidhje RFID të avancuara teknikisht, si dhe aplikimet e "Internetit të Gjërave", bazuar te pajisjet e rrjetëzuara me rreze të shkurtër në rrjetet e të dhënave.
(4) Vendimi 2006/771/CE dhe Vendimi Zbatues (EU) 2018/1538 përbëjnë kuadrin rregullator për pajisjet me rreze të shkurtër, që mbështet novacionin për një gamë të gjerë aplikimesh brenda tregut të vetëm digjital.
(5) Aplikimet e reja për pajisjet me rreze të shkurtër janë duke u shfaqur për shkak të rëndësisë në rritje të këtyre pajisjeve për ekonominë, dhe në kuadër të ndryshimeve të vrullshme në teknologji dhe kërkesave të shoqërisë. Këto aplikime kërkojnë përditësime të rregullta të kushteve teknike të harmonizuara për përdorimin e spektrit.
(6) Bazuar tek autorizimi i përhershëm i lëshuar në Konferencën Evropiane të Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT) në korrik të 2006-s, në zbatim të Nenit 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/CE, për të përditësuar Shtojcën e Vendimit 2006/771/CE për të pasqyruar zhvillimet teknologjike dhe të tregut në fushën e pajisjeve me rreze të shkurtër, Shtojca është ndryshuar gjashtë herë. Puna e kryer në kuadër të autorizimit të përhershëm shërbeu dhe si bazë për Vendimin Zbatues (EU) 2018/1538 që ofroi spektër shtesë për pajisjet me rreze të shkurtër brenda brezit të frekuencave 874-874,4 dhe 915-919,4 MHz.
(7) Më 20 tetor 2017, Komisioni lëshoi shkresën udhëzuese për ciklin e shtatë të përditësimit (RSCOM17- 24rev1). Në përgjigje të saj, CEPT-ja i dorëzoi Komisionit Raportin 70 më 8 mars 2019. Krahas thjeshtimit dhe përmirësimit të përmbajtjes ekzistuese, CEPT-ja propozon shtimin e përmbajtjeve të reja në Shtojcën e Vendimit 2006/771/CE. Përmbajtjet e reja bëjnë të mundur aplikime të reja mjekësore dhe të lidhura me sigurinë dhe harmonizojnë spektrin për aplikimet që nuk lidhen me sigurinë e sistemeve inteligjente të transportit dhe për aplikimet e zbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor. Prandaj, raporti duhet të shërbejë si baza teknike për këtë Vendim.
(8) Pajisjet me rreze të shkurtër që operojnë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Vendim duhet të jenë në përputhje me Direktivën 2014/53/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (4).
(9) Vendimi 2006/771/CE duhet të ndryshohet.
(10) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit të Radios,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
Vendimi 2006/771/CE ndryshohet si më poshtë vijon:
(1) Në Nenin 2, pikat 1 dhe 2 zëvendësohen me:
'1. "pajisje me rreze të shkurtër" nënkupton një pajisje radio që mundëson komunikim njëdrejtimësh ose dydrejtimësh dhe që merr dhe/ose transmeton në distancë të shkurtër me energji të ulët;
2. "mosinterferencë dhe bazë të pambrojtur" nënkupton që nuk mund të shkaktohet asnjë interferencë e dëmshme në shërbimet e radiokomunikimit dhe se nuk mund të ngrihet asnjë pretendim për

mbrojtjen e këtyre pajisjeve nga interferenca që vjen nga shërbimet e radiokomunikimit;'.
(2) Shtojca është zëvendësuar nga teksti në Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2
Shtetet Anëtare i raportojnë Komisionit për zbatimin e këtij Vendimi jo më vonë sesa data 5 maj 2020.

Neni 3
Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

'*SHTOJCA*

Brezat e frekuencave me kushtet teknike përkatëse të harmonizuara dhe afatet e zbatimit për pajisjet me rreze të shkurtër

Tabela 1 përcakton objektin e kategorive të ndryshme të pajisjeve me rreze të shkurtër (të përcaktuara në Nenin 2(3)) ndaj të cilave zbatohet Vendimi aktual. Tabela 2 përcakton kombinimet e ndryshme të brezit të frekuencave dhe kategorinë e pajisjeve me rreze të shkurtër, dhe kushtet teknike të harmonizuara për aksesin në spektër dhe afatet përkatëse të zbatimit.

Kushtet e përgjithshme teknike të zbatueshme për të gjithë brezat dhe pajisjet me rreze të shkurtër që mbulohen nga objekti i këtij Vendimi:

— Shtetet Anëtare duhet të lejojnë breza fqinj të frekuencës, të përcaktuar në Tabelën 2, që të përdoren si brez i vetëm frekuence, me kushtin që të përmbushen kërkesat specifike të secilit prej këtyre brezave fqinj të frekuencës.

— Shtetet Anëtare duhet të lejojnë përdorimin e **spektrit deri tek energjia e transmetimit, forca e fushës ose densiteti i fuqisë** të dhëna në Tabelën 2. Në përputhje me Nenin 3(3) të këtij Vendimi, ato mund të caktojnë kushte më pak kufizuese, pra duke lejuar përdorimin e spektrit me energji transmetimi, forcë fushe ose densitet fuqie më të lartë, për sa kohë që nuk reduktohet apo kompromethet bashkekzistenca e përshtatshme ndërmjet pajisjeve me rreze të shkurtër në brezat e harmonizuar nga ky Vendim.

— Shtetet Anëtare mund të caktojnë vetëm **parametra shtesë** (rregulla për kanalizimin dhe/ose aksesin dhe zënien e kanaleve) të përcaktuar në Tabelën 2, dhe nuk duhet të shtojnë parametra të tjerë ose kërkesa për akses ose zbutje ndaj spektrit. Kushtet më pak kufizuese në zbatim të Nenit 3(3), nënkuptojnë se Shtetet Anëtare mund t'i anashkalojnë plotësisht këta parametra shtesë në një qelizë të caktuar ose të lejojnë vlera më të mëdha, me kusht që mjedisi i përshtatshëm i ndarjes në brezin e harmonizuar të mos kompromethet.

— Shtetet Anëtare mund të vendosin vetëm këto **kufizime të tjera përdorimi** të përcaktuara në Tabelën 2 dhe nuk duhet të shtojnë kufizime shtesë përdorimi. Meqenëse mund të zbatohen kushte më pak kufizuese në përputhje me Nenin 3(3), Shtetet Anëtare mund t'i anashkalojnë këto kufizime pjesërisht ose plotësisht, me kusht që mjedisi i përshtatshëm i ndarjes në brezin e harmonizuar të mos kompromethet.

— Kushtet më pak kufizuese në zbatim të Nenit 3(3) duhet të aplikohen pa paragjykim ndaj

Direktivës 2014/53/EU. Për qëllimet e kësaj Shtojce, vlen përkufizimi i mëposhtëm i **ciklit të punës**:

"**cikël pune**" nënkupton raportin Σ(Ton)/(Tobs), të shprehur si përqindje, ku Ton është koha "aktive" e një pajisjeje të vetme transmetuese dhe Tobs është periudha e vëzhgimit. Ton matet në një brez frekuencash vëzhgimi (Fobs). Për sa kohë nuk përcaktohet ndryshe në këtë shtojcë teknike, Tobs është një periudhë e vazhdueshme prej një ore, dhe Fobs është brezi i zbatueshëm i frekuencave në këtë shtojcë teknike. Kushtet më pak kufizuese në kuptimin e Nenit 3(3), nënkuptojnë se Shtetet Anëtare mund të lejojnë një vlerë më të lartë për "ciklin e punës".

6.8 Harmonizimi i spektrit radio për përdorim nga pajisjet me rreze të shkurtër brenda brezave të frekuencave 874–876 MHz dhe 915–921 MHz

(*Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2022/172 i datës 7 Shkurt 2022 për ndryshimin e Vendimit 2018/1538)*

(njoftuar me dokumentin C(2022) 608)

KOMISIONI EVROPIAN,
Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Vendimin Nr. 676/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 7 mars 2002 mbi kuadrin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin Radio), dhe në veçanti nenin 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë sa vijon:
(1) Pajisjet me rreze të shkurtër zakonisht janë produkte të tregut masiv ose pajisje portative, ose të dyja, të cilat mund të transportohen dhe përdoren lehtësisht përtej kufijve.
Dallimet në kushtet e aksesit në spektër mund të pengojnë lëvizjen e lirë të tyre, të rrisin kostot e prodhimit dhe të krijojnë rrezik interferencash të dëmshme me aplikime dhe shërbime të tjera radio për shkak të përdorimit të paautorizuar.

Vendimi 2006/771/EC i Komisionit harmonizoi kushtet teknike për përdorimin e spektrit nga një gamë e gjerë pajisjesh me rreze të shkurtër, të cilat si rezultat i nënshtrohen një regjimi rregullator shumë të lehtë dhe jo më shumë se një autorizimi të përgjithshëm sipas legjislacionit kombëtar.

(2)Vendimi Zbatues (BE) 2018/1538 harmonizoi kushtet teknike për përdorimin e brezave të frekuencave 874–876 MHz dhe 915–921 MHz nga zgjidhje të avancuara të identifikimit me radiofrekuencë (RFID) si dhe nga aplikime të Internetit të Gjërave (IoT) të bazuara në pajisje me rreze të shkurtër të lidhura në rrjete të të dhënave.
Në këto breza frekuencash, mjedisi i bashkëndarjes së spektrit është i ndryshëm nga ai që zbatohet sipas Vendimit 2006/771/EC, prandaj kërkohet një regjim rregullator specifik.

(3) Megjithëse brezat 873–874,4 MHz dhe 918–919,4 MHz nuk janë të harmonizuar për përdorimin e sistemit global për komunikime mobile hekurudhore (GSM-R) sipas legjislacionit të Bashkimit ose

një vendimi të ECC-së, këto breza mund të përdoren për këtë qëllim në nivel kombëtar në përputhje me Rregulloret Radio të ITU-së.
Prandaj, kur kushtet teknike të harmonizuara nuk janë të mjaftueshme për të mbrojtur përdorimin e këtyre brezave për një zgjerim kombëtar të GSM-R (E-GSM-R), shtetet anëtare mund t'i nënshtrojnë pajisjet me rreze të shkurtër kërkesave shtesë pa ndikuar kushtet e harmonizuara të aksesit në spektër.

Këto kufizime duhet të sigurojnë koordinimin ndërmjet përdoruesve të E-GSM-R dhe pajisjeve RFID ose pajisjeve SRD të lidhura në rrjet.

(4)Përdorimi i harmonizuar për radiokomunikimet mobile hekurudhore në brezat e çiftuar 874,4–880,0 MHz dhe 919,4–925,0 MHz, të cilët janë ngjitur me nën-brezat 874–874,4 MHz dhe 917,4–919,4 MHz të harmonizuar për pajisjet me rreze të shkurtër, rregullohet nga Vendimi Zbatues (BE) 2021/1730.
Bashkëjetesa ndërmjet pajisjeve me rreze të shkurtër në brezat 874–874,4 MHz dhe 917,4–919,4 MHz dhe radiokomunikimeve hekurudhore në brezat fqinjë u vlerësua në Raportin 74 të CEPT-it.

(5)Në përputhje me nenin 1(4) të Vendimit Nr. 676/2002/EC, Shtetet Anëtare ruajnë të drejtën për të organizuar dhe përdorur spektrin radio për qëllime të rendit publik, sigurisë publike dhe mbrojtjes.
Në këtë kuadër, ato mbeten të lira të mbrojnë përdorimin ekzistues dhe të ardhshëm të brezave të frekuencave 874–876 MHz dhe 915–921 MHz, si dhe të brezave fqinjë, për qëllime ushtarake dhe qëllime të tjera të sigurisë publike dhe rendit publik, duke ndjekur njëkohësisht objektivin për të vënë në dispozicion brezat minimalë bazë të harmonizuar për pajisjet me rreze të shkurtër të lidhura në rrjet, në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në këtë Vendim dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së.

(6)Për të pasqyruar zhvillimet teknologjike dhe të tregut në fushën e pajisjeve me rreze të shkurtër, në korrik 2006 iu dha CEPT-it një mandat i përhershëm, në përputhje me nenin 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/EC, për të përditësuar Aneksin e Vendimit 2006/771/EC.
Puna e kryer në bazë të këtij mandati të përhershëm (cikli i shtatë i përditësimit) shërbeu gjithashtu si bazë për Vendimin Zbatues (BE) 2018/1538, i cili siguroi spektër shtesë për pajisjet me rreze të shkurtër brenda brezave 874–876 MHz dhe 915–921 MHz.

(7)Më 16 korrik 2019, Komisioni publikoi letrën udhëzuese për ciklin e tetë të përditësimit të Vendimit 2006/771/EC.
Në përgjigje të mandatit të përhershëm dhe në përputhje me këtë udhëzim, CEPT i paraqiti Komisionit më 5 mars 2021 Raportin 77, i cili përmban disa propozime për ndryshimin e Vendimit Zbatues (BE) 2018/1538.

Këto përfshijnë ndryshimin e përkufizimeve në lidhje me pajisjet me rreze të shkurtër, për të shmangur paqartësitë dhe për të siguruar përputhshmëri me Vendimin 2006/771/EC.

Ato propozojnë gjithashtu rivlerësimin e disa parametrave teknikë për kategoritë e pajisjeve me rreze të shkurtër që mbulohen nga Vendimi Zbatues (BE) 2018/1538.

Raporti 77 i CEPT-it përbën bazën teknike të këtij Vendimi.

(8)Pajisjet me rreze të shkurtër që funksionojnë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Vendim duhet gjithashtu të jenë në përputhje me Direktivën 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
(9)Prandaj, Vendimi Zbatues (BE) 2018/1538 duhet të ndryshohet.
(10)Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radio.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
(1)Vendimi (BE) 2018/1538 ndryshohet si më poshtë:
Neni 2 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

Neni 2
Për qëllimet e këtij Vendimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(1)"Pajisje me rreze të shkurtër" nënkupton një pajisje radio që ofron komunikim njëdrejtimësh ose dydrejtimësh dhe që merr dhe/ose transmeton në një distancë të shkurtër me fuqi të ulët.
(2)"Mbi bazë mos-ndërhyrjeje dhe pa mbrojtje" nënkupton që:

- nuk mund të shkaktohet interferencë e dëmshme ndaj asnjë shërbimi radiokomunikimi; dhe
- nuk mund të kërkohet mbrojtje e këtyre pajisjeve kundër interferencave që vijnë nga shërbimet radiokomunikuese.

(3)"Kategori e pajisjeve me rreze të shkurtër" nënkupton një grup pajisjesh me rreze të shkurtër ose pajisjesh me rreze të shkurtër të lidhura në rrjet, të cilat përdorin spektër me mekanizma të ngjashëm teknikë të aksesit në spektër ose bazohen në skenarë të përbashkët përdorimi.

Tabela e mëposhtme specifikon kombinime të ndryshme të brezit të frekuencës dhe kategorisë së pajisjeve me rreze të shkurtër veprimi (sipas përkufizimit në nenin 2(6)), si dhe kushtet teknike të harmonizuara për qasjen në spektër dhe afatet përkatëse të zbatimit.

- Shtetet Anëtare duhet të lejojnë përdorimin e spektrit deri në fuqinë e transmetimit, intensitetin e fushës ose densitetin e fuqisë të dhënë në këtë tabelë. Në përputhje me nenin 3(3), ato mund të vendosin kushte më pak kufizuese, pra të lejojnë përdorimin e spektrit me fuqi më të lartë transmetimi, intensitet fushe ose densitet fuqie, me kusht që kjo të mos ulë ose të mos cenojë bashkëjetesën e përshtatshme midis pajisjeve me rreze të shkurtër në brezat e harmonizuar nga kjo Vendim.
- Shtetet Anëtare mund të vendosin vetëm "parametrat shtesë (rregullat e kanalizimit dhe/ose të aksesit në kanal dhe përdorimit të kanalit)" të përcaktuara në tabelë dhe nuk duhet të shtojnë parametra të tjerë apo kërkesa të tjera për akses në spektër dhe zbutje ndërhyrjesh. Kushtet më pak kufizuese, në kuptimin e nenit 3(3), nënkuptojnë se Shtetet Anëtare mund t'i heqin plotësisht "parametrat shtesë (rregullat e kanalizimit dhe/ose të aksesit në kanal dhe përdorimit të kanalit)" në një qelizë të caktuar ose të lejojnë vlera më të larta, me kusht që të mos cenohet mjedisi i duhur i ndarjes së spektrit në brezin e harmonizuar.
- Shtetet Anëtare mund të vendosin vetëm "kufizimet e tjera të përdorimit" të përcaktuara në tabelë dhe nuk duhet të shtojnë kufizime të tjera shtesë të përdorimit, përveç rasteve kur zbatohen kushtet e përmendura në nenin 3(2). Meqenëse mund të vendosen kushte më pak kufizuese në kuptimin e nenit 3(3), Shtetet Anëtare mund të heqin një ose të gjitha këto kufizime, me kusht që të mos cenohet mjedisi i duhur i ndarjes së spektrit në brezin e harmonizuar.

Brezat e frekuencave me kushtet teknike të harmonizuara për pajisjet me rreze të shkurtër veprimi

Nr.	Brezi i frekuencës	Kategoria e pajisjes	Kufiri i fuqisë	Parametra shtesë	Kufizime përdorimi	Afati i zbatimit
1	874 – 874.4 MHz	Pajisje jo specifike me rreze të shkurtër veprimi [1]	500 mW ERP	Kërkohet Kontroll Adaptiv i Fuqisë (APC) ose teknikë ekuivalente. Gjerësia e brezit ≤ 200 kHz. Duty cycle ≤ 10% për pikat e aksesit në rrjet dhe ≤ 2.5% për pajisjet e tjera. Duhet të përdoren mekanizma për akses në spektër dhe zbutje të ndërhyrjeve në përputhje me Direktivën 2014/53/BE.	Vetëm për rrjete të të dhënave. Të gjitha pajisjet portative dhe lëvizëse duhet të kontrollohen nga një pikë qendrore aksesi në rrjet.	1 korrik 2022
2	917.4 – 919.4 MHz	Pajisje për transmetim të dhënash me brez të gjerë [3]	25 mW ERP	Gjerësia e brezit > 600 kHz dhe ≤ 1 MHz. Duty cycle ≤ 10% për pikat e aksesit në rrjet dhe ≤ 2.8% për pajisjet e tjera. Duhet të përdoren teknika për akses në spektër dhe shmangie të ndërhyrjeve.	Vetëm për pajisje me brez të gjerë në rrjete të të dhënave. Të gjitha pajisjet duhet të kontrollohen nga një pikë aksesi qendrore.	1 korrik 2022
3	916.1 – 918.9 MHz	Pajisje RFID (Identifikim me Radiofrekuencë) [2]	Transmetimet e interrogatorëve lejohen me 4 W ERP vetëm në frekuencat qendrore 916.3 MHz, 917.5	Gjerësia e brezit ≤ 400 kHz. Duhet të përdoren teknika për akses në spektër dhe zbutje të	Sipas shënimeve [5], [6] dhe [7].	1 korrik 2022

			MHz dhe 918.7 MHz	ndërhyrjeve në përputhje me Direktivën 2014/53/BE.		
4	917.3 – 918.9 MHz	Pajisje jo specifike me rreze të shkurtër veprimi [1]	500 mW ERP	Transmetimet lejohen vetëm në nën-brezat 917.3–917.7 MHz dhe 918.5–918.9 MHz. Kërkohet APC ose teknikë ekuivalente. Gjerësia e brezit ≤ 200 kHz. Duty cycle ≤ 10% për pikat e aksesit dhe ≤ 2.5% për pajisjet e tjera.	Vetëm për rrjete të të dhënave. Të gjitha pajisjet duhet të kontrollohen nga një pikë aksesi qendrore.	1 korrik 2022
5	917.4 – 919.4 MHz	Pajisje jo specifike me rreze të shkurtër veprimi [1]	25 mW ERP	Gjerësia e brezit ≤ 600 kHz. Duty cycle ≤ 1%. Duhet të përdoren teknika për akses në spektër dhe shmangie të ndërhyrjeve.	Vetëm për pajisje me rreze të shkurtër veprimi në rrjete të të dhënave. Të gjitha pajisjet duhet të kontrollohen nga një pikë aksesi qendrore.	1 korrik 2022

Kategoria e pajisjeve me rreze të shkurtër jo-specifike përfshin të gjitha llojet e pajisjeve radio, pavarësisht aplikimit ose qëllimit të tyre, të cilat përmbushin kushtet teknike të përcaktuara për një brez të caktuar frekuencash. Përdorimet tipike përfshijnë telemetrinë, telekomandimin, alarmet, transmetimet e të dhënave në përgjithësi dhe aplikime të tjera.

Kategoria e pajisjeve të identifikimit me radiofrekuencë (RFID) përfshin sisteme komunikimi radio të bazuara në etiketë/interrogator, të përbëra nga pajisje radio (etiketa) të vendosura në objekte të gjalla ose jo të gjalla dhe nga njësi transmetuese/marrëse (interrogatorë), të cilët aktivizojnë etiketat dhe marrin të dhënat prej tyre. Përdorimet tipike përfshijnë gjurmimin dhe identifikimin e objekteve, si

për shembull mbikëqyrja elektronike e artikujve (EAS), si dhe mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave që lidhen me objektet ku janë vendosur etiketat, të cilat mund të jenë pa bateri, me ndihmë baterie ose me bateri. Përgjigjet nga një etiketë verifikohen nga interrogatori i saj dhe i dërgohen sistemit pritës.

Kategoria e pajisjeve të transmetimit të të dhënave me brez të gjerë përfshin pajisje radio që përdorin teknika modulimi me brez të gjerë për të aksesuar spektrin. Përdorimet tipike përfshijnë sisteme të aksesit pa tela si rrjetet lokale radio (WAS/RLAN) ose pajisje me rreze të shkurtër me brez të gjerë në rrjetet e të dhënave.

Një pikë aksesi në rrjet në një rrjet të dhënash është një pajisje fikse tokësore me rreze të shkurtër, e cila shërben si pikë lidhjeje për pajisjet e tjera me rreze të shkurtër në rrjetin e të dhënave, për t'i lidhur ato me platformat e shërbimit që ndodhen jashtë atij rrjeti të dhënash. Termi "rrjet i të dhënave" i referohet disa pajisjeve me rreze të shkurtër, përfshirë pikën e aksesit në rrjet, si komponentë të rrjetit, si dhe lidhjeve pa tela midis tyre.

Sipas nenit 3(1), brezat e frekuencave duhet të përcaktohen dhe të vihen në dispozicion mbi bazë jo-ekskluzive dhe të ndarë. Kushtet teknike të harmonizuara duhet të bëjnë të mundur që shumica e pajisjeve me rreze të shkurtër në shumicën e Shteteve Anëtare të operojnë sipas një regjimi të përgjithshëm autorizimi sipas ligjit kombëtar. Kjo nuk cenon nenet 46 dhe 51 të Direktivës (BE) 2018/1972, si dhe nenet 3(2) dhe 7 të Direktivës 2014/53/BE. Shtetet Anëtare mund të kufizojnë përdorimin e kësaj pike në mënyrë që instalimi dhe funksionimi të kryhen vetëm nga përdorues profesionalë dhe mund të marrin në konsideratë autorizimin individual, për shembull për të administruar ndarjen gjeografike dhe/ose zbatimin e teknikave zbutëse për të siguruar mbrojtjen e shërbimeve radio.

Në Shtetet Anëtare ku pjesë ose i gjithë ky diapazon frekuencash përdoret për qëllime të rendit dhe sigurisë publike dhe nuk është e mundur koordinimi, Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos e zbatojnë këtë hyrje pjesërisht ose plotësisht, në përputhje me nenin 1(4) të Vendimit 676/2002/KE dhe nenin 3(2) të këtij Vendimi.

Ky diapazon frekuencash 874–874,4 MHz është brezi minimal bazë i harmonizuar.

Ky diapazon frekuencash 917,4–919,4 MHz është brezi minimal bazë i harmonizuar.

Etiketat RFID përgjigjen në një nivel shumë të ulët fuqie (-10 dBm e.r.p.) në një diapazon frekuencash rreth kanaleve të interrogatorit RFID dhe duhet të përmbushin kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE.

6.9 Përdorimi i harmonizuar i spektrit radio në brezin e frekuencave 5 GHz për zbatimin e sistemeve të aksesit pa tela, përfshirë rrjetet lokale radio (WAS/RLAN)

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2022/179 i datës 8 Shkurt 2022 që shfuqizon vendimin 2005/513/CE)
(njoftuar me dokumentin C(2022) 628)

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian, Duke pasur parasysh Vendimin Nr. 676/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 7 mars 2002 mbi kuadrin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin Radio), dhe në veçanti nenin 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë sa vijon:

(1) Komunikimi i Komisionit "Busulla Digjitale 2030: rruga evropiane për Dekadën Digjitale" përcakton objektiva të rinj lidhjeje për Bashkimin që do të arrihen përmes vendosjes dhe përdorimit të gjerë të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë. Një nga objektivat është që deri në vitin 2030 të gjitha familjet në Bashkim të mbulohen nga një rrjet Gigabit. Sistemet e aksesit pa tela, përfshirë aplikimet e rrjeteve lokale radio (WAS/RLAN), kontribuojnë në masë të madhe në arritjen e këtij objektivi të mbulimit.

(2) Aksesi në rrjetet lokale radio rregullohet nga neni 56 i Direktivës (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Rrjetet lokale radio përkufizohen nga kjo Direktivë si sisteme aksesi pa tela me fuqi të ulët, që funksionojnë në një rreze të vogël, me rrezik të ulët ndërhyrjeje ndaj sistemeve të tjera të ngjashme të vendosura në afërsi nga përdorues të tjerë, duke përdorur në mënyrë jo-ekskluzive spektrin radio të harmonizuar.

(3) Vendimi i Komisionit 2005/513/EC harmonizoi përdorimin e spektrit radio në brezin 5 GHz (5150-5350 MHz dhe 5470-5725 MHz) për sistemet e aksesit pa tela, përfshirë rrjetet lokale radio.

(4) Në përputhje me Rregulloret Radio të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), brezat e frekuencave 5150-5350 MHz dhe 5470-5725 MHz i janë caktuar shërbimit celular, me përjashtim të shërbimit celular aeronautik, mbi bazë primare në të tre rajonet e ITU-së, duke marrë parasysh nevojën për mbrojtjen e shërbimeve të tjera primare në këto breza frekuencash. Konferenca Botërore e Radiokomunikimeve e vitit 2003 (WRC-03) miratoi Rezolutën 229 mbi "Përdorimin e brezave 5150-5250 MHz, 5250-5350 MHz dhe 5470-5725 MHz nga shërbimi celular për zbatimin e Sistemeve të Aksesit Pa Tela, përfshirë Rrjetet Lokale Radio". Kjo rezolutë, e rishikuar në Konferencën Botërore të Radiokomunikimeve të vitit 2019 (WRC-19), zgjeroi fushën e përdorimit në ambiente të brendshme për trenat dhe automjetet rrugore, përcaktoi fuqinë maksimale të emetimit për WAS/RLAN që përdorin brezin 5150-5250 MHz në automjetet rrugore dhe lejoi përdorim të kufizuar në ambiente të jashtme në brezin 5150-5250 MHz duke mbrojtur përdorimet e tjera ekzistuese në atë brez.

(5) Në disa Shtete Anëtare ekziston një nevojë kritike për funksionimin e radarëve ushtarakë dhe meteorologjikë në brezat midis 5250 MHz dhe 5850 MHz, të cilët kërkojnë mbrojtje të veçantë kundër interferencave të dëmshme nga WAS/RLAN. Në këtë kontekst, kushtet teknike dhe operative për përdorimin e WAS/RLAN duhet të sigurojnë mbrojtjen e interesave legjitime publike që lidhen me shërbime të tjera radio, përfshirë radarët ushtarakë dhe meteorologjikë. Ekziston gjithashtu nevoja për të mbrojtur qëndrueshmërinë e sistemeve të lidhura me shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës (aktiv), shërbimin e kërkimit hapësinor (aktiv) dhe lidhjet ushqyese të shërbimit satelitor celular, veçanërisht në brezin e frekuencave 5150-5350 MHz.

(6) Më 14 prill 2020, për të zbatuar rezultatet e WRC-19 që rishikoi Rezolutën 229, Komisioni i dha, në përputhje me nenin 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/EC, një mandat Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT) për të ndryshuar Vendimin 2005/513/EC mbi përdorimin e harmonizuar të spektrit radio në brezin 5 GHz për zbatimin e WAS/RLAN. Sipas mandatit, CEPT-it iu dhanë dy detyra. E para ishte të propozonte kushte teknike për të ndryshuar Vendimin 2005/513/EC bazuar në rezultatet e WRC-19 (rishikimi i Rezolutës 229) për brezin 5150-5250 MHz. Detyra e dytë ishte të propozonte përditësime përkatëse të kushteve teknike të harmonizuara për WAS/RLAN në brezat 5150-5350 MHz dhe 5470-5725 MHz, sipas rastit. Qëllimi i këtyre përditësimeve ishte të shqyrtonin mundësitë e përdorimit të këtyre WAS/RLAN në bordin e automjeteve (aeroplanë, automjete rrugore (makina, autobusë), trena etj.) dhe të vlerësonin realizueshmërinë e përdorimit të WAS/RLAN për lidhjet radio të sistemeve ajrore pa pilot (UAS).

(7) Në përputhje me këtë mandat, CEPT publikoi Raportin 79 mbi përdorimin e harmonizuar të spektrit radio në brezin 5 GHz për zbatimin e WAS/RLAN pas WRC-19. Raporti CEPT 79 përmban kushte teknike të rishikuara për WAS/RLAN në brezin 5150-5250 MHz për rastet e mëposhtme të përdorimit në ambiente të brendshme: brenda ndërtesave dhe instalimeve në automjete rrugore, trena dhe aeroplanë, si dhe përdorim të kufizuar në ambiente të jashtme. Operimi i UAS lejohet vetëm në brezin 5170-5250 MHz si një rast specifik përdorimi në ambiente të jashtme. Kushtet teknike të propozuara për brezin 5250-5350 MHz lejojnë përdorimin në ambiente të brendshme vetëm brenda ndërtesave. Përdorimi i brezit 5470-5725 MHz është i mundur në ambiente të brendshme dhe të jashtme, por duke përjashtuar instalimet në automjete rrugore, trena dhe aeroplanë, si dhe përdorimin për UAS. Rezultatet e mandatit të përfshira në Raportin CEPT 79 u përdorën si bazë për këtë Vendim.

(8) Në Raportin e tij 79, CEPT konfirmoi një mirëkuptim të përbashkët mbi rëndësinë e zgjidhjes së problemit të interferencave të dëmshme ndaj radarëve meteorologjikë në brezin 5600-5650 MHz. Për të kontribuar në uljen e interferencave të dëmshme ndaj radarëve meteorologjikë, ky Vendim duhet të përcaktojë kushte teknike për instalimet WAS/RLAN në automjete rrugore, trena dhe aeroplanë, si dhe përdorimin nga sistemet ajrore pa pilot (UAS), dhe të qartësojë kërkesat e zbatueshme për përzgjedhjen dinamike të frekuencës (DFS). Ky Vendim mund të rishikohet në të ardhmen për të vlerësuar efektivitetin e këtyre masave.

(9) Kur përdorime të tjera përveç WAS/RLAN janë të kufizuara gjeografikisht dhe të njohura nga autoritetet rregullatore kombëtare, Shtetet Anëtare duhet të kenë të drejtën të autorizojnë në nivel kombëtar instalimet e brendshme në trena duke përdorur brezat 5250-5350 MHz dhe 5470-5725 MHz, ku përdorimi i WAS/RLAN mund të kontrollohet dhe kufizohet gjeografikisht.

(10) Ky Vendim bazohet dhe zhvillon më tej parimet dhe dispozitat e përcaktuara në Vendimin 2005/513/EC. Në interes të sigurisë juridike, Vendimi 2005/513/EC duhet të shfuqizohet.

(11) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radio.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1
Ky Vendim harmonizon kushtet për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të brezave të frekuencave 5150-5250 MHz, 5250-5350 MHz dhe 5470-5725 MHz për sistemet e aksesit pa tela, përfshirë rrjetet lokale radio (WAS/RLAN).

Neni 2
Për qëllimet e këtij Vendimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
(a) "Sisteme aksesi pa tela, përfshirë rrjetet lokale radio (WAS/RLAN)" janë sisteme radio me brez të gjerë që lejojnë akses pa tela për aplikime publike dhe private, pavarësisht topologjisë së rrjetit bazë.
(b) "Përdorim në ambiente të brendshme" nënkupton përdorimin brenda një hapësire të mbyllur që siguron dobësimin e nevojshëm të sinjalit për të lehtësuar bashkëndarjen me shërbime të tjera. Përdorimi në ambiente të brendshme mund të klasifikohet në katër raste përdorimi, të identifikuara në kushtet teknike të Aneksit të këtij Vendimi, që përfaqësojnë skenarë specifikë:

- brenda ndërtesave;
- brenda automjeteve rrugore;
- brenda trenave;
- brenda avionëve.

(c) "Fuqi ekuivalente izotropike e rrezatuar (e.i.r.p.)" nënkupton produktin e fuqisë së furnizuar në antenë dhe fitimit të antenës në një drejtim të caktuar në raport me një antenë izotropike (fitim absolut ose izotropik).
(d) "Fuqi mesatare ekuivalente izotropike e rrezatuar (e.i.r.p.)" nënkupton e.i.r.p. gjatë shpërthimit të transmetimit që korrespondon me fuqinë më të lartë, nëse zbatohet kontrolli i fuqisë.

Neni 3
Deri më 31 mars 2022, Shtetet Anëtare do të caktojnë dhe do të vënë në dispozicion brezat e frekuencave:

- 5150–5250 MHz,
- 5250–5350 MHz,
- 5470–5725 MHz,

mbi bazë jo-ekskluzive, për zbatimin e WAS/RLAN në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në Aneks.

Neni 4
Shtetet Anëtare do të monitorojnë zhvillimin e standardeve dhe teknologjisë në lidhje me përdorimin e brezave të frekuencave:

- 5150–5250 MHz,
- 5250–5350 MHz,
- 5470–5725 MHz,

për WAS/RLAN dhe do t'i raportojnë gjetjet e tyre Komisionit, me kërkesë të tij ose me iniciativën e tyre, për të mundësuar një rishikim në kohë të këtij Vendimi.

Neni 5
Vendimi 2005/513/EC shfuqizohet.

ANEKSI

Kushtet teknike të harmonizuara për WAS/RLAN në brezat e frekuencave 5150-5250 MHz, 5250-5350 MHz dhe 5470-5725 MHz.

Tabela 1

WAS/RLAN në brezin e frekuencave 5150–5250 MHz

Parametri	Kushtet teknike
Brezi i frekuencave	5150–5250 MHz
Përdorimi i lejuar	Përdorim në ambiente të brendshme, duke përfshirë instalimet brenda automjeteve rrugore, trenave dhe avionëve, si dhe përdorim të kufizuar në ambiente të jashtme (Shënimi 1). Përdorimi nga sistemet ajrore pa pilot (UAS) kufizohet në brezin 5170–5250 MHz.
Fuqia maksimale mesatare ekuivalente izotropike e rrezatuar (e.i.r.p.) për emetimet brenda brezit	200 mW
Përjashtime	— 40 mW fuqi maksimale mesatare e.i.r.p. zbatohet për instalimet brenda vagonëve të trenave me humbje dobësimi mesatare më të vogël se 12 dB.
Dendësia maksimale mesatare e.i.r.p. për emetimet brenda brezit	10 mW/MHz në çdo brez prej 1 MHz.

Shënimi 1

Nëse pajisja përdoret në ambiente të jashtme, ajo nuk duhet të jetë e montuar:

- në një instalim fiks;
- në pjesën e jashtme të automjeteve rrugore;
- në infrastrukturë fikse;
- në një antenë fikse të jashtme.

Teknikat e aksesit në spektër dhe zbutjes së interferencave

Duhet të përdoren teknika të aksesit në spektër dhe zbutjes së interferencave që sigurojnë një nivel të përshtatshëm performance për të përmbushur kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Kur teknikat përkatëse përshkruhen në standarde të harmonizuara ose në pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2014/53/BE, duhet të sigurohet një performancë të paktën ekuivalente me nivelin e performancës që lidhet me këto teknika.

Tabela 2

WAS/RLAN në brezin e frekuencave 5250–5350 MHz

Parametri	Kushtet teknike

Brezi i frekuencave	5250–5350 MHz
Përdorimi i lejuar	Përdorim në ambiente të brendshme: vetëm brenda ndërtesave. Instalimet në automjete rrugore, trena dhe avionë nuk lejohen (Shënimi 2). Përdorimi në ambiente të jashtme nuk lejohet.
Fuqia maksimale mesatare e.i.r.p. për emetimet brenda brezit	200 mW
Dendësia maksimale mesatare e.i.r.p. për emetimet brenda brezit	10 mW/MHz në çdo brez prej 1 MHz.
Teknikat e zbutjes që duhet të përdoren	Kontrolli i fuqisë së transmetimit (TPC) dhe Përzgjedhja Dinamike e Frekuencës (DFS). Teknikat alternative të zbutjes mund të përdoren nëse sigurojnë të paktën performancë dhe nivel mbrojtjeje të spektrit ekuivalent për të përmbushur kërkesat përkatëse thelbësore të Direktivës 2014/53/BE dhe nëse respektojnë kërkesat teknike të këtij Vendimi.
Kontrolli i fuqisë së transmetimit (TPC)	TPC duhet të sigurojë, mesatarisht, një faktor zbutjeje prej të paktën 3 dB mbi fuqinë maksimale të lejuar të daljes së sistemeve.Nëse kontrolli i fuqisë së transmetimit nuk përdoret, fuqia maksimale mesatare e lejuar e.i.r.p. dhe kufiri përkatës i dendësisë mesatare e.i.r.p. duhet të reduktohen me 3 dB.

Përzgjedhja Dinamike e Frekuencës (DFS)	DFS përshkruhet në Rekomandimin ITU-R M.1652-1 për të siguruar funksionim të përputhshëm me sistemet e radiopërcaktimit.Mekanizmi DFS duhet të sigurojë që probabiliteti i përzgjedhjes së një kanali të caktuar të jetë i njëjtë për të gjitha kanalet e disponueshme brenda brezave 5250–5350 MHz dhe 5470–5725 MHz. Mekanizmi DFS duhet gjithashtu të sigurojë, mesatarisht, një shpërndarje pothuajse uniforme të ngarkesës së spektrit. WAS/RLAN duhet të zbatojë një sistem DFS që siguron mbrojtje kundër interferencave ndaj radarëve të paktën po aq efektive sa DFS i përshkruar në standardin ETSI EN 301 893 V2.1.1. Konfigurimet (hardware dhe/ose software) të lidhura me DFS nuk duhet të jenë të aksesueshme nga përdoruesi nëse ndryshimi i tyre do ta bënte pajisjen jo në përputhje me kërkesat DFS. Kjo përfshin: (a) moslejimin e përdoruesit të ndryshojë vendin e operimit dhe/ose brezin e frekuencës nëse kjo do ta bënte pajisjen jo në përputhje me kërkesat DFS; (b) mospranimin e software-it ose firmware-it që do ta bënte pajisjen jo në përputhje me kërkesat DFS.

Tabela 3

WAS/RLAN në brezin e frekuencave 5470–5725 MHz

Parametri	Kushtet teknike
Brezi i frekuencave	5470–5725 MHz
Përdorimi i lejuar	Përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Instalimet në automjete rrugore, trena dhe avionë, si dhe përdorimi për sisteme ajrore pa pilot (UAS), nuk lejohen (Shënimi 3).
Fuqia maksimale mesatare ekuivalente izotropike e rrezatuar (e.i.r.p.) për emetimet brenda brezit	1 W
Dendësia maksimale mesatare e.i.r.p. për emetimet brenda brezit	50 mW/MHz në çdo brez prej 1 MHz.
Teknikat e zbutjes që duhet të përdoren	Duhet të përdoren:Kontrolli i Fuqisë së Transmetimit (TPC); Përzgjedhja Dinamike e Frekuencës (DFS).Teknika alternative të zbutjes mund të përdoren nëse sigurojnë të paktën një performancë dhe nivel mbrojtjeje të spektrit ekuivalent për të përmbushur kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE dhe nëse respektojnë kërkesat teknike të këtij Vendimi.
Kontrolli i Fuqisë së Transmetimit (TPC)	TPC duhet të sigurojë, mesatarisht, një faktor zbutjeje prej të paktën 3 dB mbi fuqinë maksimale të lejuar të daljes së sistemeve.

	Nëse kontrolli i fuqisë së transmetimit nuk përdoret, fuqia maksimale mesatare e lejuar e.i.r.p. dhe kufiri përkatës i dendësisë mesatare e.i.r.p. duhet të reduktohen me 3 dB.
Përzgjedhja Dinamike e Frekuencës (DFS)	DFS përshkruhet në Rekomandimin ITU-R M.1652-1 për të siguruar funksionim të përputhshëm me sistemet e radiopërcaktimit. Mekanizmi DFS duhet të sigurojë që probabiliteti i përzgjedhjes së një kanali të caktuar të jetë i njëjtë për të gjitha kanalet e disponueshme brenda brezave: • 5250–5350 MHz; • 5470–5725 MHz. Mekanizmi DFS duhet gjithashtu të sigurojë, mesatarisht, një shpërndarje pothuajse uniforme të ngarkesës së spektrit. WAS/RLAN duhet të zbatojë një sistem DFS që siguron mbrojtje ndaj interferencave me radarët të paktën po aq efektive sa DFS i përshkruar në standardin ETSI EN 301 893 V2.1.1. Konfigurimet (hardware dhe/ose software) të lidhura me DFS nuk duhet të jenë të aksesueshme nga përdoruesi nëse ndryshimi i tyre do ta bënte pajisjen jo në përputhje me kërkesat DFS. Kjo përfshin:(a) moslejimin e përdoruesit të ndryshojë vendin e operimit dhe/ose brezin e frekuencës nëse kjo do ta bënte pajisjen jo në përputhje me kërkesat DFS;(b) mospranimin e software-it dhe/ose firmware-it që do ta bënte pajisjen jo në përputhje me kërkesat DFS.

Shënimi 3 Funksionimi i instalimeve WAS/RLAN në **aeroplanë të mëdhenj** (duke përjashtuar helikopterët shumëmotorësh), me përjashtim të brezit të frekuencave **5600–5650 MHz**, lejohet deri më **31 dhjetor 2028**, me një fuqi maksimale mesatare e.i.r.p. prej **100 mW** për emetimet brenda brezit.

Teknikat e aksesit në spektër dhe zbutjes së interferencave

Duhet të përdoren teknika të aksesit në spektër dhe zbutjes së interferencave që sigurojnë një nivel të përshtatshëm performance për të përmbushur kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE.
Kur teknikat përkatëse përshkruhen në standarde të harmonizuara ose në pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2014/53/BE, duhet të sigurohet performancë të paktën ekuivalente me nivelin e performancës së lidhur me këto teknika.

6.10 Përdorimi i harmonizuar i spektrit radio në brezin e frekuencave 5 875 – 5 936 MHz për aplikimet e sistemeve inteligjente të transportit (ITS) të lidhura me sigurinë

(*Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2020/1426 i datës 7 Tetor 2020 për shfuqizimin e Vendimit 2008/671/EC)*

(njoftuar me dokumentin C(2020) 6773)

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Vendimin nr. 676/2002/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 mars 2002, mbi kuadrin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin Radio), dhe në veçanti nenin 4(3) të tij,

Duke marrë parasysh sa vijon:

(1) Sistemet inteligjente të transportit (ITS) përfshijnë ITS rrugore dhe ITS për hekurudhat urbane. ITS rrugore përfshijnë sisteme bashkëpunuese të bazuara në komunikime në kohë reale ndërmjet mjetit (përfshirë automjetet, kamionët, biçikletat, motoçikletat, tramvajet, pajisjet e ndërtimit, pajisjet bujqësore, si dhe pajisjet për këmbësorët dhe çiklistët) dhe mjedisit të tij (mjete të tjera, infrastruktura etj.). Në disa raste, pajisje të tilla ITS rrugore mund të përdoren edhe jashtë rrugëve publike (p.sh. në zona industriale, bujqësore ose ndërtimore). ITS për hekurudhat urbane përbëhen nga sisteme transporti publik të drejtuara në mënyrë të përhershme nga të paktën një sistem kontrolli dhe menaxhimi, të destinuara për të operuar shërbime lokale, urbane dhe periferike të transportit të pasagjerëve, të ndara nga trafiku i përgjithshëm rrugor dhe ai i këmbësorëve. ITS kanë potencialin të sjellin përmirësime të mëdha në efikasitetin e sistemit të transportit, në sigurinë e trafikut dhe në komoditetin gjatë udhëtimit.

(2) Vendimi i Komisionit 2008/671/KE harmonizoi përdorimin e spektrit radio në brezin e frekuencave 5 875–5 905 MHz (ose brezi 5,9 GHz) për aplikime ITS të lidhura me sigurinë. Ai njohu rolin qendror të ITS në një qasje të integruar ndaj sigurisë rrugore, duke shtuar teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në infrastrukturën e transportit dhe në automjete, me qëllim shmangien e situatave potencialisht të rrezikshme në trafik dhe reduktimin e numrit të aksidenteve.

(3) Direktiva 2010/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit krijoi një kuadër për vendosjen e sistemeve inteligjente të transportit në transportin rrugor dhe për ndërfaqet me mënyra të tjera transporti.

(4) Më 14 shtator 2016, pas miratimit të një pakete masash për një shoqëri evropiane me gigabit (duke përfshirë Planin e Veprimit për 5G), Komisioni theksoi lidhjen ndërmjet zhvillimit dhe vendosjes së rrjeteve 5G në Evropë dhe fushave kryesore të aplikimit, veçanërisht mobilitetit inteligjent (mobilitet i lidhur dhe i automatizuar).

(5) Më 30 nëntor 2016, Komisioni publikoi Komunikatën "Një strategji evropiane për ITS bashkëpunuese"**.** Në lidhje me spektrin radio, strategjia propozon ruajtjen e përcaktimit të spektrit të përdorur nga Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI) për komunikimet pa tela me rreze të shkurtër (ITS-G5) për shërbimet ITS të lidhura me sigurinë, si dhe mbështetjen e masave për mbrojtjen e brezit të frekuencave 5,9 GHz nga ndërhyrjet e dëmshme. Strategjia propozon gjithashtu që iniciativat për vendosjen e sistemeve inteligjente bashkëpunuese të transportit të zbatojnë teknikat përkatëse të zbutjes për bashkëjetesën e teknologjive, në përputhje me standardet dhe procedurat e ETSI-së

(6) Më 17 maj 2018, Komisioni miratoi Paketën e Tretë të Mobilitetit**,** e cila integroi strategjinë për sigurinë rrugore në një ekosistem më të gjerë evropian të mobilitetit të qëndrueshëm, të fokusuar në mobilitet të sigurt, të lidhur dhe të pastër. Në këtë paketë, automjetet pa shofer dhe sistemet e avancuara të lidhjes konsiderohen se do t'i bëjnë automjetet më të sigurta dhe më të lehta për t'u ndarë mes përdoruesve, si dhe do të zgjerojnë aksesin në shërbimet e mobilitetit për një numër më të madh përdoruesish.

(7) Në kuadër të këtij zhvillimi politik dhe rregullator në fushën e sigurisë rrugore, shtetet anëtare dhe industria ndërmorën iniciativa të ndryshme lidhur me përdorimin e brezit 5,9 GHz për zhvillimin dhe vendosjen e aplikimeve të sigurisë rrugore. Këto iniciativa përfshijnë Konsorciumin Car-2-Car Communications**,** platformën C-Roads, krijimin e Shoqatës Automotive 5G (5GAA)**,** si dhe rritjen e aktiviteteve në kuadër të Projektit të Partneritetit të Gjeneratës së Tretë (3GPP) dhe organeve të standardizimit si ETSI. Përpjekjet e industrisë çuan në zhvillimin e dy teknologjive konkurruese për komunikimin me rreze të shkurtër ndërmjet automjeteve dhe mjedisit të tyre, përkatësisht **ITS-G5** dhe teknologjisë LTE-V2X (Long Term Evolution – Vehicle-to-Everything)**.**

(8) Komuniteti i transportit hekurudhor urban konsideron se nevojiten të paktën 20 MHz spektër të harmonizuar për funksionimin e sistemeve CBTC (Communication-Based Train Control – Kontrolli i Trenave i Bazuar në Komunikim)**.** Këto sisteme mundësojnë menaxhimin e sigurt dhe efikas të operimeve hekurudhore urbane, veçanërisht duke shkurtuar intervalet ndërmjet trenave të njëpasnjëshëm, gjë që rrit kapacitetin e infrastrukturave të transportit publik. Në bazë të autorizimeve lokale, një numër linjash metroje në Bashkimin Evropian përdorin tashmë pjesë të brezit të frekuencave 5 905–5 935 MHz ose frekuenca edhe më të larta. Për këtë arsye, është e rëndësishme që spektri për këtë përdorim të harmonizohet në të gjithë Bashkimin, me qëllim garantimin e tregut unik edhe në sektorin e hekurudhave urbane dhe kontribuimin në objektivat mjedisore të Evropës.

(9) Në përputhje me nenin 4(2) të Vendimit nr. 676/2002/KE, më 18 tetor 2017 Komisioni i dha një mandat Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe të Telekomunikacioneve (CEPT) për të studiuar mundësinë e zgjerimit me 20 MHz të kufirit të sipërm të brezit të harmonizuar në nivel të Bashkimit për ITS të lidhura me sigurinë (5 875–5 905 MHz), deri në 5 925 MHz**,** si dhe për të lejuar përdorimin e këtij brezi edhe nga forma të tjera transporti, përveç transportit rrugor, siç është transporti hekurudhor urban që përdor sistemet CBTC, brenda këtij brezi frekuencash.

(10) Në përputhje me nenin 4(2) të Vendimit nr. 676/2002/KE, më 18 tetor 2017 Komisioni i dha një mandat Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe të Telekomunikacioneve (CEPT) për të studiuar mundësinë e zgjerimit me 20 MHz të kufirit të sipërm të brezit të harmonizuar në nivel të Bashkimit për ITS të lidhura me sigurinë (5 875–5 905 MHz), deri në 5 925 MHz, si dhe për të lejuar përdorimin e këtij brezi edhe nga forma të tjera transporti, përveç transportit rrugor, siç është transporti hekurudhor urban që përdor sistemet CBTC, brenda këtij brezi frekuencash. Në përgjigje të këtij mandati, CEPT publikoi më 11 mars 2019 një raport (Raporti CEPT 71 – ITS në brezin 5,9 GHz) ku rishikohen kushtet teknike dhe zgjerimi i brezit 5,9 GHz. Propozimet e përfshira në raport përfshijnë zgjerimin e përkufizimit të ITS, harmonizimin e brezit të frekuencave 5 875–5 925 MHz për aplikimet ITS të lidhura me sigurinë, harmonizimin e brezit të frekuencave 5 925–5 935 MHz për aplikimet ITS hekurudhore urbane të lidhura me sigurinë, kjo e fundit duke iu nënshtruar koordinimit kombëtar me shërbimet fikse dhe/ose studimeve për përcaktimin e kushteve të ndarjes së spektrit. Raporti propozon gjithashtu që aplikimeve ITS rrugore t'u jepet përparësi në frekuencat nën 5 915 MHz dhe aplikimeve ITS të hekurudhave urbane t'u jepet përparësi në frekuencat mbi 5 915 MHz. Në brezin e frekuencave 5 915–5 925 MHz, propozohet që përdorimi nga aplikimet ITS rrugore të kufizohet vetëm në komunikimet nga infrastruktura drejt automjetit (I2V – Infrastructure-to-Vehicle), derisa aplikimet ITS rrugore të jenë në gjendje të mbrojnë në mënyrë të përshtatshme aplikimet ITS të hekurudhave urbane. Në brezin

e frekuencave 5 915–5 935 MHz, propozohet që përdorimi nga ITS për hekurudhat urbane të bëhet mbi bazën e përdorimit të përbashkët dhe në varësi të rrethanave kombëtare, si dhe të kërkesës së palëve të interesuara për aplikime ITS në hekurudhat urbane. Autorizimet individuale për ITS hekurudhore urbane (5 915–5 935 MHz), infrastrukturën ITS rrugore (5 915–5 925 MHz), dhe shërbimet fikse (mbi 5 925 MHz) duhet të mundësojnë, kur është e nevojshme, koordinimin në nivel kombëtar ndërmjet këtyre përdorimeve, me qëllim sigurimin e bashkëjetesës së tyre pa ndërhyrje të dëmshme.

(11) Gjatë vënies në dispozicion të brezit të frekuencave 5 915–5 935 MHz për ITS hekurudhore urbane, sa më shpejt që të jetë praktikisht e arsyeshme pas përcaktimit të tij në përputhje me këtë Vendim, shtetet anëtare duhet t'u kushtojnë vëmendjen e duhur sistemeve ekzistuese hekurudhore urbane që tashmë operojnë në këtë brez (ose në një pjesë të tij) sipas kushteve teknike të ndryshme. Kjo duhet të bëhet për të siguruar një afat kohor të mjaftueshëm që lejon përshtatjen e pajisjeve ekzistuese të trenave dhe të rrjetit me kushtet teknike të harmonizuara, të përcaktuara nga ky Vendim.

(12) Rezultatet e punës së kryer nga CEPT në bashkëpunim me ETSI përbëjnë bazën teknike për këtë Vendim.

(13) Sistemet Inteligjente të Transportit (ITS) dhe rrjetet lokale radio (RLAN) mbështeten të dyja nga politikat e Bashkimit Evropian. CEPT po përcakton kushtet teknike për funksionimin e RLAN mbi frekuencën 5 935 MHz, me qëllim garantimin e mbrojtjes së aplikacioneve ITS të lidhura me sigurinë për transportin hekurudhor urban nën 5 935 MHz dhe të aplikacioneve ITS të lidhura me sigurinë rrugore nën 5 925 MHz (p.sh. kërkesat për kufizimin e emetimeve jashtë brezit dhe skenarët e bllokimit).

(14) ETSI po përcakton zgjidhje të standardizuara për sigurimin e mekanizmave të bashkëndarjes së të njëjtit kanal (co-channel sharing) dhe për zbatimin e rregullave të përparësisë ndërmjet aplikacioneve ITS rrugore dhe atyre të transportit hekurudhor urban.

(15) ETSI aktualisht po punon në dy raporte teknike që trajtojnë përcaktimin dhe vlerësimin e metodave të bashkëekzistencës në të njëjtin kanal dhe në kanale ngjitur ndërmjet ITS-G5 dhe LTE-V2X. Standardet përkatëse mund të jenë të disponueshme më së hershmi në mesin e vitit 2021 dhe procesi mund të zgjasë deri në mesin e vitit 2022.

(16) Duke marrë parasysh zhvillimet në ETSI, ky Vendim mund të ketë nevojë të rishikohet në të ardhmen.

(17) Ky Vendim duhet të mbështetet dhe të zhvillojë më tej rregullat e përcaktuara në Vendimin 2008/671/KE. Në interes të qartësisë juridike, Vendimi 2008/671/KE duhet të shfuqizohet.

(18) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radiofonik, të krijuar me Vendimin nr. 676/2002/KE.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Qëllimi i këtij Vendimi është harmonizimi i kushteve për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të brezit të frekuencave 5 875–5 935 MHz për aplikacionet e Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS) të lidhura me sigurinë.

Neni 2

Për qëllimet e këtij Vendimi zbatohen përkufizimet e mëposhtme::

(1) **“Sisteme Inteligjente të Transportit” (ITS)** nënkupton një gamë sistemesh dhe shërbimesh, të bazuara në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë përpunimin, kontrollin, pozicionimin, komunikimin dhe elektronikën, të cilat zbatohen në një sistem transporti rrugor ose në një sistem transporti hekurudhor urban, ose në të dyja;

(2) **“Sisteme Inteligjente të Transportit Rrugor” (road ITS)** nënkupton sistemet inteligjente të transportit të zbatuara në çdo lloj transporti rrugor (përfshirë rastet e përdorimit jashtë rrugës), të cilat mundësojnë komunikime sigurie ndërmjet automjeteve (V2V) dhe ndërmjet infrastrukturës dhe automjeteve (I2V). ITS-të e zbatuara në linjat hekurudhore që nuk janë të ndara nga trafiku rrugor ose këmbësor (si tramvajet dhe hekurudhat e lehta) konsiderohen gjithashtu pjesë e ITS rrugor;

(3) **“Sisteme Inteligjente të Transportit Hekurudhor Urban” (urban rail ITS)** nënkupton sistemet inteligjente të transportit të zbatuara në linja hekurudhore urbane ose periferike, të drejtuara në mënyrë të përhershme nga të paktën një sistem kontrolli dhe menaxhimi, të ndara nga trafiku rrugor dhe këmbësor;

(4) **“Fuqi mesatare ekuivalente izotropike e rrezatuar” (e.i.r.p.)** nënkupton fuqinë e.i.r.p. gjatë impulsit të transmetimit që korrespondon me fuqinë më të lartë.

Neni 3

1. Shtetet Anëtare do të caktojnë, jo më vonë se më 30 qershor 2021, brezin e frekuencave 5 875–5 935 MHz për Sistemet Inteligjente të Transportit dhe do ta kufizojnë përdorimin e brezit 5 925–5 935 MHz vetëm për ITS hekurudhor urban. Pas këtij caktimi, Shtetet Anëtare do ta bëjnë këtë brez frekuencash të disponueshëm në baza joekskluzive sa më shpejt që të jetë praktikisht e arsyeshme. Ky caktim duhet të jetë në përputhje me parametrat e përcaktuar në Aneks.
2. Aplikacionet e ITS rrugor do të kenë përparësi nën frekuencën 5 915 MHz, ndërsa aplikacionet e ITS hekurudhor urban do të kenë përparësi mbi frekuencën 5 915 MHz, në mënyrë që t’i sigurohet mbrojtje aplikacionit që gëzon përparësi.
3. Qasja e ITS rrugor në intervalin e frekuencave 5 915–5 925 MHz do të kufizohet vetëm në aplikacionet që përfshijnë lidhje nga infrastruktura te automjeti (I2V), të koordinuara, sipas rastit, me ITS hekurudhor urban.
4. Qasja e ITS hekurudhor urban në intervalin e frekuencave 5 925–5 935 MHz do të bëhet mbi bazën e përdorimit të përbashkët dhe do t’u nënshtrohet rrethanave kombëtare dhe kërkesës për ITS hekurudhor urban, duke përfshirë koordinimin me shërbimin fiks.

Neni 4

Fusha e zbatimit dhe mënyrat e zbatimit të këtij Vendimi do të rishikohen sapo zhvillimet e tregut dhe evoluimi i standardeve dhe teknologjisë ta justifikojnë një rishikim të tillë, ose më së voni deri më 30 shtator 2023.

Neni 5

Shtetet Anëtare do t’i raportojnë Komisionit për zbatimin e Nenit 3 të këtij Vendimi deri më 30 shtator 2022.

Neni 6

Vendimi 2008/671/KE shfuqizohet.

Neni 7

Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKS

Parametrat teknikë për aplikacionet e Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS) të lidhura me sigurinë në brezin 5 875–5 935 MHz


Parametri	Vlera
Dendësia maksimale spektrale e fuqisë (mesatarja e.i.r.p.)	23 dBm/MHz
Fuqia maksimale totale e transmetimit (mesatarja e.i.r.p.)	33 dBm, me një gamë kontrolli të fuqisë së transmetimit (TPC) prej të paktën 30 dB

Duhet të përdoren teknika për qasjen në spektër dhe zbutjen e interferencave që sigurojnë një nivel të përshtatshëm performance, në përputhje me Direktivën 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Nëse teknikat përkatëse përshkruhen në standarde të harmonizuara ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian sipas Direktivës 2014/53/BE, duhet të sigurohet një nivel performance të paktën ekuivalent me atë që lidhet me këto teknika.

Rregullimi i frekuencave


Rregullimi i frekuencave bazohet në blloqe me gjerësi 10 MHz, duke filluar nga kufiri i poshtëm i brezit, në frekuencën 5 875 MHz.

Për ITS rrugor:



Në brezin 5875-5925 MHz, aplikacionet ITS rrugore duhet të përdorin kanale brenda kufijve të secilit bllok 10 MHz. Gjatësia e brezit të kanalit mund të jetë më pak se 10 MHz.

Për ITS hekurudhor urban:



Në brezin 5 875–5 915 MHz, aplikacionet e ITS hekurudhor urban duhet të përdorin kanale brenda kufijve të secilit bllok prej 10 MHz. Gjerësia e kanalit mund të jetë më e vogël se 10 MHz.

Në brezin 5 915–5 935 MHz, gjerësia maksimale e kanalit për aplikacionet e ITS hekurudhor urban duhet të jetë 10 MHz. Vija e ndërprerë tregon rregullimin e preferuar të harmonizuar të frekuencave, por në nivel kombëtar, vendosja e sistemeve mund të përdorë një kanal të përqendruar në frekuencën 5 925 MHz.

6.11 Përdorimi i harmonizuar i spektrit radio në brezin e frekuencave 5 945 -6 425 MHz për zbatimin e sistemeve të aksesit pa tela, përfshirë rrjetet lokale radio (WAS/RLAN)

(*Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2021/1067 i datës 17 Qershor 2021)*
(njoftuar me dokumentin C(2021) 4240)

KOMISIONI EVROPIAN,
Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian

Duke pasur parasysh Vendimin nr. 676/2002/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 mars 2002, mbi kuadrin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin Radio), dhe në veçanti nenin 4(3) të tij,

Duke qenë se:

(1) Për shkak të rritjes së numrit dhe shumëllojshmërisë së pajisjeve për sistemet e aksesit pa tel, përfshirë rrjetet lokale radio ("WAS/RLAN"), si dhe rritjes së shpejtësive të lidhjes dhe vëllimit të trafikut të të dhënave, ekziston nevoja për harmonizimin e burimeve të reja të spektrit për ofrimin e internetit me brez të gjerë pa tel përmes WAS/RLAN-ve, përveç spektrit që është tashmë i disponueshëm në baza joekskluzive në brezat 2,4 GHz (2 400–2 483,5 MHz) dhe 5 GHz (5 150–5 350 MHz dhe 5 470–5 725 MHz). pektri shtesë për WAS/RLAN duhet të mbështesë kanalet me gjerësi të madhe të nevojshme për shumë aplikacione (duke përfshirë videokonferencat, shkarkimin e mediave, telemjekësinë, mësimin online, lojërat elektronike, realitetin e shtuar dhe realitetin virtual), të cilat kërkojnë brez të gjerë për të arritur shpejtësi në nivel gigabiti. Këto aplikacione janë bërë gjithashtu gjithnjë e më të rëndësishme gjatë krizës së koronavirusit.

(2) Në përputhje me strategjinë e Komisionit për Shoqërinë Evropiane të Gigabitit, të gjithë nxitësit kryesorë socio-ekonomikë (duke përfshirë shkollat, nyjet e transportit dhe ofruesit kryesorë të shërbimeve publike), si dhe ndërmarrjet me përdorim intensiv të teknologjive digjitale, duhet të kenë akses deri në vitin 2025 në lidhje interneti me shpejtësi shkarkimi ose ngarkimi prej 1 gigabit për sekondë (Gbit/s). Të gjitha familjet në Bashkim duhet të kenë lidhje interneti me shpejtësi shkarkimi të paktën 100 Mbit/s, e cila mund të përmirësohet deri në 1 Gbit/s.

(3) Kuadri rregullator për WAS/RLAN-të që operojnë në brezin e frekuencave 5 945–6 425 MHz, i njohur si brezi i poshtëm 6 GHz, duhet të përmirësojë lidhshmërinë pa tel në Bashkim dhe t'i mundësojë tregut të brendshëm të përfitojë nga një burim spektri potencialisht i disponueshëm në nivel global, duke krijuar ekonomi të konsiderueshme shkalle për prodhuesit e pajisjeve. Barrierat më të ulëta për akses në spektër, si rezultat i një kuadri rregullator të harmonizuar, do të lehtësojnë vendosjen në shkallë të gjerë të pajisjeve dhe pikave të aksesit WAS/RLAN të ndërveprueshme, të cilat do të shërbejnë si një infrastrukturë e rëndësishme lidhjeje për shërbimet që plotësojnë shërbimet e internetit celular të ofruara nga operatorët e rrjeteve celulare. Kuadri i rekomanduar identifikon dy raste përdorimi për WAS/RLAN në brezin 5 945–6 425 MHz: i) përdorimi me fuqi të ulët në ambiente të mbyllura (Low Power Indoor – LPI), i kufizuar dhe i vendosur në mënyrë të përhershme në ndërtesa, trena me dritare të veshura me shtresë metalike dhe avionë dhe ii) përdorimi me fuqi shumë të ulët (Very Low Power – VLP), i cili mund të përdoret si në ambiente të mbyllura ashtu edhe në ambiente të hapura. Përdorimi në ambiente të hapura synon të mbulojë aplikacione me rreze të shkurtër për komunikime të drejtpërdrejta në zona të vogla.

(4) Në përputhje me Rregulloret e Radiokomunikimit të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), brezi 5 945–6 425 MHz është i alokuar në bazë parësore për shërbimin celular, shërbimin fiks (FS) dhe shërbimin fiks satelitor (FSS) në të tri rajonet e ITU-së. Ky brez frekuencash përdoret nga stacionet tokësore satelitore të vendosura në anije, stacionet tokësore të FSS-së, sistemet e shërbimit fiks (pikë-me-pikë), sensorët pasivë satelitorë, pajisjet me rreze të shkurtër (radiopërcaktim) dhe aplikacionet me brez ultra të gjerë.

(5) Duke marrë parasysh vlerën e aplikacioneve WAS/RLAN në arritjen e objektivave të Shoqërisë së Gigabitit, kushtet teknike dhe operacionale që do të zbatohen për çdo aplikacion të ri që mund të futet në të ardhmen në brezin 5 945–6 425 MHz ose në brezat ngjitur të frekuencave duhet të marrin në konsideratë nevojën për përdorimin e vazhdueshëm të WAS/RLAN-ve në këtë brez sipas kushteve teknike të harmonizuara të këtij Vendimi Zbatues të Komisionit.

(6) Brezi 5 945–6 425 MHz përdoret gjithashtu nga lidhje tokësore fikse me kapacitet të mesëm ose të lartë dhe në distanca të gjata (pikë-me-pikë), duke përfshirë transportimin e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare me brez të gjerë. Në disa Shtete Anëtare autorizohet vendosja e sistemeve inteligjente të transportit hekurudhor urban (ITS), përfshirë kontrollin e trenave të bazuar në komunikim (CBTC), në pjesë të brezit 5 905–5 935 MHz, ndërsa në një Shtet Anëtar autorizimi shtrihet në brezin 5 925–5 975 MHz. ITS-të hekurudhore urbane në brezin 5,9 GHz, të cilat i nënshtrohen kushteve të Vendimit Zbatues (BE) 2020/1426 të Komisionit, mundësojnë menaxhimin e sigurt dhe efikas të operacioneve hekurudhore urbane.

(7) Më 19 dhjetor 2017, për të identifikuar spektër shtesë për WAS/RLAN-të, Komisioni i dha mandat Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT), në përputhje me nenin 4(2) të Vendimit nr. 676/2002/KE, për të studiuar realizueshmërinë dhe për të identifikuar kushtet teknike të harmonizuara për përdorimin e WAS/RLAN-ve në brezin 5 925–6 425 MHz për ofrimin e shërbimeve të internetit me brez të gjerë pa tel.

(8) Në përputhje me këtë mandat, CEPT publikoi dy raporte: (i) Raportin A (CEPT Report 73): "Vlerësimi dhe studimi i skenarëve të përputhshmërisë dhe bashkëekzistencës për WAS/RLAN në brezin 5 925–6 425 MHz" (6 mars 2020) dhe (ii) Raportin B (CEPT Report 75): "Parametrat teknikë të harmonizuar për WAS/RLAN që operojnë në bazë bashkëekzistence me teknika të përshtatshme zbutjeje dhe/ose kushte operacionale të përputhshmërisë/bashkëekzistencës, mbi bazën e një autorizimi të përgjithshëm" (20 nëntor 2020). Studimet e kryera nga CEPT treguan se bashkëekzistenca e WAS/RLAN-ve me sistemet CBTC dhe ITS rrugore është teknikisht e realizueshme, me kusht që të zbatohen masa të përshtatshme, si breza mbrojtës (guard bands) dhe kërkesa për emetime brenda ose jashtë brezit. Këto masa nënkuptojnë se spektri i disponueshëm për WAS/RLAN nuk mund të përfshijë të gjithë brezin 5 925–6 425 MHz. Studimet e ndarjes së spektrit dhe të përputhshmërisë treguan gjithashtu se bashkëekzistenca ndërmjet WAS/RLAN-ve (LPI dhe VLP) dhe përdorimeve ekzistuese (stacionet tokësore FSS dhe lidhjet fikse tokësore) në brezin 5 945–6 425 MHz është e mundur, me kusht që të zbatohen disa kërkesa për të siguruar mbrojtjen e duhur nga interferencat e dëmshme. Mund të jetë e nevojshme të rishikohet kufiri i vendosur për dendësinë maksimale mesatare të fuqisë ekuivalente izotropike të rrezatuar për emetimet jashtë brezit nën frekuencën 5 935 MHz për pajisjet WAS/RLAN të tipit VLP. Për këtë arsye, duhet të kryhet një rishikim deri më 31 dhjetor 2024, mbi bazën e përgjigjes së CEPT ndaj një mandati të lëshuar nga Komisioni sipas nenit 4(2) të Vendimit nr. 676/2002/KE.

(9) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radio.

KA MIRATUAR KËTE VENDIM:

Neni 1

Ky Vendim harmonizon kushtet për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të brezit të frekuencave 5 945–6 425 MHz për sistemet e aksesit pa tel, përfshirë rrjetet lokale radio (WAS/RLAN).

Neni 2

Për qëllimet e këtij Vendimi zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(a) "Sisteme të aksesit pa tel, përfshirë rrjetet lokale radio (WAS/RLAN)" nënkupton sisteme radio me brez të gjerë që mundësojnë akses pa tel për aplikacione publike dhe private, pavarësisht nga topologjia e rrjetit bazë;

(b) "Në bazë mosndërhyrjeje dhe pa mbrojtje" nënkupton që nuk duhet të shkaktohet interferencë e dëmshme ndaj asnjë shërbimi radiokomunikimi dhe se nuk mund të kërkohet mbrojtje e këtyre pajisjeve kundër interferencave që vijnë nga shërbimet e radiokomunikimit;

(c) "Fuqi ekuivalente izotropike e rrezatuar (e.i.r.p.)" nënkupton produktin e fuqisë së furnizuar në antenë dhe fitimit të antenës në një drejtim të caktuar në raport me një antenë izotropike (fitim absolut ose izotropik).

Neni 3

Deri më 1 dhjetor 2021, Shtetet Anëtare do të caktojnë brezin e frekuencave 5 945–6 425 MHz dhe do ta vënë atë në dispozicion, në baza joekskluzive, mosndërhyrjeje dhe pa mbrojtje, për zbatimin e WAS/RLAN-ve, në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në Aneks.

Kur, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, futen aplikacione të reja në brezin e frekuencave 5 945–6 425 MHz ose në breza frekuencash ngjitur, Shtetet Anëtare nuk do të miratojnë kushte teknike ose operacionale për këto aplikacione të reja që kufizojnë në mënyrë të pajustifikuar përdorimin e vazhdueshëm të WAS/RLAN-ve në brezin 5 945–6 425 MHz në përputhje me këtë Vendim.

Neni 4

Ky Vendim do t'i nënshtrohet rishikimit deri në fund të vitit 2024, duke marrë parasysh studime dhe matje shtesë lidhur me kufijtë maksimalë të dendësisë mesatare të fuqisë ekuivalente izotropike të rrezatuar (e.i.r.p.) për emetimet jashtë brezit të pajisjeve WAS/RLAN të tipit VLP nën frekuencën 5 935 MHz.

Neni 5

Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKS

Kushtet teknike të harmonizuara për WAS/RLAN në brezin e frekuencave 5 945–6 425 MHz

Tabela 1

Pajisjet WAS/RLAN me fuqi të ulët për ambiente të mbyllura (Low Power Indoor – LPI)

Parametri	Kushtet teknike

Përdorimi i lejuar	I kufizuar vetëm për përdorim në ambiente të mbyllura, duke përfshirë trenat me dritare të veshura me shtresë metalike (Shënimi 1) dhe avionët. Përdorimi në ambiente të hapura, përfshirë në automjete rrugore, nuk lejohet.
Kategoria e pajisjes	Pikë aksesi (access point) ose urë lidhëse (bridge) LPI që furnizohet me energji përmes një lidhjeje me kabllo, ka antenë të integruar dhe nuk funksionon me bateri. Pajisje klient LPI që lidhet me një pikë aksesi LPI ose me një pajisje tjetër klient LPI dhe mund të funksionojë ose jo me bateri.
Brezi i frekuencave	5 945-6 425 MHz
Fuqia maksimale mesatare ekuivalente izotropike e rrezatuar (e.i.r.p.) për emetimet brenda brezit (Shënimi 2)	23 dBm
Dendësia maksimale mesatare e e.i.r.p. për emetimet brenda brezit (Shënimi 2)	10 dBm/MHz
Dendësia maksimale mesatare e e.i.r.p. për emetimet jashtë brezit nën 5 935 MHz (Shënimi 2)	-22 dBm/MHz

Shënim 1: Ose struktura të ngjashme të ndërtuara me materiale që kanë karakteristika të krahasueshme dobësimi të sinjalit.

Shënim 2: Fuqia mesatare e.i.r.p. i referohet e.i.r.p.-së gjatë impulsit të transmetimit që korrespondon me fuqinë më të lartë, nëse zbatohet kontrolli i fuqisë.

Duhet të përdoren teknika për qasjen në spektër dhe zbutjen e interferencave që sigurojnë një nivel të përshtatshëm performance për të përmbushur kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Kur teknikat përkatëse përshkruhen në standarde të harmonizuara ose në pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2014/53/BE, duhet të sigurohet performancë të paktën ekuivalente me nivelin e performancës së lidhur me këto teknika.

Tabela 2

Pajisjet WAS/RLAN me fuqi shumë të ulët (Very Low Power – VLP)

Parametri	Kushtet teknike
Përdorimi i lejuar	Brenda dhe jashtë. Përdorimi në Sistemet e Avionëve pa Pilot (UAS) nuk lejohet.
Kategoria e pajisjes	Pajisja VLP është një pajisje portative.
Brezi i frekuencave	5 945-6 425 MHz
Fuqia maksimale mesatare e.i.r.p. për emetimet brenda brezit (Shënimi 1)	14 dBm
Dendësia maksimale mesatare e e.i.r.p. për emetimet brenda brezit (Shënimi 1)	1 dBm/MHz
Dendësia maksimale mesatare e e.i.r.p. për emetimet brenda brezit për përdorim me brez të ngushtë (NB) (Shënimet 1 dhe 2)	10 dBm/MHz
Dendësia maksimale mesatare e e.i.r.p. për emetimet jashtë brezit nën 5 935 MHz (Shënimi 1)	- 45 dBm/MHz until 31 December 2024 (note 3)

Note 1: Fuqia mesatare e.i.r.p. i referohet e.i.r.p.-së gjatë impulsit të transmetimit që korrespondon me fuqinë më të lartë, nëse zbatohet kontrolli i fuqisë.

Note 2: Pajisjet me brez të ngushtë (NB) janë pajisje që operojnë në kanale me gjerësi më të vogël se 20 MHz. Pajisjet NB kërkojnë gjithashtu një mekanizëm kërcimi frekuencash (frequency hopping), të bazuar në të paktën 15 kanale kërcimi, për të operuar me një vlerë të dendësisë spektrale të fuqisë (PSD) brenda brezit mbi 1 dBm/MHz.

Note 3: Përshtatshmëria e këtij kufiri do t'i nënshtrohet rishikimit deri më 31 dhjetor 2024. Në mungesë të provave të justifikuara, nga 1 janari 2025 do të zbatohet vlera -37 dBm/MHz**.**

Duhet të përdoren teknika për qasjen në spektër dhe zbutjen e interferencave që sigurojnë një nivel të përshtatshëm performance për të përmbushur kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE. Kur teknikat përkatëse përshkruhen në standarde të harmonizuara ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2014/53/BE, duhet të sigurohet performancë të paktën ekuivalente me nivelin e performancës së lidhur me këto teknika.

6.12 Harmonizimi i spektrit radio pajisjet që përdorin teknologjinë me brez ultra të gjerë (Ultra-Wideband - UWB)

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2019/785 i datës 14 Maj 2019 që shfuqizon vendimin 2007/131/CE)
(njoftuar me dokumentin C(2019) 3461)

KOMISIONI EVROPIAN,
Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Vendimin Nr. 676/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 7 mars 2002, mbi kuadërin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin Radio), dhe në veçanti nenin 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë sa vijon:

(1) Vendimi i Komisionit 2007/131/EC harmonizon kushtet teknike për përdorimin e spektrit nga pajisjet radio të bazuara në teknologjinë me brez ultra të gjerë (UWB) në Bashkim. Ai siguron që spektri radio të jetë i disponueshëm në të gjithë Bashkimin sipas kushteve të harmonizuara, eliminon pengesat për përdorimin e teknologjisë UWB dhe synon krijimin e një tregu unik efektiv për sistemet UWB me ekonomi të konsiderueshme shkalle dhe përfitime për konsumatorin.
(2) Megjithëse sinjalet UWB zakonisht kanë fuqi jashtëzakonisht të ulët, ekziston mundësia e interferencave të dëmshme me shërbimet ekzistuese të radiokomunikimit dhe kjo duhet të menaxhohet. Prandaj, ky Vendim mbi harmonizimin e spektrit radio për pajisjet UWB duhet të shmangë interferencat e dëmshme (përfshirë rastet kur ato mund të lindin nga aksesi në spektër i astronomisë radio, sistemeve satelitore të eksplorimit të Tokës dhe sistemeve të kërkimit hapësinor) dhe të balancojë interesat e përdoruesve ekzistues të spektrit me objektivin e përgjithshëm politik për të siguruar kushte të favorshme për futjen e teknologjive inovative në dobi të shoqërisë.
(3) Më 16 mars 2017, Komisioni i dha një mandat të përhershëm Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT) për të identifikuar kushtet teknike për futjen e harmonizuar në Bashkim të aplikimeve radio të bazuara në teknologjinë UWB, me qëllim përditësimin e kushteve teknike për këto aplikime.
(4) Në përgjigje të këtij mandati, CEPT miratoi një raport ku propozoi katër masa:
Kushtet teknike duhet të përshkruajnë pajisjet e zbulimit të materialeve (material sensing devices) në mënyrë më neutrale për të lejuar zgjidhje inovative.
Duhet të jetë e mundur përdorimi i kushteve të përgjithshme për UWB edhe për aplikimet e zbulimit të materialeve.
Duhet të vendoset kufiri –65 dBm/MHz për të gjitha pajisjet e zbulimit të materialeve, përfshirë analizën e materialeve të ndërtimit (BMA), në brezin 8,5–10,6 GHz.
Duhet të futet mundësia e përdorimit të teknikës së zbutjes "trigger-before-transmit" për sistemet e kontrollit të aksesit të automjeteve të bazuara në teknologjinë UWB në brezat 3,8–4,2 GHz dhe 6–8,5 GHz.
(5) Ky Vendim duhet të mbështesë harmonizimin e përgjithshëm të kuadrit rregullator UWB për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kufijve dhe teknikave të zbutjes ndërmjet rregulloreve të ndryshme UWB dhe për të lejuar zgjidhje inovative në fushën e teknologjisë UWB.

(6) Ky Vendim përcakton kufij rregullatorë dhe identifikon teknika zbutjeje për të siguruar përdorim efikas të spektrit, duke garantuar njëkohësisht bashkëjetesën me përdoruesit e tjerë të spektrit. Zhvillimi teknologjik mund të sjellë zgjidhje të tjera që sigurojnë të paktën një nivel ekuivalent mbrojtjeje të spektrit. Për këtë arsye, përdorimi i teknikave alternative të zbutjes, siç mund të jenë zgjidhjet e përfshira në standardet e ardhshme të harmonizuara të organizatave evropiane të standardizimit, duhet të lejohet me kusht që ato të sigurojnë të paktën një nivel ekuivalent performance dhe mbrojtjeje të spektrit dhe të respektojnë në mënyrë të verifikueshme kërkesat teknike të përcaktuara nga ky kuadër rregullator.
(7) Vendimi 2007/131/EC është ndryshuar disa herë.Në interes të qartësisë ligjore, Vendimi 2007/131/EC duhet të shfuqizohet.
(8) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radio.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM

Neni 1

Qëllimi i këtij Vendimi është harmonizimi i kushteve teknike për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të spektrit radio nga pajisjet që përdorin teknologjinë me brez ultra të gjerë (Ultra-Wideband – UWB) në Bashkim.

Neni 2

Për qëllimet e këtij Vendimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(a)"Pajisje që përdorin teknologjinë me brez ultra të gjerë (UWB)" nënkupton pajisje që përfshijnë, si pjesë përbërëse ose si aksesor, teknologji për radiokomunikime me rreze të shkurtër, që përfshin gjenerimin dhe transmetimin e qëllimshëm të energjisë radiofrekuente e cila shtrihet mbi një gamë frekuencash më të gjerë se 50 MHz, dhe që mund të mbivendoset me disa breza frekuencash të caktuara për shërbimet e radiokomunikimit.

(b)"Në bazë mosndërhyrjeje dhe pa mbrojtje" do të thotë se:

nuk mund të shkaktohet interferencë e dëmshme ndaj asnjë shërbimi radiokomunikimi;

nuk mund të kërkohet mbrojtje për këto pajisje kundër interferencave që vijnë nga shërbimet e radiokomunikimit.

(c)"Brenda ambienteve (indoors)" nënkupton brenda ndërtesave ose vendeve ku mbrojtja (shielding) zakonisht siguron dobësimin e nevojshëm për të mbrojtur shërbimet e radiokomunikimit nga interferencat e dëmshme.

(d)"Automjet motorik" ka të njëjtin kuptim si ai i përcaktuar në nenin 3(11) të Direktivës 2007/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

(e)"Mjet hekurudhor" ka të njëjtin kuptim si ai i përcaktuar në nenin 3(1)(4) të Rregullores (BE) 2018/643 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

(f)"e.i.r.p." (Equivalent Isotropically Radiated Power) nënkupton fuqinë ekuivalente izotropike të rrezatuar, e cila është produkti i fuqisë së furnizuar në antenë dhe fitimit të antenës në një drejtim të caktuar krahasuar me një antenë izotropike.

(g)"Dendësia maksimale mesatare e fuqisë spektrale" nënkupton fuqinë mesatare për njësi të gjerësisë së brezit (e përqendruar në atë frekuencë), e rrezatuar në drejtimin e nivelit maksimal sipas kushteve të përcaktuara të matjes dhe e shprehur si e.i.r.p. e pajisjes radio në testim në një frekuencë të caktuar.

(h)“Fuqia kulmore (peak power)” nënkupton fuqinë e përmbajtur brenda një gjerësie brezi prej 50 MHz në frekuencën ku ndodh fuqia mesatare më e lartë e rrezatuar, e rrezatuar në drejtimin e nivelit maksimal sipas kushteve të përcaktuara të matjes dhe e shprehur si e.i.r.p.
(i)“Dendësia totale e fuqisë spektrale” nënkupton mesataren e vlerave të dendësisë mesatare të fuqisë spektrale të matura mbi një sferë rreth skenarit të matjes me një rezolucion prej të paktën 15 gradësh.
(j)“Në bord të avionit (onboard aircraft)” nënkupton përdorimin e lidhjeve radio për qëllime komunikimi brenda një avioni.
(k)“LT1” nënkupton sisteme të destinuara për gjurmimin e përgjithshëm të vendndodhjes së personave dhe objekteve, të cilat mund të vihen në përdorim pa licencë.

Neni 3
Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi, Shtetet Anëtare do të caktojnë dhe do të vënë në dispozicion spektrin radio, mbi bazë mosndërhyrjeje dhe pa mbrojtje, për pajisjet që përdorin teknologjinë UWB, me kusht që këto pajisje të përmbushin kushtet e përcaktuara në Aneks dhe të përdoren: brenda ambienteve; ose nëse përdoren jashtë, të mos jenë të lidhura me një instalim fiks, infrastrukturë fikse ose antenë të jashtme fikse.
Pajisjet UWB që përmbushin kushtet e Aneksit lejohen gjithashtu në automjete motorike dhe mjete hekurudhore.

Neni 4
Shtetet Anëtare do të monitorojnë përdorimin e brezave të identifikuar në Aneks nga pajisjet që përdorin teknologjinë UWB, veçanërisht për të siguruar që të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 3 të këtij Vendimi të mbeten të përshtatshme, dhe do t'i raportojnë gjetjet e tyre Komisionit.

Neni 5
Vendimi 2007/131/EC shfuqizohet.

Neni 6
Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKSI Përdorimi i Përgjithshëm i Teknologjisë me Brez Ultra të Gjerë (UWB)

Kërkesat teknike

Gama e frekuencës	**Dendësia maksimale mesatare e fuqisë spektrale (e.i.r.p.)**	**Fuqia maksimale kulmore (e.i.r.p.)**
f ≤ ,6 GHz	–90 dBm/MHz	–50 dBm
1,6 < f ≤ 2,7 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm
2,7 < f ≤ 3,1 GHz	–70 dBm/MHz	–36 dBm
3,1 < f ≤ 3,4 GHz	–70 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz duke përdorur LDC ose DAA	–36 dBm ose 0 dBm

3,4 < f ≤ 3,8 GHz	–80 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz duke përdorur LDC ose DAA	–40 dBm ose 0 dBm
3,8 < f ≤ 4,8 GHz	–70 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz duke përdorur LDC ose DAA	–30 dBm ose 0 dBm
4,8 < f ≤ 6 GHz	–70 dBm/MHz	–30 dBm
6 < f ≤ 8,5 GHz	–41,3 dBm/MHz	0 dBm
8,5 < f ≤ 9 GHz	–65 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz duke përdorur DAA	–25 dBm ose 0 dBm
9 < f ≤ 10,6 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
f > 10,6 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm

Shënimi 1 – LDC (Low Duty Cycle)

Brenda brezit 3,1 GHz deri në 4,8 GHz, teknika e zbutjes LDC (Low Duty Cycle) dhe kufijtë e saj përcaktohen në standardin ETSI EN 302 065-1 V2.1.1.

Mund të përdoren teknika alternative zbutjeje nëse ato sigurojnë të paktën të njëjtin nivel performance dhe mbrojtjeje të spektrit dhe përputhen me kërkesat teknike të këtij Vendimi.

Shënimi 2 – DAA (Detect and Avoid)

Brenda brezave:

- 3,1 GHz – 4,8 GHz
- 8,5 GHz – 9 GHz

teknika e zbutjes DAA (Detect and Avoid) dhe kufijtë e saj përcaktohen në standardin ETSI EN 302 065-1 V2.1.1.

Mund të përdoren teknika alternative zbutjeje nëse sigurojnë nivel të barasvlershëm mbrojtjeje të spektrit dhe respektojnë kërkesat teknike të këtij Vendimi.

2. Sistemet e Gjurmimit të Vendndodhjes – Tipi 1 (LT1)

Kërkesat teknike

Gama e frekuencës	**Dendësia maksimale mesatare e fuqisë spektrale (e.i.r.p.)**	**Fuqia maksimale kulmore (e.i.r.p.)**
f ≤ 1,6 GHz	–90 dBm/MHz	–50 dBm
1,6 < f ≤ 2,7 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm
2,7 < f ≤ 3,4 GHz	–70 dBm/MHz	–36 dBm
3,4 < f ≤ 3,8 GHz	–80 dBm/MHz	–40 dBm
3,8 < f ≤ 6 GHz	–70 dBm/MHz	–30 dBm
6 < f ≤ 8,5 GHz	–41,3 dBm/MHz	0 dBm
8,5 < f ≤ 9 GHz	–65 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz me DAA	–25 dBm ose 0 dBm
9 < f ≤ 10,6 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
f > 10,6 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm

3. Pajisje UWB të instaluara në automjete motorike dhe mjete hekurudhore

Kërkesat teknike

Gama e frekuencës	**Dendësia maksimale mesatare e fuqisë spektrale (e.i.r.p.)**	**Fuqia maksimale kulmore (e.i.r.p.)**
f ≤ 1,6 GHz	–90 dBm/MHz	–50 dBm
1,6 < f ≤ 2,7 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm
2,7 < f ≤ 3,1 GHz	–70 dBm/MHz	–36 dBm
3,1 < f ≤ 3,4 GHz	–70 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz me LDC + kufi të jashtëm (e.l.) ose –41,3 dBm/MHz me TPC + DAA + e.l.	–36 dBm ose ≤ 0 dBm
3,4 < f ≤ 3,8 GHz	–80 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz me LDC + e.l. ose –41,3 dBm/MHz me TPC + DAA + e.l.	–40 dBm ose ≤ 0 dBm
3,8 < f ≤ 4,8 GHz	–70 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz me LDC + e.l. ose –41,3 dBm/MHz me TPC + DAA + e.l.	–30 dBm ose ≤ 0 dBm
4,8 < f ≤ 6 GHz	–70 dBm/MHz	–30 dBm
6 < f ≤ 8,5 GHz	–53,3 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz me LDC + e.l. ose –41,3 dBm/MHz me TPC + e.l.	–13,3 dBm ose ≤ 0 dBm
8,5 < f ≤ 9 GHz	–65 dBm/MHz ose –41,3 dBm/MHz me TPC + DAA + e.l.	–25 dBm ose ≤ 0 dBm
9 < f ≤ 10,6 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
f > 10,6 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm

Shënime
LDC (Low Duty Cycle) – teknikë kufizimi e ciklit të transmetimit.
DAA (Detect and Avoid) – teknikë që zbulon sistemet e tjera radio dhe shmang interferencat.
TPC (Transmit Power Control) – kontroll i fuqisë së transmetimit.
e.l. (Exterior Limit) – kufiri i emetimeve jashtë automjetit.
Kufiri i jashtëm i kërkuar është:
≤ –53,3 dBm/MHz për të mbrojtur shërbimet e tjera radio.
Shënime
LDC (Low Duty Cycle) – teknikë kufizimi e ciklit të transmetimit.
DAA (Detect and Avoid) – teknikë që zbulon sistemet e tjera radio dhe shmang interferencat.
TPC (Transmit Power Control) – kontroll i fuqisë së transmetimit.
e.l. (Exterior Limit) – kufiri i emetimeve jashtë automjetit.
Kufiri i jashtëm i kërkuar është:≤ –53,3 dBm/MHz për të mbrojtur shërbimet e tjera radio.

Sistemet e aksesit në automjete me teknikën "Trigger-Before-Transmit"

Kërkesat teknike për sistemet e aksesit në automjete që përdorin teknikën **Trigger-Before-Transmit**:

Gama e frekuencës	**Dendësia maksimale mesatare e fuqisë spektrale**	**Fuqia maksimale kulmore**

3,8 < f ≤ 4,2 GHz	–41,3 dBm/MHz me Trigger-Before-Transmit dhe LDC ≤ 0,5 % në 1 orë	0 dBm
6 < f ≤ 8,5 GHz	–41,3 dBm/MHz me Trigger-Before-Transmit dhe LDC ≤ 0,5 % në 1 orë ose TPC	0 dBm

Përkufizimi i Trigger-Before-Transmit

"Trigger-Before-Transmit" është një transmetim UWB që fillon vetëm kur është i nevojshëm, konkretisht kur sistemi tregon se pajisje të tjera UWB ndodhen pranë.
Komunikimi mund të aktivizohet:

- nga përdoruesi;
- ose nga automjeti.

Komunikimi pasues konsiderohet si "komunikim i aktivizuar". Kur përdoret kjo teknikë:

- vazhdon të zbatohet kufizimi LDC;
- ose TPC në brezin 6–8,5 GHz;
- nuk kërkohet kufiri i jashtëm (e.l.) për sistemet e aksesit në automjete.

4. UWB në bord të avionëve

Vlerat për densitetin maksimal mesatar të fuqisë spektrale dhe fuqinë maksimale kulmore për pajisjet me rreze të shkurtër që përdorin teknologjinë UWB në avionë janë si më poshtë:

Gama e frekuencës	Densiteti maksimal mesatar	Fuqia kulmore maksimale
f ≤ 1,6 GHz	–90 dBm/MHz	–50 dBm
1,6 < f ≤ 2,7 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm
2,7 < f ≤ 3,4 GHz	–70 dBm/MHz	–36 dBm
3,4 < f ≤ 3,8 GHz	–80 dBm/MHz	–40 dBm
3,8 < f ≤ 6 GHz	–70 dBm/MHz	–30 dBm
6 < f ≤ 6,650 GHz	–41,3 dBm/MHz	0 dBm
6,650 < f ≤ 6,6752 GHz	–62,3 dBm/MHz	–21 dBm
6,6752 < f ≤ 8,5 GHz	–41,3 dBm/MHz	0 dBm
8,5 < f ≤ 10,6 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
f > 10,6 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm

Për brezin 6,650–6,6752 GHz duhet të zbatohet një notch (gropë filtri) prej 21 dB për të arritur nivelin –62,3 dBm/MHz.

5. Pajisjet për Zbulimin e Materialeve (Material Sensing Devices) që përdorin teknologjinë UWB

Pajisjet UWB për zbulimin e materialeve ndahen në dy kategori:

- **Pajisje me kontakt (Contact Based)**

Pajisje për të cilat transmetuesi UWB aktivizohet vetëm kur është në kontakt të drejtpërdrejtë me materialin që po analizohet.

- **Pajisje pa kontakt (Non-Contact Based)**

Pajisje për të cilat transmetuesi UWB aktivizohet vetëm kur ndodhet pranë materialit që po analizohet dhe drejtohet drejt materialit në fjalë, për shembull:

- manualisht me sensor afërsie;
- ose përmes projektimit mekanik të pajisjes.

Pajisjet për zbulimin e materialeve të bazuara në teknologjinë UWB duhet të përmbushin:

- ose rregullat e përgjithshme UWB të përcaktuara në seksionin 1 të Aneksit;
- ose kufijtë specifikë për pajisjet e zbulimit të materialeve të përcaktuara në seksionet 5.2 dhe 5.3.

Rregullat e përgjithshme UWB nuk lejojnë instalime fikse në ambiente të jashtme.
Emetimet e këtyre pajisjeve nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e përcaktuar për përdorimin e përgjithshëm UWB dhe duhet të përmbushin kërkesat e teknikave të zbutjes të përcaktuara për përdorimin e përgjithshëm UWB.

5.2 Pajisje me kontakt (Contact Based Material Sensing Devices)

Kufijtë kryesorë.

Gama e frekuencës	**Densiteti maksimal mesatar i fuqisë (e.i.r.p.)**	**Fuqia maksimale kulmore**
f ≤ 1,73 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm
1,73 < f ≤ 2,2 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
2,2 < f ≤ 2,5 GHz	–50 dBm/MHz	–10 dBm
2,5 < f ≤ 2,69 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
2,69 < f ≤ 2,7 GHz	–55 dBm/MHz	–15 dBm
2,7 < f ≤ 2,9 GHz	–70 dBm/MHz	–30 dBm
2,9 < f ≤ 3,4 GHz	–70 dBm/MHz	–30 dBm
3,4 < f ≤ 3,8 GHz	–50 dBm/MHz	–10 dBm
3,8 < f ≤ 4,8 GHz	–50 dBm/MHz	–10 dBm
4,8 < f ≤ 5 GHz	–55 dBm/MHz	–15 dBm
5 < f ≤ 6 GHz	–50 dBm/MHz	–10 dBm
6 < f ≤ 8,5 GHz	–41,3 dBm/MHz	0 dBm
8,5 < f ≤ 10,6 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
f > 10,6 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm

Kërkesa shtesë.

- Mund të përdoret mekanizmi **LBT (Listen Before Talk)** në disa breza frekuencash.
- Në brezat 2,69–2,7 GHz dhe 4,8–5 GHz duhet të mbrohet Shërbimi i Astronomisë Radio (RAS).
- Cikli i punës kufizohet në **10 % për sekondë** në disa breza.
- Në brezin 6–8,5 GHz nuk lejohen instalime fikse në ambiente të jashtme.
- Mund të përdoren teknikat **LDC** dhe **DAA** në brezat përkatës.

5.3 Pajisje pa kontakt (Non-Contact Based Material Sensing Devices)

Kufijtë kryesorë

Gama e frekuencës	Densiteti maksimal mesatar i fuqisë (e.i.r.p.)	Fuqia maksimale kulmore
f ≤ 1,73 GHz	–85 dBm/MHz	–60 dBm
1,73 < f ≤ 2,2 GHz	–70 dBm/MHz	–45 dBm
2,2 < f ≤ 2,5 GHz	–50 dBm/MHz	–25 dBm
2,5 < f ≤ 2,69 GHz	–65 dBm/MHz	–40 dBm
2,69 < f ≤ 2,7 GHz	–70 dBm/MHz	–45 dBm
2,7 < f ≤ 2,9 GHz	–70 dBm/MHz	–45 dBm
2,9 < f ≤ 3,4 GHz	–70 dBm/MHz	–45 dBm
3,4 < f ≤ 3,8 GHz	–70 dBm/MHz	–45 dBm
3,8 < f ≤ 4,8 GHz	–50 dBm/MHz	–25 dBm
4,8 < f ≤ 5 GHz	–55 dBm/MHz	–30 dBm
5 < f ≤ 5,25 GHz	–55 dBm/MHz	–30 dBm
5,25 < f ≤ 5,35 GHz	–50 dBm/MHz	–25 dBm
5,35 < f ≤ 5,6 GHz	–50 dBm/MHz	–25 dBm
5,6 < f ≤ 5,65 GHz	–50 dBm/MHz	–25 dBm
5,65 < f ≤ 5,725 GHz	–65 dBm/MHz	–40 dBm
5,725 < f ≤ 6 GHz	–60 dBm/MHz	–35 dBm
6 < f ≤ 8,5 GHz	–41,3 dBm/MHz	0 dBm
8,5 < f ≤ 10,6 GHz	–65 dBm/MHz	–25 dBm
f > 10,6 GHz	–85 dBm/MHz	–45 dBm

Kërkesat e mekanizmit LBT (Listen Before Talk)

Për të mbrojtur shërbimet radio, pajisjet duhet të zbulojnë sinjale të caktuara para transmetimit.

Gama e frekuencës	Shërbimi që duhet zbuluar	Vlera e pragut
1,215 – 1,4 GHz	Shërbimi i radiopërcaktimit	+8 dBm/MHz
1,61 – 1,66 GHz	Shërbimi satelitor celular	–43 dBm/MHz
2,5 – 2,69 GHz	Shërbimi celular tokësor	–50 dBm/MHz
2,9 – 3,4 GHz	Shërbimi i radiopërcaktimit	–7 dBm/MHz

Nëse tejkalohet pragu i përcaktuar:

- pajisja duhet të fiket automatikisht brenda 10 milisekondash;
- duhet të qëndrojë e heshtur për të paktën 12 sekonda duke vazhduar monitorimin;
- kjo periudhë heshtjeje duhet të respektohet edhe nëse pajisja fiket dhe ndizet përsëri.

6.13 Harmonizimi i brezave të frekuencave 1920-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz për sistemet tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2022/688 i datës 5 Nëntor 2012)
(njoftuar me dokumentin C(2012) 7697)

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Vendimin Nr. 676/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 7 mars 2002 mbi kuadrin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin Radio), dhe në veçanti nenin 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë sa vijon :

(1) Më 14 dhjetor 1998, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Vendimin Nr. 128/1999/EC mbi futjen e koordinuar të një sistemi të komunikimeve mobile dhe pa tela të gjeneratës së tretë (UMTS) në Komunitet (Vendimi UMTS), që mbulonte brezat e frekuencave 1900–1980 MHz. 2010–2025 MHz, 2110-2170 MHz ("brezi tokësor 2 GHz'). S Sipas këtij vendimi, Shtetet Anëtare duhej të ndërmerrnin të gjitha veprimet e nevojshme për të mundësuar futjen e koordinuar dhe progresive të shërbimeve UMTS në territorin e tyre jo më vonë se 1 janari 2002 dhe, në veçanti, të krijonin një sistem autorizimi për UMTS jo më vonë se 1 janari 2000. Ky vendim skadoi më 22 janar 2003, por harmonizimi i spektrit mbeti në fuqi.

(2) Që atëherë, Komisioni ka mbështetur një përdorim më fleksibël të spektrit në Komunikimin e tij mbi:
"Qasje të shpejtë në spektër për shërbimet pa tela të komunikimeve elektronike përmes më shumë fleksibiliteti"i cili trajton ndër të tjera brezin tokësor 2 GHz dhe synon të shmangë shtrembërimet e tregut.
Parimet e neutralitetit teknologjik dhe neutralitetit të shërbimit janë konfirmuar nga Direktiva 2002/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kuadër).

(3) Caktimi i nënbrezave të çiftuar 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz ("brezi tokësor i çiftuar 2 GHz") për sisteme të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike përbën një element të rëndësishëm që adreson konvergjencën e sektorëve celularë, fiks dhe transmetues, si dhe pasqyron inovacionin teknik. Sistemet e vendosura në brezin tokësor të çiftuar 2 GHz duhet të synojnë kryesisht aksesin e përdoruesve fundorë në shërbimet broadband.

(4) Përdoruesit e shërbimeve broadband pa tela, për të cilat brezi tokësor i çiftuar 2 GHz përdoret tashmë në një Shtet Anëtar, mund të kenë akses edhe në shërbime ekuivalente në çdo Shtet tjetër Anëtar. Megjithatë, nënbrezi i paçiftuar 1900–1920 MHz, edhe pse i licencuar për operatorë në shumë Shtete Anëtare, mbetet kryesisht i papërdorur, dhe nënbrezi i paçiftuar 2010–2025 MHz është licencuar vetëm në disa Shtete Anëtare dhe nuk përdoret.

(5) Në përputhje me nenin 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/EC, më 15 qershor 2009 Komisioni i dha mandat Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT) për të zhvilluar kushtet teknike më pak kufizuese për brezat e frekuencave të trajtuara në kuadër të Politikës së Aksesit Pa Tela për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike (ËAPECS).

(6) Në përgjigje të këtij mandati, CEPT publikoi Raportin 39 (CEPT Report 39), i cili përmban kushtet teknike më pak kufizuese dhe udhëzime për zbatimin e tyre për stacionet bazë dhe

stacionet terminale që operojnë në brezin tokësor 2 GHz. Në brezin tokësor të çiftuar 2 GHz, këto kushte teknike janë të përshtatshme për të menaxhuar rrezikun e interferencave të dëmshme ndërmjet rrjeteve fqinje në nivel kombëtar dhe ndërkufitar, pa imponuar ndonjë teknologji të caktuar dhe bazuar në parametrat e optimizuar për përdorimin më të mundshëm të këtij brezi.

Megjithatë, në nënbrezat e paçiftuar 1900–1920 MHz dhe 2010–2025 MHz, kushtet teknike të Raportit CEPT 39 janë më kufizuese për funksionimin e rrjeteve celulare sesa të drejtat ekzistuese kombëtare të përdorimit.

(7) Në përputhje me Raportin CEPT 39, koncepti i Maskave të Kufirit të Bllokut (Block Edge Masks - BEM)**,** të cilat janë parametra teknikë që zbatohen për të gjithë bllokun e spektrit të një përdoruesi të caktuar, pavarësisht nga numri i kanaleve të zëna nga teknologjia e zgjedhur prej tij, konsiderohet i përshtatshëm. Këto maska synohen të jenë pjesë e kushteve të autorizimit për përdorimin e spektrit.

Ato mbulojnë emetimet brenda bllokut të spektrit (fuqia brenda bllokut) si dhe emetimet jashtë bllokut (emetimet jashtë bllokut). Këto përbëjnë kërkesa rregullatore që synojnë menaxhimin e rrezikut të interferencave të dëmshme ndërmjet rrjeteve fqinje dhe nuk cenojnë kufijtë e përcaktuar në standardet e pajisjeve sipas Direktivës 1999/5/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 mars 1999 mbi pajisjet radio dhe pajisjet terminale të telekomunikacionit dhe njohjen reciproke të përputhshmërisë së tyre (Direktiva R&TTE).

(8) Kushtet teknike të përcaktuara si rezultat i mandatit të CEPT synojnë gjithashtu të mbrojnë aplikimet ekzistuese në brezat fqinjë kundër interferencave të dëmshme. Për këtë qëllim, duhet të sigurohet përputhshmëria me maskën ekzistuese të emetimeve të spektrit për UMTS nën 1900 MHz; ndërmjet 1980 MHz dhe 2010 MHz; ndërmjet 2025 MHz dhe 2110 MHz dhe mbi 2170 MHz. Në masën që bashkëjetesa me një aplikim tjetër radio nuk trajtohet në Raportin CEPT 39 dhe në Raportin ERC 65 të Komitetit të Komunikimeve Elektronike, mbi të cilin bazohet Raporti CEPT 39, kriteret e përshtatshme të ndarjes për bashkëjetesën mund të përcaktohen gjithashtu mbi bazën e konsideratave kombëtare.

(9) Rezultatet e Raportit CEPT 39 duhet të bëhen të zbatueshme në Bashkim dhe të implementohen nga Shtetet Anëtare duke marrë parasysh të drejtat ekzistuese të përdorimit në brezin tokësor 2 GHz për UMTS dhe përdorimin efektiv të spektrit.

(10) Megjithatë, duke pasur parasysh kushtet teknike kufizuese mbi nivelet e fuqisë së transmetimit për brezin tokësor të paçiftuar 2 GHz të përcaktuara në Raportin CEPT 39 — me qëllim mbrojtjen e operimeve në brezin tokësor të çiftuar 2 GHz dhe sigurimin e bashkëjetesës së shumë rrjeteve TDD — si dhe gjerësinë e kufizuar të brezit të përgjithshëm të brezit tokësor të paçiftuar 2 GHz, përdorimi i shërbimeve broadband pa tela sipas kushteve aktuale të licencimit është penguar. Kjo situatë kërkon studimin e masave alternative të harmonizimit për brezin tokësor të paçiftuar 2 GHz dhe mund të sjellë nevojën për ndryshimin e licencave ekzistuese. Për të mos penguar futjen e hershme të fleksibilitetit të përdorimit në brezin tokësor të çiftuar 2 GHz, bëhet i nevojshëm ndarimi i masave të harmonizimit për brezat tokësorë të çiftuar dhe të paçiftuar 2 GHz.

(11) Kushtet e harmonizimit teknik duhet të vendosen vetëm për brezin tokësor të çiftuar 2 GHz, pa cenuar të drejtën e Shteteve Anëtare për të organizuar autorizimin e përdorimit të brezit tokësor 2 GHz, duke marrë parasysh të drejtat ekzistuese të përdorimit nën juridiksionin e tyre dhe në përputhje me legjislacionin e Bashkimit, veçanërisht Direktivën 2002/20/EC (Direktiva e Autorizimit) dhe nenet 9 dhe 9a të Direktivës 2002/21/EC.

(12) Harmonizimi sipas këtij Vendimi nuk duhet të përjashtojë mundësinë që një Shtet Anëtar të zbatojë, kur kjo është e justifikuar dhe duke marrë parasysh të drejtat ekzistuese të përdorimit,

periudha tranzitore që mund të përfshijnë marrëveshje për ndarjen e spektrit radio, në përputhje me nenin 4(5) të Vendimit Nr. 676/2002/EC.

(13) Për të siguruar përdorimin efektiv të brezit tokësor të çiftuar 2 GHz edhe në afat të gjatë, administratat duhet të vazhdojnë studimet që mund të rrisin efikasitetin dhe përdorimin inovativ të këtij brezi.

Këto studime duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të një rishikimi të këtij Vendimi.

(14) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radio.

KA MIRATUAR KETE VENDIM:

Neni 1

Ky Vendim synon harmonizimin e kushteve për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të brezave të frekuencave: 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz (në vijim "brezi tokësor i çiftuar 2 GHz") për sisteme tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike në Bashkim.

Neni 2

1. Jo më vonë se 30 qershor 2014, ose sa herë që zbatojnë nenin 9a të Direktivës 2002/21/EC në një datë më të hershme për një të drejtë ekzistuese përdorimi ose japin të drejta të reja përdorimi për një pjesë ose për të gjithë brezin tokësor të çiftuar 2 GHz, Shtetet Anëtare do ta caktojnë dhe do ta vënë në dispozicion këtë brez, mbi bazë jo-ekskluzive, për sisteme tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike, në përputhje me parametrat e përcaktuar në Aneks.
2. Me përjashtim të paragrafit 1 dhe në përputhje me nenin 4(5) të Vendimit Nr .676/2002/EC, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë periudha tranzitore që mund të perfshijne marrëveshje për ndarjen e spektrit radio dhe që duhet tq përfundojne jo më vonë se 24 maj 2016.
3. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që sistemet e përmendura në paragrafin q të ofrojnë mbrojtjen e duhur për sistemet që operojnë në brezat fqinjë.
4. Shtetet Anëtare do të lehtësojne marrëveshjet e koordinimit ndërkufitar me qëllim mundësimin e funksionimit të sistemeve të përmenudra në paragrafin 1, duke marrë parasysh procedurat ekzistuese rregullatore dhe të drejtat ekzistuese.

Neni 3

Shtetet Anëtare do ta mbajnë nën vëzhgim përdorimin e brezit tokësor të çiftuar 2 GHz dhe do t'i raportojnë gjetjet e tyre Komisionit për të mundësuar një rishikim të rregullt dhe në kohë të këtij Vendimi.

Neni 4

Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKSI

PARAMETRAT E PËRMENDUR NE NENIN 2(1)

Kushtet teknike të paraqitura në këtë Aneks janë në formën e rregullimeve të frekuencave dhe maskave të kufirit të bllokut (Block Edge Masks – BEM). Një BEM është një maskë emetimi e përcaktuar, si funksion i frekuencës, në raport me kufirin e një blloku spektri për të cilin operatorit i janë dhënë të drejta përdorimi. Ajo përbëhet nga komponentë brenda bllokut (in-block) dhe komponentë jashtë bllokut (out-of-block), që përcaktojnë nivelet e lejuara të emetimeve brenda dhe jashtë bllokut të licencuar të spektrit.

Nivelet BEM ndërtohen duke kombinuar vlerat e paraqitura në tabelat përkatëse, në mënyrë që kufiri në çdo frekuencë të përcaktohet nga vlera më e lartë (më pak kufizuese) ndërmjet: a) kërkesave bazë (baseline requirements), b) kërkesave kalimtare (transition requirements) dhe c) kërkesave brenda bllokut (in-block requirements), kur është e aplikueshme. Maskat BEM paraqiten si kufij maksimalë të fuqisë mesatare ekuivalente izotropike të rrezatuar (EIRP) ose fuqisë totale të rrezatuar (TRP),mbi një interval kohor mesatarizimi dhe mbi një gjerësi brezi matjeje. Në domenin kohor, EIRP ose TRP mesatarizohet mbi pjesët aktive të shpërthimeve të sinjalit dhe korrespondon me një konfigurim të vetëm të kontrollit të fuqisë. Në domenin e frekuencës, EIRP ose TRP përcaktohet mbi gjerësinë e brezit të matjes të specifikuar në pikën B(2), Tabelat 1, 2 dhe 3 (2). Në përgjithësi, dhe përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe, nivelet BEM korrespondojnë me fuqinë totale të rrezatuar nga pajisja përkatëse, duke përfshirë të gjitha antenat transmetuese, me përjashtim të kërkesave bazë dhe të tranzicionit për stacionet bazë, të cilat specifikohen për antenë.

BEM-të duhet të zbatohen si një komponent thelbësor i kushteve teknike të nevojshme për të siguruar bashkëjetesën ndërmjet shërbimeve në nivel kombëtar. Megjithatë, duhet kuptuar se BEM-të e përcaktuara nuk ofrojnë gjithmonë nivelin e kërkuar të mbrojtjes për shërbimet që mund të preken, dhe mund të jetë e nevojshme të zbatohen teknika shtesë zbutëse në mënyrë proporcionale në nivel kombëtar për të zgjidhur rastet e mbetura të ndërhyrjeve, përfshirë edhe ato që lidhen me brezat fqinjë.

Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të sigurojnë që operatorët e sistemeve tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike mund të përdorin parametra teknikë më pak të rreptë se ata të përcaktuar më poshtë në pikat A, B dhe C, me kusht që përdorimi i këtyre parametrave të jetë dakordësuar ndërmjet të gjitha palëve të prekura dhe që këta operatorë të vazhdojnë të respektojnë kushtet teknike të zbatueshme për mbrojtjen e shërbimeve, aplikacioneve ose rrjeteve të tjera, si dhe detyrimet që rrjedhin nga koordinimi ndërkufitar.

Pajisjet që operojnë në këtë brez mund të përdorin gjithashtu kufij fuqie të ndryshëm nga ata të përcaktuar më poshtë, me kusht që të zbatohen teknika të përshtatshme zbutëse që janë në përputhje me Directive 1999/5/EC dhe që ofrojnë të paktën një nivel mbrojtjeje të barasvlershëm me atë që sigurohet nga këta parametra teknikë.

A. Parametrat e përgjithshëm

Brenda brezit tokësor të çiftuar 2 GHz, rregullimi i frekuencave do të jetë si vijon:

(1) Mënyra e funksionimit duplex do të jetë Frequency Division Duplex (FDD)**.** Hapësira duplex do të jetë 190 MHz**,** ku transmetimi i terminalit (FDD uplink) ndodhet në pjesën e poshtme të brezit nga 1920 MHz deri në 1980 MHz dhe transmetimi i stacionit bazë (FDD doënlink) ndodhet në pjesën e sipërme të brezit nga 2110 MHz deri në 2170 MHz**.**

(2) Kufiri i bllokut të spektrit më afër 1920 MHz fillon në 1920,3 MHz ose më lart.

Kufiri i bllokut më afër 1980 MHz përfundon në 1979,7 MHz ose më poshtë.

Kufiri i bllokut më afër 2110 MHz fillon në 2110,3 MHz ose më lart.

Kufiri i bllokut më afër 2170 MHz përfundon në 2169,7 MHz ose më poshtë.

Shtetet Anëtare mund të vendosin kufij paksa të ndryshëm për të ruajtur përputhshmërinë me autorizimet ekzistuese.

B. **Kushtet teknike për stacionet bazë FDD**

(1) *Kërkesat brenda bllokut*

Një kufi EIRP për stacionet bazë nuk është i detyrueshëm. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të vendosin një kufi EIRP ndërmjet 61 dBm / 5 MHz dhe 65 dBm / 5 MHz në brezin FDD doënlink. Ky kufi mund të rritet për raste të veçanta, p.sh. në zona me dendësi të ulët popullsie, me kusht që të mos rritet ndjeshëm rreziku i bllokimit të marrësve të terminaleve.

(2) *Kërkesat jashtë bllokut*

Tabela 1

Kërkesat bazë— kufijtë EIRP jashtë bllokut (BEM) për stacion bazë, për antenë (1)

Diapazoni i frekuencave të emetimeve jashtë bllokut (FDD doënlink)	EIRP mesatare maksimale jashtë bllokut	Gjerësia e brezit të matjes
Frekuenca të larguara më shumë se 10 MHz nga skaji i poshtëm ose i sipërm i bllokut	9 dBm	5 MHz

(1) Niveli BEM përcaktohet për antenë dhe zbatohet për konfigurime të stacionit bazë me deri në katër antena për sektor.

Tabela 2

Kërkesat e tranzicionit — kufijtë EIRP jashtë bllokut (BEM) për stacion bazë, për antenë (1)

Diapazoni i frekuencave të emetimeve jashtë bllokut (FDD doënlink)	EIRP mesatare maksimale jashtë bllokut	Gjerësia e brezit të matjes
−10 deri në −5 MHz nga skaji i poshtëm i bllokut	11 dBm	5 MHz
−5 deri në 0 MHz nga skaji i poshtëm i bllokut	16,3 dBm	5 MHz
0 deri në +5 MHz nga skaji i sipërm i bllokut	16,3 dBm	5 MHz
+5 deri në +10 MHz nga skaji i sipërm i bllokut	11 dBm	5 MHz

(1) Niveli BEM përcaktohet për antenë dhe zbatohet për konfigurime të stacionit bazë me deri në katër antena për sektor

C. **Kushtet teknike për terminalet FDD**

Tabela 3

Kërkesat brenda bllokut— kufiri BEM i emetimeve brenda bllokut për stacionin terminal në brezin e frekuencave FDD uplink

Fuqia mesatare maksimale brenda bllokut (1)	24 dBm (2)

(1) Ky kufi i fuqisë specifikohet si EIRP për stacionet terminale të projektuara për të qenë fikse ose të instaluara, dhe si TRP për stacionet terminale të projektuara për të qenë mobile ose nomade. EIRP dhe TRP janë ekuivalente për antenat izotropike. Pranohet se kjo vlerë mund t'i nënshtrohet një tolerance të përcaktuar në standardet e harmonizuara, për të marrë parasysh funksionimin në kushte ekstreme mjedisore dhe variacionet e prodhimit.

(2) Për përcaktimin e emetimeve jashtë brezit (*out-of-band emissions*) të terminaleve në CEPT Report 39, është përdorur si referencë fuqia maksimale e transmetimit të përcjellë (*maximum conducted transmit power*) prej 23 dBm**.**

Shtetet Anëtare mund të lehtësojnë kufirin e përcaktuar në Tabelën 3 për vendosje specifike, p.sh. për stacionet terminale fikse në zonat rurale, me kusht që mbrojtja e shërbimeve, rrjeteve dhe aplikacioneve të tjera të mos kompromentohet dhe që detyrimet e koordinimit ndërkufitar të përmbushen.

6.14 Përdorimi i harmonizuar i brezave të çiftuar të frekuencave 874,4–880,0 MHz dhe 919,4–925,0 MHz si dhe të brezit të paçiftuar të frekuencave 1900–1910 MHz për Radiokomunikimet Mobile Hekurudhore (Railway Mobile Radio – RMR)

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2021/1730 i datës 28 Shtator 2021)
(njoftuar me dokumentin C(2021) 6862)

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Vendimin Nr. 676/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 7 mars 2002 mbi kuadrin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian (Vendimi për Spektrin Radio), dhe në veçanti nenin 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë sa vijon:

(1) Sistemi i radiokomunikimit që përdoret aktualisht për operacionet hekurudhore, konkretisht

Global System for Mobile Communications – Rail (GSM-R), bazohet në specifikime të finalizuara rreth 20 vjet më parë dhe, për shkak të vjetërsimit teknologjik, mbështetja industriale për GSM-R nuk ka gjasa të garantohet shumë përtej vitit 2030. Future Railway Mobile Communication System (FRMCS) do të pasojë GSM-R si një nga elementët thelbësorë të European Railway Traffic Management System (ERTMS). Ai do të mbështesë dixhitalizimin e hekurudhave dhe inovacionin në shërbime. GSM-R dhe pasardhësit e tij, përfshirë FRMCS, emërtohen kolektivisht si Railway Mobile Radio (RMR).

(2) Krahasuar me GSM-R, FRMCS ofron cilësi më të lartë shërbimi, përdor spektrin në mënyrë më efikase dhe është më kosto-efektiv. Sistemi planifikohet gjithashtu të mbështesë aplikime të reja, si: Automatic Train Operation (ATO) dhe Connected Driver Advisory System (C-DAS). Aplikime të tjera pritet të shtohen gradualisht. Aplikimet kritike hekurudhore të FRMCS, si monitorimi dhe kontrolli i infrastrukturës kritike, mund të funksionojnë në mënyrë efikase duke përdorur narrowband IoT**.** FRMCS duhet të jetë në gjendje të integrojë aplikime të reja dhe zhvillime teknologjike për një periudhë të gjatë kohore, pasi sistemet e komunikimit hekurudhor kanë një cikël jetësor shumë më të gjatë se rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike.

(3) Prandaj, brezat e frekuencave duhet të harmonizohen për të mundësuar futjen e FRMCS.

(4) Për të mundësuar funksionimin paralel të GSM-R dhe pasardhësit të tij gjatë një faze migrimi afërsisht 10-vjeçare nga GSM-R në FRMCS, si dhe për të përfituar nga aplikimet e reja kritike hekurudhore gjatë dhe pas migrimit, aksesi në spektër të mjaftueshëm dhe të harmonizuar për RMR është thelbësor.

(5) Për të mbështetur një qasje të përbashkët në nivel të Bashkimit për spektrin e RMR, më 12 korrik 2018, Komisioni i dha mandat CEPT-it sipas nenit 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/EC.

(6) Në përgjigje të këtij mandati, CEPT paraqiti: CEPT Report 74 (3 korrik 2020) dhe CEPT Report 76 (20 nëntor 2020). Këto raporte bazohen në studime fizibiliteti dhe vlerësojnë sasinë e nevojshme të spektrit; identifikojnë brezat më të përshtatshëm të frekuencave dhe propozojnë kushtet teknike të harmonizuara për FRMCS.

(7) Në veçanti, CEPT Report 74 vlerëson bashkëjetesën me të gjitha aplikimet në brezat fqinjë të frekuencave, përfshirë shërbimet e komunikimeve elektronike në brezat 900 MHz dhe 2 GHz, pajisjet me rreze të shkurtër (SRD) sipas Vendimit Zbatues (BE) 2018/1538 dhe sistemet DECT (Digital European Cordless Telecommunications). Raporti merr gjithashtu parasysh futjen e mundshme të sistemeve ajrore pa pilot (UAS/dronë) në gamën 1880–1920 MHz.

(8) Kushtet teknike të harmonizuara për stacionet bazë RMR (FRMCS) që operojnë në brezin 1900–1910 MHz, siç përcaktohen në CEPT Report 76, supozojnë që stacionet bazë që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike dhe që përdorin frekuenca mbi 1920 MHz për marrje sipas Vendimit Zbatues (BE) 2020/667, të kenë selektivitet të përmirësuar krahasuar me standardet e harmonizuara evropiane aktuale. Stacionet bazë të komunikimeve elektronike që ndodhen pranë një stacioni bazë RMR dhe që nuk plotësojnë kriterin e selektivitetit të përmirësuar duhet, kur është e nevojshme, të përshtaten për të zbutur interferencat e dëmshme.

(9) CEPT Report 74 shqyrtoi realizueshmërinë teknike të përdorimit të rrjeteve komerciale mobile, duke marrë parasysh nevojat e sistemit hekurudhor për mbulim pa tela dhe besueshmëri të lartë. Raporti konfirmoi mundësinë e përdorimit të rrjeteve komerciale mobile për të gjitha aplikimet përkatëse hekurudhore, përfshirë aplikimet kritike hekurudhore, me kusht që pjesët përkatëse të rrjetit komercial të plotësojnë kërkesat e shërbimit të sistemeve hekurudhore.

(10) Marrësit RMR (stacionet bazë dhe radiot e kabinës së trenit) duhet të jenë rezistentë ndaj emetimeve në frekuencat fqinje. Shtetet Anëtare mund të zbatojnë masa shtesë në nivel kombëtar për të siguruar bashkëjetesën ndërmjet DECT në brezin 1880–1900 MHz dhe RMR në brezin 1900–1910 MHz, ose për të siguruar një ndarje frekuencore prej 200 kHz ndërmjet RMR dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike në kufirin 925 MHz.

(11) Sistemet FRMCS që përdorin sisteme aktive antenash (Active Antenna Systems – AAS) nuk janë marrë në konsideratë në CEPT Report 76.Studime shtesë duhet të kryhen nëse sisteme të tilla do të merren në konsideratë për vendosjen e FRMCS.

(12) Për sa kohë që një Shtet Anëtar nuk ka linja hekurudhore në funksionim, atij duhet t'i lejohet të shtyjë zbatimin e masave të harmonizimit të spektrit për RMR deri në momentin kur planifikohet aktivizimi i një linje hekurudhore.

(13) Bazuar në kërkesën kombëtare, Shteteve Anëtare duhet t'u lejohet, në përputhje me të drejtën e BE-së, të shtyjnë datën e zbatimit të masave të harmonizimit për brezin 1900–1910 MHz deri më 1 janar 2025**.**

(14) Zbatimi i këtij Vendimi nuk cenon të drejtën e Shteteve Anëtare për të organizuar dhe përdorur spektrin radio për qëllime të rendit public, sigurisë publike dhe mbrojtjes kombëtare, në përputhje me nenin 1(4) të Vendimit për Spektrin Radio dhe me legjislacionin e BE-së.

(15) Raportimi nga të gjitha Shtetet Anëtare tek Komisioni mbi zbatimin e këtij Vendimi, përfshirë çdo zhvillim në menaxhimin e spektrit që ka ndikim negativ në ndërveprueshmëri, si dhe raportimi i menjëhershëm i zbatimit të nenit 1(4) të Vendimit për Spektrin Radio dhe arsyetimit përkatës, do të ndihmojë në vlerësimin e ndikimit të këtij Vendimi në nivel të Bashkimit dhe në rishikimin e tij në kohën e duhur.

(16) Raporti 74 i CEPT-it shqyrtoi realizueshmërinë teknike të përdorimit të rrjeteve komerciale celulare, duke marrë parasysh nevojat e sistemit hekurudhor për mbulim pa tela dhe besueshmëri. Raporti konfirmoi mundësinë e përdorimit të rrjeteve komerciale celulare për të gjitha aplikimet përkatëse hekurudhore, përfshirë edhe aplikimet kritike hekurudhore, me kusht që pjesët përkatëse të rrjetit komercial celular të përmbushin kërkesat e shërbimit të sistemeve hekurudhore.

(17) Marrësit RMR (stacionet bazë dhe radiot e kabinës së trenit) duhet të jenë rezistentë ndaj emetimeve në frekuencat ngjitur. Shtetet Anëtare mund të zbatojnë masa shtesë në nivel kombëtar për të siguruar bashkëjetesën ndërmjet sistemeve DECT në brezin e frekuencave 1 880–1 900 MHz dhe RMR në brezin e frekuencave 1 900–1 910 MHz, ose për të siguruar një ndarje frekuencore prej 200 kHz ndërmjet RMR dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike në kufirin e frekuencës 925 MHz.

(18) Sistemet FRMCS që përdorin sisteme aktive antenash nuk janë marrë në konsideratë në Raportin 76 të CEPT-it. Duhet të kryhen studime shtesë në rast se sistemet aktive të antenave merren në konsideratë për vendosjen e FRMCS.

(19) Për sa kohë që një Shtet Anëtar nuk ka linja hekurudhore në funksionim, duhet t'i lejohet të shtyjë zbatimin e masave për harmonizimin e spektrit për RMR deri në momentin kur planifikohet vënia në funksion e këtyre linjave.

(20) Bazuar në kërkesën kombëtare, Shtetet Anëtare, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duhet të lejohen të shtyjnë datën e zbatimit të masave të harmonizimit të spektrit për RMR në brezin e frekuencave 1 900–1 910 MHz deri më 1 janar 2025.

(21) Zbatimi i këtij Vendimi nuk cenon të drejtën e Shteteve Anëtare për të organizuar dhe përdorur spektrin radio për qëllime të rendit publik, sigurisë publike dhe mbrojtjes kombëtare, në përputhje me nenin 1.4 të Vendimit për Spektrin Radio dhe në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

(22) Raportimi nga të gjitha Shtetet Anëtare tek Komisioni mbi zbatimin e këtij Vendimi, duke përfshirë çdo zhvillim në fushën e menaxhimit të spektrit që mund të ketë ndikim negativ në ndërveprueshmëri, si dhe raportimi i menjëhershëm për zbatimin, nëse ka, të nenit 1.4 të Vendimit për Spektrin Radio dhe arsyetimin përkatës, do të ndihmojë në vlerësimin e ndikimit të këtij Vendimi në nivel të Bashkimit dhe në rishikimin e tij në kohën e duhur.

(23) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radio.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Ky Vendim përcakton kushtet e harmonizuara për disponueshmërinë dhe përdorimin efikas të spektrit radio për Radiokomunikimet Mobile Hekurudhore (RMR) në brezat: 874,4-880,0 MHz, 919,4-925,0 MHz dhe 1 900-1 910 MHz.

Neni 2

Për qëllimet e këtij Vendimi:

(a) **"Terminal RMR"** është një pajisje radio mobile nën kontrollin e rrjetit RMR.

(b) **"Cab-radio"** është një terminal RMR i instaluar në bord të trenit, i aftë të mbështesë aplikime zanore dhe të dhënash

(c) **"Fuqi ekuivalente izotropike e rrezatuar (e.i.r.p.)"** nënkupton produktin e fuqisë së furnizuar në antenë dhe fitimit absolut (izotropik) të antenës në një drejtim të caktuar në raport me një antenë izotropike.

Neni 3

1. Deri më 1 janar 2022**,** Shtetet Anëtare duhet të caktojnë dhe të vënë në dispozicion mbi bazë jo-ekskluzive brezat e çiftuar 874,4-880,0 MHz dhe 919,4-925,0 MHz për Radiokomunikimet Mobile Hekurudhore, në përputhje me kushtet teknike të Aneksit.
2. Jo më vonë se 1 janar 2025, bazuar në kërkesën kombëtare, Shtetet Anëtare duhet të caktojnë dhe të vënë në dispozicion mbi bazë jo-ekskluzive brezin e paçiftuar 1 900-1 910 MHz për RMR, në përputhje me kushtet teknike të Aneksit.
3. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që rrjetet që përdorin brezat e frekuencave të përmendura më sipër t'u ofrojnë mbrojtje të përshtatshme sistemeve që operojnë në brezat fqinjë.
4. Shtetet Anëtare ku nuk ofrohen shërbime hekurudhore në datën 1 janar 2022 do të zbatojnë pikën 1 vetëm sapo të planifikohet aktivizimi i një linje hekurudhore.

Neni 4

Shtetet Anëtare duhet t'i raportojnë Komisionit mbi zbatimin e këtij Vendimi deri më 1 janar 2025.

Shtetet Anëtare duhet të monitorojnë përdorimin nga RMR të brezave të frekuencave që janë objekt i këtij Vendimi dhe t'i raportojnë Komisionit gjetjet e tyre, duke përfshirë çdo ndikim në ndërveprueshmëri që lidhet me çështje të spektrit, me kërkesë të Komisionit ose me iniciativën e tyre, në mënyrë që të mundësohet rishikimi në kohë i këtij Vendimi kur të jetë e nevojshme.

Neni 5

Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKSI

PJESA A

KUSHTET TEKNIKE PËR GSM-R NË BREZAT 874,4–880,0 MHz DHE 919,4–925,0 MHz

Për GSM-R zbatohen parametrat e mëposhtëm:

Frekuenca qendrore Downlink GSM-R: fDL = 921 MHz + n × 0,2 MHz ku $\{n \in \mathbb{Z} \mid -7 \leq n \leq 19\}$

Frekuenca qendrore Uplink GSM-R: fUL = fDL – 45 MHz
Gjerësia e kanalit GSM-R është 200 kHz.

Tabela 1
Kërkesat brenda bllokut për stacionet bazë GSM-R në brezin 919,4–921 MHz (vendosje pa koordinim)

Gjerësia e kanalit GSM-R	e.i.r.p. maksimale
200 kHz	= 70,5 dBm + (f_{DL} – 921) × 40/3 dB

f_{DL} është frekuenca qendrore në MHz

Nuk ka kufizim e.i.r.p. për stacionet bazë GSM-R që transmetojnë në brezin 921-925 MHz. Formula zbatohet vetem pwr to $f_{DL} \leq 921$ MHz. Për të lejuar nivele më të larta të e.i.r.p., duhet të zbatohen procedura koordinimi ose masa të tjera zbutëse.

PJESA B

KUSHTET TEKNIKE PËR NJË MBARTËS TË VETËM RMR ME BREZ TË GJERË NË BREZAT 874,4–880,0 MHz DHE 919,4–925,0 MHz

Kushtet teknike për stacionet bazë RMR që përdorin teknologji me brez të gjerë

Kushtet teknike të përcaktuara në këtë seksion paraqiten në formën e një Maskë Kufiri Blloku (Block Edge Mask – BEM) që zbatohet për stacionet bazë RMR me brez të gjerë. Këto kushte vlejnë përR një mbartës të vetëm RMR që përdor teknologji broadband. BEM është zhvilluar mbi bazën që marrëveshje të detajuara koordinimi dhe bashkëpunimi nuk kërkohen para vendosjes së rrjetit. Për të lejuar shumë mbartës (multiple carriers) ose e.i.r.p. më të lartë se kushtet e harmonizuara, duhet të zbatohen procedura koordinimi ose masa të tjera zbutëse.Stacionet bazë që përdorin sisteme aktive antenash (AAS) janë të ndaluara.

Për teknologjitë e aksesit radio të ndryshme nga GSM-R zbatohet:

— Kufiri i poshtëm i Resource Block më të ulët duhet të jetë **≥ 919,6 MHz**.

Tabela 2
Kërkesë e përgjithshme brenda bllokut (jo e detyrueshme)

Gjerësia e kanalit PMR	e.i.r.p. maksimale
Çdo gjerësi kanali	Mund të përdoret vlera: Min {65 dBm/kanal, e.i.r.p. maksimale specifike për gjerësinë e kanalit}

Tabela 3
Kërkesat specifike brenda bllokut për kanalet 5,6 MHz dhe 5 MHz (të detyrueshme për vendosje pa koordinim)

Gjerësia e kanalit	e.i.r.p. maksimale
5,6 MHz	= 62 dBm/5,6 MHz
5 MHz	= 64,5 dBm/5 MHz + (f_{DL} – 922,1) × 40/3 dB

f_{DL} është frekuenca qendrore në MHz.

Lejohet mënyra **NB-IoT in-band pa rritje fuqie (power boost).** Nuk lejohen NB-IoT guard-band mode dhe NB-IoT in-band me power boost.

Tabela 4
Kërkesat specifike për kanalet 1,4 MHz dhe 200 kHz

Gjerësia e kanalit	e.i.r.p. maksimale
1,4 MHz	= 56 dBm/1,4 MHz + (f_{DL} – 920,2) × 40/3 dB (Shënim 1)
200 kHz (Shënim 2)	= 70,5 dBm/200 kHz + (f_{DL} – 921) × 40/3 dB (Shënim 3)

f_{DL} është frekuenca qendrore në MHz.
Shënim 1: Formula 1,4 MHz zbatohet vetëm për fDL ≤ 921,7 MHz.
Shënim 2: Kanali 200 kHz zbatohet për mënyrën NB-IoT standalone**,** e përbërë nga një Resource Block.
Shënim 3: Formula 200 kHz zbatohet vetëm për fDL ≤ 921,0 MHz. Mbi këtë vlerë nuk ka kufizim specifik të e.i.r.p.

Tabela 5
Kërkesat për emetimet jashtë brezit

MHz nga kufiri i bllokut (919,4–925 MHz)	Kufiri i e.i.r.p.
$0 \leq \Delta f < 0,2$	32,5 dBm/200 kHz
$0,2 \leq \Delta f < 1$	14 dBm/800 kHz
$1 \leq \Delta f < 10$	5 dBm/MHz
Në raste të veçanta, në nivel kombëtar, mund të zbatohen kufij më të lartë për emetimet jashtë brezit.	

Tabela 6
Kërkesa bazë

Gama e frekuencave	Kufiri e.i.r.p.
880-915 MHz	-49 dBm/5 MHz
Kjo kërkesë ka përparësi ndaj kërkesave për emetimet jashtë brezit.	

Kushtet teknike për radiot e kabinës (Cab-Radio) RMR që përdorin teknologji me brez të gjerë

Për teknologjitë e aksesit radio të ndryshme nga GSM-R, zbatohen parametrat e mëposhtëm:

Fuqia maksimale e daljes: më e madhe se 23 dBm dhe deri në 31 dBm;
ACLR (Raporti i Rrjedhjes së Fuqisë në Kanalin Ngjitur): minimumi 37 dB;
Kontrolli i fuqisë në uplink është i detyrueshëm dhe duhet të jetë i aktivizuar.

Kushtet teknike për terminalet RMR, përveç radiove të kabinës, që përdorin teknologji me brez të gjerë

Për teknologjitë e aksesit radio të ndryshme nga GSM-R, zbatohen parametrat e mëposhtëm:
Fuqia maksimale e daljes: 23 dBm;
ACLR: minimumi 30 dB;
Kontrolli i fuqisë në uplink është i detyrueshëm dhe duhet të jetë i aktivizuar.

Kushtet teknike për marrësit RMR që përdorin teknologji me brez të gjerë

Brezi mund të përdoret vetëm nëse aplikohen teknika për aksesin në spektër dhe për zbutjen e interferencave që sigurojnë një nivel të përshtatshëm të performancës së marrësit, në përputhje me kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Kur teknikat përkatëse përshkruhen në standarde të harmonizuara ose në pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2014/53/BE, duhet të sigurohet një nivel performance të paktën ekuivalent me atë që lidhet me këto teknika.

Tabela 7
Kërkesat për karakteristikat e marrësit të stacionit bazë RMR me brez të gjerë

Parametri	Vlera
Niveli i sinjalit të dëshiruar	RefSens + 3 dB
Sinjali maksimal ndërhyrës në brezin 870–874,4 MHz (Shënimi 1)	-34 dBm

Konektori i antenës së modulit radio është pika e referencës.Ndjeshmëria referente (RefSens) është fuqia mesatare minimale e marrë në konektorin e antenës, në të cilën duhet të arrihet niveli minimal i performancës së specifikuar. Këto kërkesa mbulojnë si bllokimin e sinjalit (blocking), ashtu edhe intermodulimin e rendit të tretë (third-order intermodulation).

Shënimi 1: Supozohet një gjerësi brezi prej 200 kHz për sinjalin ndërhyrës.

Tabela 8
Kërkesa vetëm për karakteristikat e marrësit të radios së kabinës (Cab-Radio) RMR me brez të gjerë

Parametri	Vlera

Niveli i sinjalit të dëshiruar	RefSens + 3 dB
Sinjali maksimal ndërhyrës në brezin 880–918,9 MHz (Shënimi 1)	-26 dBm
Sinjali maksimal ndërhyrës me valë të vazhdueshme (Continuous Wave) në brezin 925,6–927 MHz	-13 dBm
Sinjali maksimal ndërhyrës me valë të vazhdueshme (Continuous Wave) në brezin 927–960 MHz	-10 dBm
Sinjali maksimal ndërhyrës LTE me gjerësi brezi 5 MHz (me mbartësin më të ulët të përqendruar në 927,6 MHz)	-13 dBm

Konektori i antenës së modulit radio është pika e referencës. Ndjeshmëria referente (RefSens) është fuqia mesatare minimale e marrë në konektorin e antenës, në të cilën duhet të arrihet niveli minimal i performancës së specifikuar. Këto kërkesa mbulojnë si: bllokimin e sinjalit (blocking), ashtu edhe intermodulimin e rendit të tretë (third-order intermodulation).

Shënimi 1: Supozohet një gjerësi brezi prej 400 kHz për sinjalin ndërhyrës RFID.

PJESA C

KUSHTET TEKNIKE PËR RMR ME BREZ TË GJERË NË BREZIN 1 900–1 910 MHz (TDD)

Kushtet teknike për stacionet bazë RMR që përdorin teknologji me brez të gjerë

Kushtet teknike të përcaktuara në këtë seksion paraqiten në formën e një Maske të Kufirit të Bllokut (Block Edge Mask – BEM) që zbatohet për stacionet bazë RMR me brez të gjerë.

BEM është zhvilluar mbi bazën që nuk do të jetë e nevojshme të ekzistojnë marrëveshje të detajuara koordinimi dhe bashkëpunimi përpara vendosjes së rrjetit. Stacionet bazë që përdorin sisteme aktive antenash janë të ndaluara.

Zbatohen parametrat e mëposhtëm:

Tabela 9

Kërkesa e përgjithshme brenda bllokut, e detyrueshme për vendosje pa koordinim

Gjerësia e kanalit RMR	e.i.r.p. maksimale
10 MHz	= 65 dBm/10 MHz (Note 1)

Shënim 1: Shtetet Anëtare mund të lejojnë një nivel më të lartë të e.i.r.p., në varësi të koordinimit kombëtar ose masave të tjera për zbutjen e interferencave.

Tabela 10
Kërkesa bazë

Gama e frekuencave	Kufiri e.i.r.p.
1 920-1 980 MHz	-43 dBm/5 MHz

Kushtet teknike për radiot e kabinës (Cab-Radio) RMR që përdorin teknologji me brez të gjerë

Zbatohen parametrat e mëposhtëm:
Fuqia maksimale e daljes: 31dBm; ACLR: minimumi 37 dB;

Fuqia e padwshiruar e daljes ne brezin 1 920-1 980 MHz:

- maksimumi –25 dBm/MHz në brezin 1 920–1 925 MHz;
- maksimumi –30 dBm/MHz në brezin 1 925–1 980 MHz.

Kontrolli i fuqisë në uplink është i detyrueshëm dhe duhet të jetë i aktivizuar.

Kushtet teknike për terminalet RMR, përveç radiove të kabinës, që përdorin teknologji me brez të gjerë

Zbatohen parametrat e mëposhtëm:

Fuqia maksimale e daljes: 23dBm;

ACLR: minimumi 30 dB;

Kontrolli i fuqisë në uplink është i detyrueshëm dhe duhet të jetë i aktivizuar.

Kushtet teknike për marrësit RMR që përdorin teknologji me brez të gjerë

Brezi mund të përdoret vetëm nëse aplikohen teknika për akses në spektër dhe për zbutjen e interferencave që sigurojnë një nivel të përshtatshëm të performancës së marrësit, në përputhje me kërkesat thelbësore të Direktivës 2014/53/BE. Kur teknikat përkatëse përshkruhen në standarde të harmonizuara ose në pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian në përputhje me Direktivën 2014/53/BE, duhet të sigurohet një nivel performance të paktën ekuivalent me atë që lidhet me këto teknika.

Tabela 11
Kërkesat për karakteristikat e marrësit të stacionit bazë RMR me brez të gjerë

Parametri	Value
Niveli i sinjalit të dëshiruar	RefSens + 3 dB
Sinjali maksimal ndërhyrës LTE me gjerësi brezi 5 MHz në brezin 1 805–1 880 MHz	-20 dBm

Konektori i antenës së marrësit të stacionit bazë është pika e referencës. Ndjeshmëria referente (RefSens) është fuqia mesatare minimale e marrë në konektorin e antenës në të cilën duhet të arrihet niveli minimal i performancës së specifikuar. Këto kërkesa mbulojnë bllokimin e sinjalit (blocking) dhe intermodulimin e rendit të tretë (third-order intermodulation).

Tabela 12

Kërkesa vetëm për karakteristikat e marrësit të radios së kabinës (Cab-Radio) RMR me brez të gjerë

Parameter	Value
Niveli i sinjalit të dëshiruar	RefSens + 3 dB
Sinjali maksimal ndërhyrës LTE me gjerësi brezi 5 MHz në brezin 1 805–1 880 MHz	-13 dBm
Sinjali maksimal ndërhyrës LTE me gjerësi brezi 5 MHz në brezin 1 920–1 980 MHz	-39 dBm

Konektori i antenës së marrësit të stacionit bazë është pika e referencës. Ndjeshmëria referente (RefSens) është fuqia mesatare minimale e marrë në konektorin e antenës në të cilën duhet të arrihet niveli minimal i performancës së specifikuar.Këto kërkesa mbulojnë bllokimin e sinjalit (blocking) dhe intermodulimin e rendit të tretë (third-order intermodulation).

6.15 Përditësimi i kushteve teknike të harmonizuara në fushën e përdorimit të spektrit radio për pajisjet me rreze të shkurtër

(Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2022/180 i datës 8 Shkurt 2022 për ndryshimin e Vendimit 2006/771/EC)

(njoftuar me dokumentin C(2022) 644)

KOMISIONI EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Vendimin Nr. 676/2002/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 mars 2002, mbi kuadrin rregullator për politikën e spektrit radio në Komunitetin Evropian, dhe veçanërisht nenin 4(3) të tij,

Duke marrë në konsideratë sa vijon:

(1) Pajisjet me rreze të shkurtër (Short Range Devices – SRD) janë zakonisht pajisje radio të tregut masiv ose pajisje radio portative, ose të dyja bashkë, të cilat mund të transportohen dhe përdoren lehtësisht përtej kufijve shtetërorë. Dallimet në kushtet e aksesit në spektër brenda tregut të brendshëm rrezikojnë të krijojnë interferenca të dëmshme me aplikime dhe shërbime të tjera radio, të pengojnë lëvizjen e lirë të këtyre pajisjeve dhe të rrisin kostot e prodhimit të tyre.

(2) Vendimi i Komisionit 2006/771/EC harmonizon kushtet teknike për përdorimin e spektrit për një gamë të gjerë pajisjesh me rreze të shkurtër në fusha aplikimi si sistemet e alarmit, komunikimet locale, telekomanda, implantet mjekësore, mbledhja e të dhënave mjekësore, sistemet inteligjente të transportit, "Interneti i Gjërave" (Internet of Things – IoT), përfshirë identifikimin me radiofrekuencë (RFID). Si rezultat, pajisjet me rreze të shkurtër që respektojnë këto kushte teknike të harmonizuara i nënshtrohen vetëm një autorizimi të përgjithshëm sipas legjislacionit kombëtar.

(3) Vendimi Zbatues (BE) 2018/1538 i Komisionit harmonizon gjithashtu kushtet teknike për përdorimin e spektrit nga pajisjet me rreze të shkurtër në brezat e frekuencave 874–

874,4 MHz dhe 915–919,4 MHz. Meqenëse në këto breza mjedisi i ndarjes së spektrit është i ndryshëm, kërkohet një regjim rregullator specifik. Ky vendim mundëson zgjidhje të avancuara teknikisht RFID dhe aplikime të "Internetit të Gjërave" (IoT) të bazuara në pajisje të ndërlidhura me rreze të shkurtër brenda rrjeteve të të dhënave.

(4) Vendimi 2006/771/EC dhe Vendimi Zbatues (BE) 2018/1538 përbëjnë kuadrin rregullator për pajisjet me rreze të shkurtër, i cili mbështet inovacionin për një gamë të gjerë aplikimesh brenda tregut të vetëm dixhital.

(5) Aplikime të reja për pajisjet me rreze të shkurtër po shfaqen për shkak të rëndësisë në rritje të këtyre pajisjeve për ekonominë, ndryshimeve të shpejta teknologjike, kërkesave të reja të shoqërisë. Këto aplikime kërkojnë përditësime të rregullta të kushteve teknike të harmonizuara për përdorimin e spektrit.

(6) Bazuar në mandatin e përhershëm të dhënë Konferencës Evropiane të Administratave Postare dhe Telekomunikacionit (CEPT) në korrik 2006, në përputhje me nenin 4(2) të Vendimit Nr. 676/2002/EC, për të përditësuar Aneksin e Vendimit 2006/771/EC në mënyrë që të pasqyrojë zhvillimet teknologjike dhe të tregut në fushën e pajisjeve me rreze të shkurtër, ai aneks është ndryshuar shtatë here. Puna e kryer në bazë të këtij mandati të përhershëm shërbeu gjithashtu si bazë për Vendimin Zbatues (BE) 2018/1538, i cili siguron spektër shtesë për pajisjet me rreze të shkurtër në brezat e frekuencave 874–874,4 MHz dhe 915–919,4 MHz.

(7) Më 16 korrik 2019, Komisioni lëshoi letrën e tij udhëzuese për ciklin e tetë të përditësimit. Në përgjigje të mandatit të përhershëm dhe në përputhje me këtë udhëzim, CEPT i paraqiti Komisionit Raportin 77 më 5 mars 2021. Përveç përmirësimeve të hyrjeve ekzistuese që zbatohen për pajisjet telematike të transportit dhe trafikut, CEPT propozoi shtimin e hyrjeve të reja në Aneksin e Vendimit 2006/771/EC. Këto hyrje të reja duhet të mundësojnë përdorimin e spektrit për aplikimet e mbyllura të Rezonancës Magnetike Bërthamore (Nuclear Magnetic Resonance – NMR)**.** Prandaj, ky raport duhet të shërbejë si bazë teknike për këtë Vendim.

(8) Pajisjet me rreze të shkurtër që operojnë sipas kushteve të përcaktuara në këtë Vendim duhet gjithashtu të jenë në përputhje me Direktivën 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

(9) Prandaj, Vendimi 2006/771/EC duhet të ndryshohet.

(10) Masat e parashikuara në këtë Vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të Spektrit Radio.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2006/771/EC ndryshohet si më poshtë:

(1) Shtohet neni i mëposhtëm 4a: '*Neni 4a*
Shtetet Anëtare duhet t'i raportojnë Komisionit mbi zbatimin e këtij Vendimi jo më vonë se data 1 tetor 2022.';

(2) Aneksi zëvendësohet me tekstin e përcaktuar në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim u drejtohet Shteteve Anëtare.

ANEKSI

Brezat e frekuencave me kushtet teknike të harmonizuara përkatëse dhe afatet e zbatimit për pajisjet me rreze të shkurtër

Tabela 1 përcakton fushën e zbatimit të kategorive të ndryshme të pajisjeve me rreze të shkurtër (siç përcaktohen në nenin 2(3)) ndaj të cilave zbatohet ky Vendim. Tabela 2 përcakton kombinime të ndryshme të brezit të frekuencave, kategorisë së pajisjeve me rreze të shkurtër si dhe kushtet teknike të harmonizuara për aksesin në spektër dhe afatet e zbatimit që zbatohen për to.

Kushtet e përgjithshme teknike të zbatueshme për të gjitha brezat dhe pajisjet me rreze të shkurtër që hyjnë në fushën e zbatimit të këtij Vendimi:

- Shtetet Anëtare duhet të lejojnë që brezat fqinjë të frekuencave të përcaktuara në Tabelën 2 të përdoren si një brez i vetëm frekuencor, me kusht që të respektohen kushtet specifike të secilit prej këtyre brezave fqinjë.
- Shtetet Anëtare duhet të lejojnë përdorimin e spektrit deri në fuqinë e transmetimit, intensitetin e fushës ose dendësinë e fuqisë të përcaktuar në Tabelën 2. Në përputhje me nenin 3(3), ato mund të vendosin kushte më pak kufizuese, domethënë të lejojnë përdorimin e spektrit me fuqi transmetimi, intensitet fushe ose dendësi fuqie më të lartë, me kusht që kjo të mos reduktojë ose kompromentojë bashkëjetesën e përshtatshme ndërmjet pajisjeve me rreze të shkurtër në brezat e harmonizuar nga ky Vendim.
- Shtetet Anëtare mund të vendosin vetëm parametrat shtesë (kanalizimi dhe/ose rregullat e aksesit dhe përdorimit të kanalit) të përcaktuara në Tabelën 2 dhe nuk duhet të shtojnë parametra të tjerë ose kërkesa shtesë për aksesin në spektër dhe zbutjen e interferencave. Kushtet më pak kufizuese sipas nenit 3(3) nënkuptojnë që Shtetet Anëtare mund t'i heqin plotësisht këta parametra shtesë në një qelizë të caktuar të tabelës ose të lejojnë vlera më të larta, me kusht që të mos cenohet mjedisi i përshtatshëm i ndarjes së spektrit në brezin e harmonizuar.
- Shtetet Anëtare mund të vendosin vetëm kufizimet e tjera të përdorimit të përcaktuara në Tabelën 2 dhe nuk duhet të shtojnë kufizime të tjera shtesë. Meqenëse mund të zbatohen kushte më pak kufizuese sipas nenit 3(3), Shtetet Anëtare mund të heqin një ose të gjitha këto kufizime, me kusht që të mos cenohet mjedisi i përshtatshëm i ndarjes së spektrit në brezin e harmonizuar.
- Kushtet më pak kufizuese sipas nenit 3(3) zbatohen pa cenuar Direktivën 2014/53/BE.

Për qëllimet e këtij Aneksi zbatohet përkufizimi i mëposhtëm për ciklin e punës (duty cycle)**:**

"Cikli i punës (duty cycle)" nënkupton raportin, të shprehur në përqindje, të Σ(Ton)/(Tobs)\Sigma(T_{on}) / (T_{obs})Σ(Ton)/(Tobs) ku Ton është koha e transmetimit ("on time") e një pajisjeje të vetme transmetuese dhe Tobs është periudha e vëzhgimit. Ton matet brenda një brezi frekuencor vëzhgimi (Fobs).Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë aneks Teknik, Tobs është një periudhë e vazhdueshme prej një ore dhe Fobs është brezi përkatës i frekuencave i përcaktuar në këtë aneks teknik. Kushtet më pak kufizuese sipas kuptimit të nenit 3(3) nënkuptojnë që Shtetet Anëtare mund të lejojnë një vlerë më të lartë për "ciklin e punës (duty cycle)".

Tabela 1

Kategoritë e pajisjeve me rreze të shkurtër sipas nenit 2(3) dhe fusha e tyre e zbatimit

Kategoria e pajisjeve me rreze të shkurtër	**Fusha e zbatimit**

Pajisje me rreze të shkurtër me qëllim të përgjithshëm (SRD)	Përfshin të gjitha llojet e pajisjeve radio, pavarësisht aplikimit ose qëllimit të tyre, të cilat përmbushin kushtet teknike të përcaktuara për një brez të caktuar frekuencash. Përdorimet tipike përfshijnë telemetrinë, telekomandën, sistemet e alarmit, transmetimin e të dhënave në përgjithësi dhe aplikime të tjera.
Pajisje aktive mjekësore të implantueshme	Përfshin pjesën radio të pajisjeve aktive mjekësore të implantueshme që synohen të futen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë kirurgjikale ose mjekësore, në trupin e njeriut ose të kafshëve, si dhe pajisjet e tyre ndihmëse, kur është e zbatueshme. Pajisjet aktive mjekësore të implantueshme përcaktohen në Direktivën 90/385/KEE të Këshillit.
Pajisje ndihmëse të dëgjimit (ALD)	Përfshin sisteme radio-komunikimi që u mundësojnë personave me dëmtim të dëgjimit të përmirësojnë aftësinë e tyre dëgjuese. Instalimet tipike përbëhen nga një ose më shumë transmetues radio dhe një ose më shumë marrës radio.
Pajisje me cikël të lartë pune / transmetim të vazhdueshëm	Përfshin pajisje radio që mbështeten në vonesë të ulët dhe transmetime me cikël të lartë pune. Këto pajisje përdoren zakonisht për sisteme personale audio pa tela dhe transmetim multimedial, për transmetime audio/video dhe sinjale sinkronizimi audio/video, telefona celularë, sisteme argëtimi për automjete ose shtëpi, mikrofona pa tela, altoparlantë pa tela, kufje pa tela, pajisje radio që mbahen në trup, pajisje ndihmëse të dëgjimit, monitorim në vesh (in-ear monitoring), mikrofona pa tela për koncerte ose shfaqje skenike dhe transmetues analogë FM me fuqi të ulët.
Pajisje induktive	Përfshin pajisje radio që përdorin fusha magnetike me sisteme lakore induktive për komunikime në afërsi dhe aplikime përcaktimi. Kjo zakonisht përfshin pajisje për bllokimin e automjeteve, identifikimin e kafshëve, sistemet e alarmit, zbulimin e kabllove, menaxhimin e mbetjeve, identifikimin personal, lidhje zanore pa tela, kontrollin e aksesit, sensorët e afërsisë dhe të metaleve, sistemet kundër vjedhjes, sistemet induktive RF kundër vjedhjes, transferimin e të dhënave në pajisje portative, identifikimin automatik të artikujve, sistemet e kontrollit pa tela dhe tarifimin automatik rrugor.
Pajisje me cikël të ulët pune / besueshmëri të lartë	Përfshin pajisje radio që mbështeten në përdorim të ulët të spektrit dhe rregulla aksesi me cikël të ulët pune për të siguruar akses shumë të besueshëm në spektër dhe transmetime në breza të përbashkët. Aplikimet tipike përfshijnë sisteme alarmi që përdorin komunikim radio për sinjalizimin e një gjendjeje alarmi në një vend të largët dhe sisteme alarmi social që mundësojnë komunikim të besueshëm për persona në gjendje rreziku.
Pajisje për mbledhjen e të dhënave mjekësore	Përfshin transmetimin e të dhënave jozanore drejt dhe nga pajisje mjekësore jo të implantueshme për monitorimin, diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve në institucione shëndetësore ose në shtëpitë e tyre, sipas përshkrimit të profesionistëve të autorizuar të kujdesit shëndetësor.
Pajisje PMR446	Përfshin pajisje portative dore (pa përdorim të stacioneve bazë ose përsëritësve), të mbajtura nga personi ose të përdorura manualisht, të cilat përdorin vetëm antena të integruara për të maksimizuar ndarjen e spektrit dhe minimizuar interferencat. Pajisjet PMR446 funksionojnë në mënyrë direkte “peer-to-peer” me rreze të shkurtër dhe nuk duhet të përdoren si pjesë e një rrjeti infrastrukture ose si përsëritës.
Pajisje për përcaktim radio (Radio Determination Devices)	Përfshin pajisje radio të përdorura për përcaktimin e pozicionit, shpejtësisë dhe/ose karakteristikave të tjera të një objekti ose për marrjen e informacionit që lidhet me këto parametra. Pajisjet e përcaktimit radio zakonisht kryejnë matje për të përcaktuar këto karakteristika. Kjo kategori përjashton çdo lloj komunikimi radio pikë-më-pikë ose pikë-me-shumë pika.
Pajisje të identifikimit me radiofrekuencë (RFID)	Përfshin sisteme komunikimi radio të bazuara në etiketa (tag) dhe lexues (interrogator), të përbëra nga: (i) pajisje radio (etiketa) të vendosura mbi objekte të gjalla ose jo të gjalla dhe (ii) njësi transmetuese/marrëse (lexues) që aktivizojnë etiketat dhe marrin të dhëna prej tyre. Aplikimet tipike përfshijnë gjurmimin dhe identifikimin e objekteve, për shembull për mbikëqyrjen elektronike të artikujve (EAS), si dhe mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave që lidhen me objektet ku janë vendosur etiketat. Etiketat mund të jenë pa bateri, me bateri ndihmëse ose të furnizuara plotësisht me bateri. Përgjigjet e etiketave verifikohen nga lexuesi përkatës dhe i transmetohen sistemit pritës (host system).
Pajisje telematike të transportit dhe trafikut	Përfshin pajisje radio që përdoren në fushat e transportit (rrugor, hekurudhor, ujor ose ajror, në varësi të kufizimeve teknike përkatëse), menaxhimit të trafikut, navigimit, menaxhimit të lëvizshmërisë dhe sistemeve inteligjente të transportit (ITS). Aplikimet tipike përfshijnë ndërfaqet ndërmjet mënyrave të ndryshme të transportit, komunikimin ndërmjet automjeteve (p.sh. automjet me automjet), ndërmjet automjeteve dhe pikave fikse (p.sh. automjet me infrastrukturë), si dhe komunikimin nga dhe drejt përdoruesve.

Pajisje për transmetimin e të dhënave me brez të gjerë	Përfshin pajisje radio që përdorin teknika modulimi me brez të gjerë për akses në spektër. Përdorimet tipike përfshijnë sistemet e aksesit pa tela, si rrjetet lokale radio (WAS/RLAN), ose pajisjet SRD me brez të gjerë në rrjetet e të dhënave.

Direktiva 90/385/KEE e Këshillit, datë 20 qershor 1990, për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me pajisjet aktive mjekësore të implantueshme (Gazeta Zyrtare L 189, 20.7.1990, fq. 17).

Për Tabelën Nr. 2 Brezat e frekuencave me kushtet teknike të harmonizuara përkatëse dhe afatet e zbatimit për pajisjet me rreze të shkurtër, referojuni vendimit të mësipërm.

SHTOJCA 1

Fjalori i shkurtimeve të përdorura

8PSK	8 Phase Shift Keying
ACAS	Airborne Collision Avoidance System – Sistem Shmangie Perplasieje per Forcat Ajrore
AES	Aircraft Earth Station – Stacion Tokesor i Avionineve
AIS	Universal Shipborne Automatic Identification System – Sistem Universal Identifikimi Automatik per Anijet
ALS	Airfield Landing System – Sistem Uljeje Aeroporti
ASDE	Airport Surface Detection Equipment – Pajisje Dedektimi per Siperfaqe Aeroporti
ATIS	Automatic Transmitter Identification System – Sistem Automatik Identifikimi Transmetuesi
AVI	Automatic Vehicle Identification for Railways – Identifikim automatik i Mjeteve per Hekurudha
BFWA	Broadband Fixed Wireless Access (Akses me Brez të Gjërë Fiks PaTela)
BRAN	Broadband Radio Access Networks- Rrjete aksesi radio me brez te gjere
BWA	Broadband Wireless Access (Aksesi Pa Tela me Brez të Gjërë)
CEPT	European Conference of Postal and Telecommunications Administrations - Konferenca Evropiane e Administratave Postare dhe te Telekomunikacionit
CEPT T/R	CEPT T/R Recommendation - Rekomandim i CEPT T/R
CT1	Cordless Telephone 1 - Telefon pa Tel 1
DCS 1800	Digital Communication System 1800 – Sistem Komunikimi Dixhital 1800
DECT	Digital Enhanced Cordless Telecommunications-Pajisje Dixhitale Komunikimi pa Tel
DFS	Dynamic Frequency Selection – Selektim Dinamik i Frekuences
DME	Distance Measuring Equipment – Pajisje Matje Distance
DMO	Direct Mode Operation – Menyre Direkte Veprimi
DSC	Digital Selective Calling – Thirrje Selektive Dixhitale
DVB-T	Digital Video Broadcasting — Terrestrial – Transmetim Video Dixhital Tokesor
EAS	Electronic Article Surveillance – Mbikqyres Elektronik Artikujsh
ECC	Electronic Communications Committee – Komiteti Komunikimeve Elektronike
ECC/DEC	ECC Decision – Vendim ECC
ECS	Electronic Communication Services – Shërbime të Komunikimeve Elektronike

EGSM	Extended GSM
EIRP	Equivalent Isotropically Radiated Power – Fuqi e Rrezatuar Izotropikalisht ne cdo Drejtim
ELT	Emergency Location Transmitter – Transmetues Vendodhjeje Urgjence
EN	European Standard – Standart Europian
EOV	Unified National Projection System – Sistem Projektimi Kombetar I Unifikuar
EPIRB	Emergency Position-Indicating Radiobeacon – Sinjalizim Radio Tregues - Pozicioni i Urgjences
ERC	European Radiocommunications Committee – Komiteti Evropian i Radiokomunikimeve
ERC/DEC	ERC Decision – Vendim ERC
ERP	Effective Radiated Power – Fuqi e Rrezatuar Efektive
ETCS	European Train Control System – Sistemi Evropian I Kontrollit te Trenave
ETS	European Telecommunications Standard – Standart Evropian Telekomunikacioni
EU	European Union – Bashkimi Evropian
FDD	Frequency Division Duplex – (Menyre modulimi me pjesetim ne frekuence-duplex)
FHSS	Frequency Hopping Spread Spectrum – (Menyre modulimi me kercim ne frekuence).
FM	Frequency Modulated –Moduluar ne Frekuence
FWA	Fixed Wireless Access – Akses pa tel fiks
GMDSS	Global Maritime Distress and Safety System – Sistem Global i Sigurise dhe Fatkeqesise ne Det
GMSK	Gaussian Minimum Shift Keying
GNSS	Global Navigation Satellite System – Sistem Global Navigimi Satelitor
GSM	Global System for Mobile Communications – Sistem Global per Komunikime te Levizshme
GSM-R	GSM-Railway
HCM	Harmonised Calculation Method – Metoda e Llogaritjes se Harmonizuar
HDFSS	High-density applications in the fixed-satellite service – Aplikime me Densitet te Larte ne sherbimet Satelitore te palevisshme
HF	High Frequency – Frekuence e Larte
HIPERLAN	High Performance Radio Local Area Network – Rrjet Lokal Radio me Performance te Larte
HiperMAN	High Performance Radio Metropolitan Area Network – Rrjet Metropolitan Radio me Performance te Larte
IARU	International Amateur Radio Union – Bashkimi Nderkombetar i Radio Amatoreve

ICAO	International Civil Aviation Organization – Organizata Nderkombetare e Aviacionit Civil
ICAO Annex 10	Annex 10 to the Convention on International Civil Aviation (Aeronautical Telecommunications) - Shtojca 10 e Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar (Telekomunikacione Aeronautike)
ICAO EANPG	ICAO European Air Navigation Planning Group - ICAO Grup Planifikimi per Navigimin Ajror Europian
ILS	Instrument Landing System – Sistemi Ulje me Instrumenta
ILS LOC	Localizer Element of ILS – Element Lokalizues I ILS
IMT-2000	International Mobile Telecommunications - 2000/Universal Mobile Telecommunications System
ISM	Industrial, Scientific and Medical - Industrial, Shkencor dhe Mjekësor
ITU	International Telecommunication Union – Bashkimi Nderkombetar i Telekomunikacionit
ITU-R	ITU Radiocommunication Sector – ITU Sektori Radiokomunikimeve
LBT	Listen before talk – Degjo para se te flasesh
LF	Low Frequency – Frekuence e Ulet
LORAN	Long Range Air Navigation System – Sistem Navigimi Ajror per Distance te Gjate
MF	Medium Frequency – Frekuence e Mesme
MFCN	Mobile/Fixed Communications Networks (Rrjete Komunikimesh fikse/të lëvizshme)
MLS	Microwave Landing System – Sistem Uljeje Mikrovalor
MSI	Maritime Safety Information – Informacion Sigurie Detare
NAVTEX	Automated direct-printing telegraph system for navigational and meteorological warnings and urgent information to ship
NBFM	Narrow-Band Frequency Modulated – Moduluar ne Frekuence me Brez-Ngushte
NDB	Non-Directional Radio Beacon – Sinjalizim Radio jo i Drejtuar
OFDM	Orthogonal Frequency Division Multiplex-Modulim me pjesetim ne frekuence ortogonal
OMEGA	Hyperbolic Long-range Navigation System – Sistem Navigimi Hiperbolik per Distance (hapsire) te Gjate
(OR)	Off-route – Jashte Korridori
PABX	Private Automatic Branch Exchange – Central Automatik Privat
PAR	Precision Approach Radar Element – Element Radari Perafrim Precizioni
PBX	Private Branch Exchange – Central Privat
PMR	Professional/Private Mobile Radio – Radio e Levisshme Profesionale/Private
PR 27	Personal Radio 27 – Radio Personale 27

(R)	Route – Korridor
RF	Radio Frequency – Radio frekuence
RFID	Radio Frequency Identification – Identifikim Radio Frekuence
RLAN	Radio Local Area Network – Rrjet local Radio
ROES	Receive Only Earth Station – Stacion Tokesor Vetem Marje
RR	Radio Regulations – Radio Rregullore
RSMS	Radar Sensing and Measurement System – Sistem Mates dhe Ndjeshmerie Radari
RTTT	Road Transport & Traffic Telematics – Telemates Trafiku dhe Transporti Rrugor
SIT	Satellite Interactive Terminal – Terminal Interaktiv Satelitor
SNG	Satellite News Gathering – Grumbullim Lajmesh nga Sateliti
SOLAS	International Convention for the Safety of Life at Sea, 1974 - Konventa Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në det, 1974
S-PCS	Satellite Personal Communications Services/Systems – Sherbime/Sisteme Personale Komunikimi Satelitore
SRE	Surveillance Radar Element – Element Radari Mbikqyres
SRD	Short Range Device – Pajisje per Distance te Shkurter
SRR	Automotive Short Range Radar – Radar Vetelevizes per Distance te Shkurter
SSB	Single-Sideband
SSR	Secondary Surveillance Radar – Radar Mbykqyres Dytesor
SUT	Satellite User Terminal – Terminal Perdorues Satelitor
T-DAB	Terrestrial Digital Audio Broadcasting – Transmetim Dixhital Tokesor Audio
TDD	Time Division Duplex-Modulim me Pjesetim ne Kohe Duplex
TPC	Transmitter Power Control – Kontrollues i Fuqise se Transmetuesit
TRA-ECS	Terrestrial Radio Applications Capable of Providing Electronic Communications-Aplikime radio tokesore qe mundesojne komunikimet elektronike
TV	Television - televizion
UIC	International Union of Railways – Bashkimi Nderkombetar Hekurudhor (I hekurudhave)
VHF	Very High Frequency – Frekuence Shume e Larte
VHF-FM	VHF – Frequency Modulated – VHF-Moduluar ne Frekuence
VOR	VHF Omnidirectional Radio Range
VSAT	Very Small Aperture Terminal – Terminal me Hapje Shume te Vogel
WAS	Wireless Access Systems – Sisteme Aksesi pa Tel
WBB	Wireless Broadband

SHTOJCA 2

Lista e dokumentave

1. Dokumentat e ITU

1.1 Radio Rregulloret

Radio Rregulloret
Edicioni i 2004-s
Geneva 2004
- Volumi 1: Nenet
- Volumi 2: Shtojcat
- Volumi 3: Vendimet (rezolutat) dhe Rekomandimet
- Volumi 4: Rekomandimet e ITU-se te perfshira prej referimeve
- Skemat per perdorim ne lidhje te Shtojces 27 (Rev.WRC-03)

1.2 Rekomandimet e ITU-R

BS.412-9 Standartet e planifikuara per radiodifuzionin tokesor FM te zerit ne VHF

BS.450-3 Standartet e transmetimit per radiodifuzionin FM te zerit ne VHF

BS.560-4 Raporti i mbrojtjes se Radio Frekuencave ne radiodifuzionin LF, MF dhe HF.

BS.639 Brezi i nevojshem i emisionit ne radiodifuzionin LF, MF dhe HF.

BS.640-3 Sistemi i transmetimit me nje brez anesor (SSB) per radiodifuzionin HF.

BS.1514-1 Sistemi per radiodifuzionin dixhital te zerit ne brezat e radiodifuzionit nen 30 MHz.

BS.1615 "Parametrat e planifikuara" per radiodifuzionin dixhital te zerit per frekuencat nen 30 MHz.

BT.417-5 Fuqite minimale te fushes per te cilen mbrojtja mund te shihet ne planifikimin e nje sherbimi televiziv tokesor analog.

BT.470-6 Sistemet televizive konvencionale.

BT.655-6 Raporti i mbrojtjes se Radio Frekuencave per sistemet televizive tokesore me brez anesor AM qe pengohen nga sinjale vizive analoge te padeshirueshme dhe sinjalet e tyre sinjalizuese.

F.162-3 Perdorimi i antenave transmetuese ne sherbimet fikse te cilat operojne ne brezat nen 30 MHz.

F.349-5 Qendrueshmeria e frekuences se kerkuar per sistemet te cilat operojne ne sherbimet fikse HF per te bere te mundur perdorimin e kontrollit automatik te frekuences se panevojshme.

F.382-7	Ndarja e kanaleve te Radio Frekuencave per sistemet radio-rele qe operojne ne brezat 2 dhe 4 GHz.
F.636-3	Ndarja e kanaleve e Radio Frekuencave per sistemet radio-rele qe operojne ne brezin 15 GHz.
F.747	Ndarja e kanaleve e Radio Frekuencave per sistemet fiks wireless qe operojne ne brezin 10 GHz.
F.755-2	Sherbimet pike-shume-pika ne sherbimin fiks.
F.1110-3	Sistemet radio te pershtatura per frekuencat nen 30 MHz.
F.1400	Objektivat dhe kerkesat e performances dhe vlefshmerise per aksesin e sherbimit fiks pa tel ne rrjetin e komutuar telefonik publik (PSTN).
F.1488	Ndarja ne blloqe e frekuencave per sistemet fiks pa tel ne brezin 3400-3800 MHz.
M.629	Perdorimi per sherbimin e radionavigacionit te brezave te frekuencave 2900-3100 MHz, 5470-5660 MHz, 9200-9300 MHz, 933-9600 MHz, 9500-9800 MHz.
M.1174-1	Karakteristikat teknike te pajisjeve te perdorura per komunikimet ne anije dhe avion ne brezat midis 450 dhe 470 MHz.
M.1313-1	Karakteristikat teknike te radareve te radionavigacionit detar.
M.1652	Selektimi dinamik i frekuencave (DFS) ne sistemet pa tel, perfshire dhe rrjetet e zones lokale radio me qellim mbrojtjen e sherbimit radiopercaktues ne brezin 5 GHz.
S.1340	Ndarja midis lidhjeve feeder per sherbimin mobile-satelitor dhe sherbimit radionavigacion aereonautik ne drejtimin Toke-Hapsire ne brezin 15.4-15.7 GHz.
SA.1282	Realizueshmeria e ndarjes mids radareve te eres dhe sensoreve aktiv te lindur ne hapsire ne afersine 1260 MHz.
SM.329-10	Emisionet e padeshiruara ne fusha te paligjshme.
SM.337-4	Ndarjet e distances dhe frekuences.
SM.851-1	Ndarja midis sherbimit radiodifuzion dhe sherbimeve fiks dhe/ose te levizshme ne brezat UHF dhe VHF.
SM.1009-1	Perpuethshmeria midis sherbimeve radiodifuzion ne brezin rreth 87-108 MHz dhe sherbimeve aeronautik ne brezin 108-137 MHz.
SM.1045-1	Toleranca e frekuences se transmetuesit.
SM.1138	Percaktimi i brezit te nevojshem perfshire ketu shembujt per llogaritjen e tyre dhe shembujt shoqerues per percaktimin e emisioneve.
SM.1266	Sistemet adaptuese MF/HF.

2. Akte ligjore të Bashkimit Europian

2.1 Direktivat

1999/5/EC Direktiva 1999/5/EC e Parlamentit Europian dhe e Keshillit ne 9 Mars 1999 ne pajisjet radio dhe ato terminale te telekomunikacioneve si dhe njohja e perbashket e konformitetit te tyre.

2002/20/EC Direktiva 2002/20/EC e Parlamentit Europian dhe e Keshillit ne 7 Mars 2002 mbi autorizimin e sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike (Direktiva e Autorizimit).

2002/21/EC Direktiva 2002/21/EC e Parlamentit Europian dhe e Keshillit ne 7 Mars 2002 mbi nje strukture rregulloreje per sherbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Struktures – Framework Directive).

2.2 Vendimet

98/516/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 7 Qershor 1998 mbi nje Rregullore teknike per stacionet Toke - satelitore, i levizshem – tokesor me vlera te ulta te dhenash (LMES) qe operojne ne brezat e frekuencave 11/12/14 GHz.

98/533/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 3 Shtator 1998 mbi nje Rregullore teknike per Rrjetet e Komunikimeve Individuale Satelitore (S-PCN) Stacionet Tokesore te levizshme (MES), perfshire stacionet tokesore per rrjetet S-PCN qe operojne ne brezat e frekuencave 1.6/2.4 GHz sipeas sherbimeve satelitore te levizshme (MSS).

98/542/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 4 Shtator 1998 mbi nje rregullore teknike per kerkesat e aplikimeve telefonike per komunikimet e levizshme tokesore dixhitale publike pan-Europiane, faza II.

98/543/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 4 Shtator 1998 mbi nje rregullore teknike per kerkesat e aplikimeve telefonike per stacionet e levizshme mendohet te perdoren me rrjetet e telekomunikacioneve celulare dixhital publike te fazes se II duke operuar ne brezin DCS 1800.

98/574/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 16 Shtator 1998 mbi nje rregullore teknike per kerkesa te pergjithshme te bashkengjitura per komunikimet e levizshme tokesore dixhitale publike pan-Europiane, faza e II.

98/575/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 16 Shtator 1998 mbi nje rregullore teknike per stacionet e levizshme mendohet te perdoren me rrjetet e telekomunikacioneve celulare dixhitale publike te fazes se II duke operuar ne brezin GSM 1800.

98/578/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 16 Shtator 1998 mbi nje rregullore teknike per stacione tokesor-satelitore i levizshem -tokesor me vlere te ulet te dhenash (LMES) qe operojne ne brezat e frekuencave 1.5/1.6 GHz.

98/734/EC Vendimi i marre nga Komisioni ne 30 Nentore 1998 mbi nje rregullore teknike per stacinet Toke-satelitore, i levizshem -tokesor (LMES) qe operojne ne brezat e frekuencave 1.5/1.6 GHz.

1999/310/EC	Vendimi i marre nga Komisioni ne 23 Prill 1999 mbi nje rregullore teknike per pajisje dixhitale pa tel te telekomunikacioneve (DECT) qe aksesojne rrjete dixhitale te sherbimeve te integruara (ISDN).
1999/498/EC	Vendimi i marre nga Komisioni ne 7 Korrik 1999 mbi nje rregullore teknike per pajisje dixhitale pa tel te telekomunikacioneve (DECT) qe aksesojne rrjete dixhitale te sherbimeve te integruara (ISDN) (Versioni 2).
1999/511/EC	Vendimi i marre nga Komisioni ne 7 Korrik 1999 mbi nje rregullore teknike per kerkesa shtese per stacione te levizshme me shume slote me te dhena te komutuara ne qark te nje shpejtesie te larte (HSCSD).
2000/299/EC	Vendimi i marre nga Komisioni ne 6 Prill 2000 duke vendosur klasifikimin fillestar te pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore te telekomunikacioneve dhe identifikuese shoqeruese.
2000/637/EC	Vendimi i marre nga Komisioni ne 22 Shtator 2000 ne aplikimin e Artikullit 3(3)(e) te Direktives 1999/5/EC te pajisjeve radio te cilat mbulohen nga kerkesat rajonale ne lidhje me sherbimet radiotelefonike ne brendesi te kanaleve.
2001/148/EC	Vendimi i marre nga Komisioni ne 21 Shkurt 2001 ne aplikimin e Artikullit 3(3)(e) te Direktives 1999/5/EC .
676/2002/EC	Vendimi Nr. 676/2002/EC i Parlamentit Europian si dhe vendimi i Keshillit date 7 Mars 2002 mbi nje sturkture rregullatore per politikat e spektrit te radios ne Bashkimin Europian (Vendime mbi Spektrin e Radios).
2004/71/EC	Vendimi i dates 4 Shtator 2003 i Komisionit mbi kerkesat esenciale qe lidhen me pajisjet e komunikimit radio detare qe mendohet te perdoren ne anijet dhe avionet non-SOLAS dhe te behen pjese e Sistemit Global te Sigurise dhe Fatkeqesive Detare (GMDSS).
2004/545/EC	Vendimi i dates 8 Korrik 2004 i Komisionit mbi harmonizimin e spektrit te radios ne brezin 79 GHz per perdorimin e pajisjeve radar automatike me brez te shkurter ne Bashkim.
2005/50/EC	Vendimi i Komisionit date 17 Janar 2005 mbi harmonizimin e brezit te spektrit te radios ne brezin 24 GHz per nje perdorim ne kohe te limituar nga pajisjet radar automatike me brez te shkurter ne Bashkim.
2005/53/EC	Vendimi i Komisionit date 25 Janar 2005 mbi aplikimin e Artikullit 3(3)(e)e Direktives 1999/5/EC te Parlamentit Europian dhe te Keshillit per pajisjet radio qe mendohet te perfshihen ne Sistemin e Identifikimit Automatik (AIS).
2005/513/EC	Vendimi i Komisionit date 11 Korrik 2005 mbi perdorimin e harmonizuar te spektrit te radios ne brezin e frekuences 5 GHz per implementimin e sistemeve wireless duke perfshire dhe rrjetet e zones locale radio (WAS/RLAN).
2005/631/EC	Vendimi i Komisionit i dates 29 Gusht 2005 ne lidhje me kerkesat esenciale referuar ne Direktiven 1999/5/EC te Parlamentit Europian dhe te Keshillit duke siguruar akses te fareve mates Cospas-Sarsat per sherbimet e emergjences.

2011/485/EU	Vendim Zbatues i Komisionit më 29 korrik 2011 për ndryshimin e Vendimit 2005/50/EC për harmonizimin e brezit të spektrit radio 24 GHz për përdorimin e kufizuar kohor nga pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër në komunitet
2016/339/EU	Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2016/339 i datës 8 mars 2016 për harmonizimin e brezit të frekuencave 2 010-2 025 MHz për lidhjet video pa tel portative ose të lëvizshme dhe kamerat pa kabllo të përdorura për krijimin e programeve dhe ngjarjet e veçanta
2016/2317/EU	Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2016/2317 më 16 dhjetor 2016 për ndryshimin e Vendimit 2008/294/EC dhe Vendimit zbatues 2013/654/EU, me qëllim thjeshtësimin e operimit të komunikimeve celulare në mjete fluturuese (shërbime MCA) në Union.
2017/1483/EU	Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2017/1483 i 8 gushtit 2017 që ndryshon Vendimin 2006/771/EC për harmonizimin e spektrit të radios për përdorim nga pajisjet me rreze të shkurtër dhe që shfuqizon Vendimin 2006/804/EC
2017/2077/EU	Vendim Zbatues I Komisionit (EU) 2017/2077 i datës 10 nëntor 2017 për ndryshimin e Vendimit 2005/50/CE për harmonizimin e brezit të spektrit të radios 24 GHz për përdorimin e kufizuar kohor nga pajisjet radar automobilistike me rreze të shkurtër në Komunitet.
2019/1345/EU	Vendim Zbatues i Komisionit (EU) 2019/1345 i datës 2 gusht 2019 për ndryshimin e Vendimit 2006/771/EC për përditësimin e kushteve teknike të harmonizuara në fushën e përdorimit të spektrit të radios për pajisjet me rreze të shkurtër.
2022/173/EU	Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2022/173 i datës 7 shkurt 2022 për harmonizimin e brezave të frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz për sistemet tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike në Union dhe shfuqizimin e Vendimit 2009/766/EC.
2012/688/EU	Vendimi Zbatues i Komisionit 2012/688/EU i datës 5 nëntor 2012 për harmonizimin e brezave të frekuencave 1920-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz për sistemet tokësore të afta për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronik ne Union.
2020/636/EC	Vendimi Zbatues i Komisionit 2020/636/EC i datës 8 maj 2020 për ndryshimin e Vendimit 2008/477/EC për përditësímin e kushteve teknike aplikuara në brezin e frekuencave 2500-2690 MHz.
2019/235/EU	Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2019/235 për ndryshimin e Vendimit 2008/411/EC në lidhje me një përditësim të kushteve teknike përkatëse të zbatueshme për brezin e frekuencave 3400-3800 MHz
2020/1426/EU	Vendimi zbatues i Komisionit (EU) 2020/1426 i datës 7 tetor 2020 për përdorimin e harmonizuar të spektrit të radios në brezin e frekuencave 5875 - 5905 MHz për aplikimet e lidhura me sigurinë të Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS) dhe shfuqizimin e Vendimit 2008/671/EC.
2022/179/EU	Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2022/179 i datës 8 shkurt 2022 për përdorimin e harmonizuar të spektrit të radios në brezin e frekuencave 5 GHz për zbatimin e

sistemeve të aksesit me valë duke përfshirë rrjetet lokale të radios dhe shfuqizimin e Vendimit 2005/513/EC.

2021/1067/EU Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2021/1067 i datës 17 qershor 2021 për përdorimin e harmonizuar të spektrit të radios në brezin e frekuencave 5945-6425 MHz për zbatimin e sistemeve të aksesit pa tela duke përfshirë rrjetet lokale të radios (WAS/RLANs).

2020/590/EU Vendimi zbatues i Komisionit (EU) 2020/590 i datës 24 prill 2020 për ndryshimin e Vendimit (EU) 2019/784 për përditësimin e kushteve teknike të aplikueshme në brezin e frekuencave 24,25-27,5 GHz .

2022/180/EU Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2022/180 i datës 8 shkurt 2022 që ndryshon Vendimin 2006/771/EC në lidhje me përditësimin e kushteve teknike të harmonizuara në fushën e përdorimit të spektrit të radios për pajisjet me rreze të shkurtër veprimi.

2022/172/EU Vendimi zbatues i Komisionit (EU) 2022/172 i datës 7 shkurt 2022 që ndryshon Vendimin Zbatues (EU) 2018/1538 për harmonizimin e spektrit të radios për përdorim nga pajisjet me rreze të shkurtër brenda brezave të frekuencave 874-876 dhe 915-921 MHz.

2022/2324/EU Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2022/2324 i datës 23 nëntor 2022 që ndryshon Vendimin 2008/294/EC, për të përfshirë teknologjitë shtesë të aksesit dhe masat për funksionimin e shërbimeve të komunikimit celular në avion (shërbimet MCA) në Union.

2021/1730/EU Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2021/1730 i datës 28 shtator 2021 për përdorimin e harmonizuar të brezave të çiftuar të frekuencave 874,4-880,0 MHz dhe 919,4-925 MHz dhe të brezit të paçiftuar të frekuencave 1900- 1910 MHz për Radio celulare hekurudhore.

2019/785/EU Vendimi Zbatues i Komisionit (EU) 2019/785 i datës 14 maj 2019 për harmonizimin e spektrit të radios për pajisjet që përdorin teknologjinë ultra të gjerë në Bashkim dhe shfuqizimin e Vendimit 2007/131/EC.

3. Dokumentat e CEPT-it

3.1 Vendimet e ECC/DEC dhe ERC/DEC

ERC/DEC/(95)01 Vendimi i ERC i dates 1 Dhjetor 1995 mbi qarkullimin e lire te pajisjeve radio ne vendet anetare te CEPT.

